



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 22 SHTATOR 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
22. SEPTEMBRA 2011. GODINE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2011

E enjte, 22.09. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupeve parlamentare zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve deri në 3 minuta. Replika nuk ka.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Dua të ngrejë këtu një çështje jashtë rendit të ditës, humbjen e jetës në mënyrë tragjike të vëllezërve Mehana, nga lagjja Bar e komunës së Mitrovicës. Familjes Mehana, fillimisht i shpreh ngushëllimet më të sinqerta.

Të nderuar kolegë,
Dyshohet se dy vëllezërit e familjes Mehana u detyruan në vetëvrasje nga fajdexhinjtë, ndërsa i treti i shpëtoi më të keqes. Duke ndarë dhembjen me familjen Mehana, duhet të tërheq vëmendjen tuaj, të institucioneve të hetuesisë dhe të drejtësisë, për të ndërmarrë veprime të duhura për luftimin e krimit të organizuar të fajdeve, të kësaj dukurie kriminale e të atyre që përfitojnë nga këto- fajdexhinjtë.

Rasti i familjes Mehana, sa është tragjik, është edhe tepër shqetësues, ngase dëshmon se sa janë të fuqishëm fajdexhinjtë sot në Kosovë, sa familje janë vënë në presion, në telashe nga fajdexhinjtë, sa individë dhe familje u plaçkitën, u bankrotuan, u hodhën në rrugë nga fajdexhinjtë për të përfituar këto grupe kriminale të fajdexhinjve.

Thënia e filozofit Tomas Hobs se “ njeriu për njeriun është ujë”, i përgjigjet më së miri këtij soji të njerëzve.

Fajdexhinjtë sollën në Kosovë shumë vuajtje edhe lot. Kush janë fajdexhinjtë? Çdo qytetar në shtetin e tij i njeh, si në Mitrovicë, ashtu edhe në Prishtinë, Podujevë, Ferizaj, Prizren, apo Gjilan e Pejë, kudo në Kosovë, ngase kur duam për të gjetur paratë me fajde, i gjejmë fajdexhinjtë.

Çdo qytet i Kosovës i ka fajdexhinjtë e vet, ata njihen me emër dhe mbiemër dhe me grupin që i rrethon.

Nuk mund të fajësohen qytetarët të cilët për nevojat e tyre, të familjes apo biznesit, detyrohen të kërkojnë para nga fajdexhinjtë. Në këtë veprimtari ata shpeshherë detyrohen, ngase në bankat tona nuk mund të kenë përkrahje financiare, banka këto tek ne të cilat gjithashtu japin kredi aspak më të mira se fajdetë.

Hiq rastin e fundit, sa vrasje tjera ka ndodhur në Kosovë sherri i fajdeve dhe fajdexhinjve. Sa janë të organizuar fajdexhinjtë, a kanë ata të ndarë botën e biznesit të fajdeve, a do të thotë se këta njerëz janë mbi ligjin? A do të thotë se dënimi i ulët për këtë veprimtari kriminale ka ndikuar në rritjen e numrit të fajdexhinjve të cilët në mënyrë krejt kriminale përfitojnë duke shantazhuar dhe kërcënuar qytetarë, duke detyruar ata deri në vetëvrasje, duke mos pasur rrugë të tjera për t' u përgjigjur fajdeve të fajdexhinjve.

Andaj, një bashkëpunim, qytetarë, polici, do të luftonte këtë të keqe të madhe në shoqërinë tonë.

Përfitimet kriminale të fajdexhinjve, të narko-bizneseve dhe pasurive tjera të jashtëligjshme e bën të domosdoshëm që ky Parlament të aprovojë Ligjin anti-mafia.

Tragjedia e familjes Mehana dhe shumë familjeve të tjera, të cilat pësuan nga njerëz që janë mbi ligjin, e bën të domosdoshëm Ligjin anti-mafia, që ky ligjin do t'i sanksiononte të gjithë ata të cilët në forma të ndryshme, jo ligjore, u pasuruan në Kosovë, por edhe ata të cilët u pasuruan jashtë Kosovës në mënyrë joligjore, ndërsa këtu edhe për të .. pasurinë e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën, si deputet, tre minuta.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Që prej 26 korrikut, pra një ditë pas ndërhyrjes së njësiteve tona të Policisë në veri të vendit dhe po ditën kur u tërhoqën ato prapa, kjo pjesë e Kosovës, pra veriu i Kosovës është shndërruar në poligon të Beogradit.

Ndonëse Qeveria përditë e përsërit se në veri ka filluar të sundojë ligji e rendi, është shumë e qartë që fatkeqësisht atje sundon vetëm ligji i bandave të armatosura të Serbisë dhe rendi i barrikadave.

Në veri të Kosovës politikisht sundon pushteti lokal i tri komunave të veriut, që janë shkëputur moti nga Prishtina, në koalicion me Beogradin.

Pushteti komunal atje është vënë aktivisht në funksion të ndarjes së Kosovës, madje edhe paratë që u ndanë atyre nga Qeveria jonë, nëpërmjet buxhetit të konsoliduar të Kosovës, shfrytëzohen për ta luftuar integritetin territorial të shtetit tonë.

Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk i ka prekur dhe cenuar strukturat e paligjshme të Serbisë në veri dhe kjo është e mjaftueshme për ta trajtuar këtë qeveri si partner pasiv të situatës atje.

Qeveria e Kosovës krejt sovranitetin e Republikës e ka reduktuar në vendosjen e një grushti doganierësh, në pikat kufitare me Serbinë. Këta doganierë, së pari janë dërguar atje me helikopter të KFOR-it dhe Qeveria në vend që të na tregojë planin e vet operacional për shtrirjen e sovranitetit, ajo po mburret me helikopterin e KFOR-it.

Përveç kësaj, këta doganierë nuk guxojnë ta shkelin mbi 40 kilometra të tokës, prej lumit Ibër e deri në Leposaviq, por duhet ta kalojnë këtë hapësirë nëpër qiell. Qarkullimi nëpër qiell tregon se Qeveria, fatkeqësisht, nuk po e kontrollon tokën e Kosovës.

Moslejimi i mallrave të Serbisë ka mundur të shërbente si armë e fortë e Kosovës për të ushtruar trusni mbi Serbinë për ta njohur shtetin e Kosovës, por Thaçi është ndikuar më shumë nga interesi ekonomik i Serbisë, sesa nga interesi politik i Kosovës. Ky është një shërbim i madh për Serbinë dhe i cili ia mundëson Beogradi ta vazhdojë luftën e tij kundër Kosovës, pa kurrfarë trysnie.

Qeveria e Kosovës po duket haptazi se nuk po brengoset për ata që e rrezikojnë Kosovën, po për ata që duhen ta ndihmojnë. I tillë ishte edhe shqetësimi i ministrit Rexhepi për praninë e deputetit Rexhep Selimi në Lagjen e Boshnjakëve, më 16 shtator.

Ministrit Rexhepi nuk i bën fare përshtypje që ministrat e Serbisë dhe dhjetëra deputetë nga Beogradi shkojnë në veri dhe u japin urdhra strukturave paralele dhe kriminale të Serbisë.

Ministri Rexhepi e ka hallin pse një deputet i “Vetëvendosjes” ka qëndruar në një lagje të rrezikuar shqiptare atje. Meqë ky ministër sot ka ardhur të na tregojë përrallën e mirënjohur për sundimin e ligjit në veri, unë i thërras deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta shfrytëzojnë po ashtu të drejtën e tyre për të folur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Aferiditë Berisha- Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA SHAQIRI: I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Gjendja në shëndetësinë e Kosovës edhe pse kanë kaluar disa vjet pas lufte, nuk ka ndonjë përmirësim të theksuar, sepse mendojmë që nuk është trajtuar asnjëherë me seriozitet. Ende nuk është zgjedhur drejtori ekzekutiv i QKUK-së, pastaj ministri i

Shëndetësisë, ka nënshkruar kontratën kolektive -sektoriale për pagesën e kujdestarive, edhe pse në Ligjin për buxhet 2011, nuk parashihen mjete për këtë.

Kostoja e kësaj kontrate është mbi 5 milionë euro. Të jemi të qartë, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës e përkrahim pagesën e këtyre kujdestarive, por kërkojmë të qartësohet se nga do të merren këto mjete?

Ministri gjithashtu deklaroi se dy ligje për shëndetësi kanë marrë aprovimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore, për t'u miratuar, mirëpo me rastin e prishjes së marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ku Kosova kaloi nga stand by arrangement në staf monitoring program e që thënë shkurt është kalim nga një marrëveshje përfituese në një program monitorimi dhe supervizimi në kërkim të përmbushjes së standardeve, asnjë ligj që ka kosto financiare, nuk do të mund të miratohet apo të futet në fuqi para tri vjetëve, atë që Lidhja Demokratike e Kosovës e pat potencuar me rastin e prishjes së marrëveshjes.

Mendoj, se për këtë sektor duhet bërë shumë më shumë, në mënyrë që të mos mbetet një ndër pikat më të dobëta të udhëheqjes qeveritare.

Ndërsa, sa i përket nivelit dhe profesionalizmit të mjekëve kosovarë asnjëherë nuk është vë në dyshim, edhe ne kemi mjekë specialistë e profesorë të kalibrit evropian dhe botëror, që kanë treguar shumë sukses dhe që mund të mburremi me ta. Ata nuk u kursyen edhe gjatë luftës, mirëpo, kushtet në të cilat ata punojnë sot dhe shpërblimi që ata marrin për punën e kryer janë jashtë çdo standardi.

Ata pagat e janarit dhe shkurtit i kanë marrë pa rritje edhe pse u janë premtuar. Të përmend vetëm një fakt që këto ditë e dëgjuam nëpër mediat tona, brenda 24 orëve lindin mesatarisht 50 foshnje, ndërsa në QKUK ka vetëm 2 ultrazë. Kjo nuk do koment, kjo i bie që shtatzënat tona duhet të presin në radhë për të bërë vizitën në ultrazë, pastaj hapësira e ngushtë në emergjencë për t'i sistemuar rastet emergjente, që ishte po ashtu në media.

Ne nuk kemi harruar që bazat e gjendjes jo të mirë në shëndetësi fillojnë edhe nga vitet e 90-ta kur mjekët shqiptarë u larguan nga vendet e punës, mirëpo, pas lufte asnjëherë nuk u nda buxhet adekuat për këtë sektor shumë të rëndësishëm për qytetarët e Kosovës. Mendoj, që ka ardhur koha që ky sektor të shikohet me një seriozitet më të madh.

Të nderuar deputetë,

Për t'u bërë mjek duhet lënë sytë në libra dhe familja duhet të bëjë shumë mund, sakrifica e shpenzime. Dikur të studiosh Fakultetin e Mjekësisë, ka qenë ëndërr, ndërkaq sot është atraktive të studiosh shkencat politike, Fakultetin Ekonomik, Juridik e të tjera. Mjekësia meriton një trajtim më të mirë në të ardhmen. Kemi nevojë për menaxherë të suksesshëm për të menaxhuar atë që kemi. Tani për tani kërkojmë nga ministri i Shëndetësisë që në afat sa më të shpejtë të zgjedhë drejtorin ekzekutiv të QKUK-së, në përputhje me ligjet në fuqi, duke i dhënë përparësi aftësive menaxheriale dhe profesionale e jo përkatësisë politike dhe partiake, një drejtor i cili do të ndihmojë

në zhvillimin e QKUK-së dhe në ofrimin e shërbimeve të mirëfillta shëndetësore për qytetarët e Kosovës.

Tek e fundit për mjekë të mirë, për shërbime të mira shëndetësore, ka nevojë e tërë popullata, pa marrë parasysh se cilës parti i takon. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Kërkoj ta shtoj një çështje jo për ta shndërruar në çështje të trajtimit të çështjeve të politikës ditore edhe aq më tepër për ta ndërruar kursin e politikës zyrtare të Kosovës, në raport me shqiptarët që jetojnë në Luginën e Preshevës, por për faktin se këto ditë kemi pasur një varg aktiviteteve protestuese të qytetarëve që jetojnë në komunat: Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë dhe si rezultat i krejt kësaj dje ka pasur një protestë gjithë popullore të organizuar nga qytetarët dhe përfaqësuesit politikë dhe të shoqërisë civile nga gjithë kjo trevë. Theksi kryesor dhe kërkesa kryesore e këtyre protestave ka qenë liria e lëvizjes, rikthimi i zonës së sigurisë, çmilitarizimi i rajonit e të tjerë, kërkesë e këtyre qytetarëve kamotshme. Siç e dini, kohëve të fundit, ka pasur raste edhe të arrestimit të veprimtarëve të shoqërisë civile atje, dhe po ashtu ka pasur edhe pengesa në kalimin e kufirit.

Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara tonat dhe duke pasur parasysh po ashtu një kurs jashtëzakonisht racional të politikës zyrtare të Prishtinës, në raport me krejt fqinjët, po edhe me qytetarë shqiptarë që jetojnë atje. Dëshiroj të vë theksin një angazhim më të madh të institucioneve tona edhe të legjislativit edhe të ekzekutivit në raport me ndikimin pozitiv që mund ta kemi ne atje.

Besoj që Kuvendi duke marrë për bazë aktivitetet e agjencive dhe institucioneve që janë në varësi të Kuvendit, do t'i shtojë angazhimet, sidomos në aktivitetet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në çfarë mundësish mund t'i mbështesim ata qytetarë dhe po ashtu ekzekutivi duke përfshirë të gjitha mundësitë, gjithë partnerët ndërkombëtarë që janë, që veprojnë këtu, e duke përfshirë po ashtu edhe angazhimet e Qeverisë në raport me bisedimet ose me bisedimet që po zhvillohen me zyrtarët e Beogradit, në mënyrë që të trajtohen disa prej çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat elementare të qytetarëve atje.

Siç e dini kohëve të fundit edhe në zonat kufitare kemi pasur shtim të kontrollit policor në Serbi. Dhe po ashtu dua t'i theksoj edhe disa kërkesa që lidhen edhe me Kosovë, siç kanë të bëjnë, kalimet kufitare, njohja e diplomave të universiteteve të Kosovës e të tjerë.

Unë shpresoj që edhe ekzekutivi edhe Kuvendi i Kosovës në ditët në vijim është momenti i mirë që edhe t'i ftojme përfaqësuesit e institucioneve atje në informacione më të mira, po edhe të ndërmarrim aktivitetet që janë në fuqinë tonë për t'u ndihmuar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit!
Deputeti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: I nderuari kryetar,
Të nderuar deputetë,
Edhe unë po ashtu do të flas sërish këtu sot për Medvegjën, Bujanocin dhe Preshevën. Është pikërisht indiferenca e madhe aktuale ndaj shqiptarëve të këtyre tri komunave në Serbi nën Serbi, që më bën të flas.

Kjo temë është e domosdoshme që të hapet, pasi sot vazhdojnë shqiptarët që të shtypen atje dhe në ndërkohë vazhdon të flitet dhe të negociohet me Serbinë për Kosovën dhe për serbët e jo asnjëherë të mos hapet çështja e Serbisë dhe çështja e shqiptarëve që jetojnë atje.

Çështja e shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, trajtohet në fakt krejtësisht si diçka në rregull nga ana e Kosovës e po ashtu edhe nga faktori ndërkombëtar.

Problemi i shqiptarëve në këto tri komuna nuk po ekziston fare dhe shumë kush në Kosovë po t'i thuash gjë për Preshevën, do të thotë thuaju të durojnë se po na prishin punë këtu neve. Çdo herë kur shqiptarët e këtyre tri komunave i kërkojnë të drejtat e tyre, mesazhet nga Kosova ishin që të rrinë të qetë, sepse po i prishin punë Kosovës, dhe ata e respektuan këtë kërkesë të Kosovës edhe pse si e tillë ishte e padrejtë. Ata ishin të disiplinuar edhe çdo herë kur ka kërkuar Kosova diçka nga ata.

Pra, u kërkuar të heshtin edhe kur në Kosovë negociohej për decentralizimin dhe kur bëheshin komuna dhe në atë kohë kur ne si lëvizje e kundërshtonim sepse kjo pikërisht atëherë e bënte izolimin fizikë të Preshevës, Bujanocit nga Kosova.

Dhe si përfundim kemi arritur në pikën ku sot vazhdojnë ende negociatat me Serbinë për Kosovës dhe për serbët në Kosovë. Dhe asnjëherë nuk flitet atje dhe në ndërkohë ky territor po zbrazet si pasojë e dhunës dhe diskriminimit e varfërisë që i shkakton shteti me të cilin ne po kemi raporte të shkëlqyera, të njëanshme deri te tregtia e lirë e njëanshme.

Dhe kur bëhet fjalë për integrimin e Serbisë në BE, fitimin e statusit të vendit kandidat për Serbinë, nuk janë asnjëherë kusht të drejtat e shqiptarëve atje dhe nuk paraqet problem asnjëherë zbrazja e territorit atje. Ata dinë të na thonë çdo herë se vetëm këto tri komuna nuk janë në agjendë për diskutime.

Piter Feith, nga njëra anë propozon modelin e Katatonisë për serbët në veri dhe në ndërkohë që në Preshevë, Bujanoc e Medvegjë, shqiptarët trajtohen si zezakë në Afrikën e Jugut, gjatë periudhës së aparteidit, sepse kur bëhet fjalë për serbët edhe paketa e Ahttisarit bën të ndryshohet.

Ndërsa, atje kur i lejohen shqiptarëve abetaret në gjuhën shqipe të përpiluara në Tiranë, nga këto abetare hiqen të gjitha elementet shqiptare, çdo simbol kombëtar dhe nëse rastësisht ndodhet ndonjë emërtim shqiptar, atëherë ai zëvendësohet me atë serb. Në abetaren e re emri, Tirana është zëvendësuar me emrin Nish.

Pse, nuk paskan të drejtë nxënësit shqiptarë në Preshevë të dinë dhe të njohin emrin

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të Grupit, edhe 2 minuta!

LIBURN ALIU: ...edhe ata shqiptarë janë, pse atje për ta nuk duhet të ekzistojë flamuri kombëtar, përveç atij serb në tekstet shkollore. Ja pse. Sepse ky shtet partner në negociata me Qeverinë e Kosovës shqiptarët e atjeshëm i konsideron si serbë që aksidentalisht flasin shqip dhe politikanët tanë heshtin në këtë çështje.

Dhe kur ne flasim me tëra që na thonë është se kur ata kanë vepruar për Preshevën apo kur kanë qenë në Preshevë, ne as që e dinim ku gjendej Presheva.

Dje pati një protestë masive kundër diskriminimit në Preshevë dhe më datën 13 pati protestë po ashtu masive në Bujanoc dhe priten të tjera. Gjendja atje është e padurueshme dhe ky zë i tyre duhet të prekë ndërgjegjen e të gjithë neve dhe secilit veç e veç. Ata janë të përcaktuar qartë me kërkesa, duan reciprocitet e të të drejtave me serbët e Kosovës, duan të trajtojnë njëjtë si trajtohen serbët në Kosovë.

Unë me kërkesën e shumë qytetarëve dhe përfaqësuesve politikë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja edhe si deputet në këtë rast si Grupi Parlamentar të “Vetëvendosjes” do të kërkoj nga ju deputetë të Kuvendit të Kosovës që në këtë Kuvend të organizojmë një seancë të jashtëzakonshme që lidhet me këtë çështje. Jam i bindur që dot të hasin në gatishmërinë tuaj, pa dallime partiake.

Po ashtu desha të jap një sqarim shtesë në lidhje me aksionin e djeshëm të Lëvizjes “Vetëvendosje” me ç’rast u përmbys një maune me mallra serbe dhe në media u tha që pronari ka qenë nga Presheva, shoferi ka qenë nga Presheva, gjë që nuk është aspak e vërtetë. Kamioni është pronar i një serbi, shoferi deri në Merdare ka qenë Zoran Radojković, dhe shofer nga Merdarja ka qenë Fatmir Hajdari, i cili është nga Kosova. Pra, nuk ka të bëjë këtu me Preshevën aspak dhe kompania e cila i importon mallrat, është kompani nga Kosova. Unë dua ta heq çdo ndryshim pra, të mos mendohet këtu që janë shqiptarë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Liburn, faleminderit!

Juve të “Vetëvendosjes” po ju them edhe një herë, lexoni Rregulloren edhe shikoni të drejtën e juaj se si një çështje hyn në rend të ditës. Kështu që ju duhet ta dini se Kryesia si një trup që e administron me kërkesa që i bëhen Kuvendit, administron letra dhe jo fjalë. Prandaj, këtë po duhet ta them disa herë, dihet kur një çështje dëshironi ta futni në rend të ditës, cila është rruga për të ardhur deri te rendi i ditës.

Fjalën e ka deputeti Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuar kryetar i Parlamentit,

I nderuari zëvendëskryeministër dhe ministra,

Të nderuar deputetë,

Që nga 16 qershori, një pjesë e territorit të Kosovës është e barrikaduar dhe e çimentuar. Strukturat që nuk janë vetëm kriminale, por dorë e zgjatur e pushtetit të Serbisë, të papenguar veprojnë për rrënimin dhe sovranitetin e rendit kushtetues të Kosovës.

Veprimet më agresive ndodhin pikërisht prej ditës kur është dashur të funksionojë rendi shtetëror në pikat kufitare 1 dhe 31 dhe kur është hequr reciprociteti me Serbinë.

Është për përkrahje përpjekja e Qeverisë që ligji dhe shteti të funksionojë edhe në Jarinjë dhe Bërnjak, pa marrë parasysh që ato janë të pranishëm vetëm simbolikisht, por nuk ka pasur asnjë arsye, asnjë indikacion se ka arritur momenti për heqjen e masave të reciprocitetit. Tash vërehet se nuk ka qenë garanci as marrëveshja e 2 shtatorit në Bruksel, për të cilën nuk kemi shumë informacione.

Nëse rrethanat kanë imponuar që shteti atje të jetë i pranishëm në mënyrë simbolike, pse të hiqet reciprociteti në kohën kur zyrtarët nga Qeveria e Serbisë haptas e kanë thënë se në veri të Kosovës, nuk do të ketë prani të institucioneve të Republikës së Kosovës, se e pranojnë vetëm gjendjen e para 25 korrikut dhe Rezolutën 1244. Këto qëndrime të ne janë të papranueshme dhe kanë treguar qartë se për normalizimin e marrëdhënieve tregtare me Serbinë nuk mjafton vullneti i mirë i Prishtinës. Më pastaj ndodhen zhvillime edhe më dramatike të cilat për synim kanë shkatërrimin e mëtejshëm të sovranitetit të Kosovës dhe forcimin e strukturave paralele serbe në Kosovë.

Së pari në Serbi nuk ka hyrë asnjë kamion me mallra nga Kosova, edhe ato që ishin me vula të UNMIK-ut, u kthyen që të pajisen me dokumente të Administratës Tatimore serbe që veprojnë në Kosovë. Tash Serbia si përgjigje ndaj vullnetit tonë të mirë, imponon legjitimin e strukturave të saj në Kosovë, madje këtë e ka rregulluar edhe me ligjin për tatimet që e ka miratuar një ditë para se Kosova ta heqë reciprocitetin. Aty tash Kosova trajtohet si pjesë integrale e sistemit tatimor të Serbisë dhe nuk parasheh kurrfarë procedura doganore për qarkullimin e mallrave me Kosovën.

Pra, disponimit tonë për reciprocitet ajo përgjigjet me veprime radikale që shkojnë në dëm të shtetësisë së Kosovës. Prandaj, me heqjen e reciprocitetit kemi dhënë autogol, por kam dëshirë që në vazhdim të lojës do ta kthejmë rezultatin në favor të interesave të Republikës së Kosovës.

Në këtë rrethana është shqetësues edhe reagimi i Komunitetit të Biznesit, duket se mezi është pritur vendimi për suspendimin e masave dhe Kosova të vërshohet me mallra serbe.

Prej të premtës kanë hy mbi 400 kamion me mallra nga Serbia, u harruan deklaratat për rritjen e prodhimit dhe të punësimit mbi 40% në prodhues kosovarë. Po punojmë me një matematikë të palogjikshme, nuk kemi eksportuar asnjë gram në Serbi, kurse kemi importuar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën i fundit për sot e ka deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta ngre një çështje e cila ka të bëjë me një grevë të ish- punëtorëve të Ndërmarrjes Bujqësore Industriale “Suhareka” në Suharekë, të cilët që tri javë resht bëjnë grevë, pas shumë ankesave, pas shumë shkrimeve, pas shumë protestave për procesin e privatizimit të kësaj ndërmarrje, ku kanë vërejtur shumë dështime, edhe në procedura, por edhe në parregullsi të tjera dhe pas shumë ankesave kanë vendosur të futen në grevë.

Unë mendoj që e vlen vëmendjen tonë dhe të opinionit kosovar që ata ish- punëtorë të ndërmarrjes të kenë të themi edhe një mbikëqyrje edhe nga ne. Në këtë aspekt e kisha lutur kryeministrin apo ministrin e Zhvillimit Ekonomik që të bëjë një vizitë, të bisedojë me ta dhe do të shoh që vërtet shumë gjëra për të cilat ndoshta i kemi ditë apo s'i kemi ditur, do t'i dëgjoni aty dhe ka nevojë të përmirësohen në procedurën e mëtutjeshëm nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe me këtë e kemi kryer kohën për deklarime jashtë rendit të ditës.

Në sallë kemi 74 deputetë,

Në mbledhjen e Kryesisë, më kryetarët e grupeve parlamentare, jemi marrë veshë që nga Qeveria ta kemi një informatë nga ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi, dhe kjo informatë jepet pa debat.

Fjalën e ke zoti ministër.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Parlamentit, Krasniqi,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Me qenë se nga Kryesia është marrë vendim të jepet një informatë e shkurtër në lidhje me situatën e sigurisë dhe përgjithësi në veri, unë do të provoj të jem i shkurtër dhe t'i

sublimojë disa gjëra të cilat mendoj se do të jenë të rëndësishme për njoftimin tuaj, ndërsa, në seancë të ardhshme debatohet në lidhje me situatën në veri, atëherë do të jemi të gatshëm që çdo pyetje dhe shqetësim tuaj ta elaborojmë më gjatë.

Natyrisht që ju e dini se më 2 shtator janë arritur disa konkluzione edhe sa i përket vulave edhe sa i përket implementimit të Marrëveshjes së tregtisë së lirë në kuadër të Ceftës, mirëpo paraprakisht edhe Qeveria e Kosovës së bashku me partnerët ndërkombëtarë edhe me përfaqësues të KFOR-it e të EULEX-it, por po ashtu edhe përfaqësuesin special të Unionit Evropian, zoti Xhentilini dhe Ambasadën Amerikane jemi marrë veshë për disa parime të përgatitjes së një plani operacional për funksionalizimin e pikave doganore 1 dhe 31.

Pas pajtueshmërisë për këto parime, grupet punuese kanë pas disa takime ku i kanë precizuar edhe detalet teknike.

Natyrisht që edhe Grupi ndërministror, i udhëhequr nga kryeministri i Kosovës, kemi pas takime gati të përditshme në lidhje me përgatitjen e këtij plani të veprimi dhe fillimin e implementimit të tij. Mbas një pune dy javore, më 15 shtator është aprovuar ky plan dhe ka filluar implementimi i tij, më 16 shtator sa edhe ka qenë si një zonë e izoluar ushtarake pika 1 - në Janrinje dhe 31 në Bërnjakë.

Ky plan operativ është i gatshëm ai mund edhe tu epet deputetëve, mirëpo në pika të shkurtra konsiston në këtë, që në pikat kufitare 1 - Jarinjë dhe 31 policët kufitarë e kanë përfaqësuesin, pra komandantin e pikës, është nga Policia Kufitare dhe nga një polic kufitar.

Doganierët po ashtu e kanë rolin udhëheqës në doganë, nga një person në pikën 1 dhe 31, ndërsa detyrat operationale i kryejnë përfaqësuesit e EULEK-sit dhe sigurinë e plotë e bëjnë trupat e KFOR-it, në një perimetër që e garanton sigurinë e tyre.

Natyrisht që për momentin në pikat 1 dhe 31 qarkullimi bëhet kryesisht për udhëtarë, për qytetarë nuk ka qarkullim të mallrave edhe pse dihet se kjo më tepër është për shkak të pengesave, barrikadave që janë në pjesën veriore. Mirëpo, në atë plan është i një rëndësi tjetër e veçantë që kontrollin e vijës së gjelbër dhe të gjitha vendkalimet ilegale, monitorohen, kontrollohen nga KFOR-i dhe në këtë mënyrë është prevenuar komplet kontrabanda. Transportin e kanë përsipër për momentin EULEX-i, bashkë me KFOR-in dhe bartja e policëve kufitarë dhe doganierëve bëhet me helikopterë të EULEX-it ose të KFOR-it. Deri tani ky plan ka funksionuar me përpikëri, asnjëherë nuk ka pasur vonesa dhe çdoherë ndërrimet kanë qenë në vendin e duhur.

Aranzhimet e dakorduara me partnerët ndërkombëtarë për pikë-kalimet kufitare Jarin dhe Bërnjak, janë për një fazë tranzitore gjashtëmujore që pastaj do të rishqyrtohen. Pavarësisht opinioneve të ndryshme, mendoj se e arritura më e madhe është që bashkë me partnerët ndërkombëtarë edhe të Unionit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkrahja e KFOR-it dhe EULEX-it, që është përkrahur si e drejtë legale dhe legjitime dhe se tërë territori i Kosovës është një njësi doganore policore, prandaj në

këtë moment, opinioni politik që në faza të mëhershme ka qenë vështirë të arrihet një përkrahje, sidomos nga Unioni Evropian, në këtë rast është arritur plotësisht dhe kjo është një arritur e madhe. Prandaj, edhe ne si Qeveri, i përmbahemi me përpikëri këtij plani dhe nuk duam të bëjmë veprime të pakoordinuara.

Edhe sa për një njoftim, edhe sikur të funksionalizohen për qarkullim të mallrave, pas heqjes së barrikadave që duhet të ndodhë në ditët ose javët e ardhshme, mallrat të cilat i nënshtrohen akcizës nuk qarkullojnë nëpër pikën 1 dhe 31 dhe kjo është po ashtu një gjë shumë e mirë për arsye se të gjithë ata kontrabandistë dhe kriminelë i kanë shfrytëzuar këto pika dhe janë pasuruar në mënyrë të paligjshme, janë fuqizuar edhe politikisht. Prandaj çdo mall që i nënshtrohet akcizës, është i preorientuar kah pika 3 në Merdare ose pjesë tjera ku bëhet zhdoganimi, menjëherë në pikën kufitare.

Sa për informim, po ashtu e dini se edhe para këtyre aksioneve, zhdoganimi nuk është bërë në pikën 1 dhe 31 për arsye se nuk ka mundësi teknike. Kjo pritet në të ardhmen që të bëhen objektet e duhura dhe të bëhet zhdoganimi në këto pika. Për momentin bëhen në terminalin e Mitrovicës dhe aty ka alternativa të ndryshme se si të detyrohen ata që eksportojnë mallra në Kosovë, ta bëjnë zhdoganimin.

E dini, në të kaluarën ata diku gjatë rrugës kanë humbur dhe i kanë ikur obligimit për zhdoganim. Tash ka alternativa të cilat janë propozuar nga Doganat e Kosovës. Së pari është garancioni bankar që do të japin dhe në rast se ai mall nuk zhdoganohet, merren menjëherë ato të hyra. Po ashtu ka mundësi që t'iu merren dokumentet personale, të detyrohen të shkojnë në Terminalin doganor dhe aty, pas zhdoganimit, i marrin dokumentet mbrapa.

Ka pasur propozime të ndryshme që për sasi të vogla të bëhet pagesa në kesh që nuk është pranuar, prandaj të gjitha të hyrat nga këto pika, hyjnë nëpër buxhetin qendror nëpër trezorin tonë dhe hyjnë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës.

Natyrisht që kemi qenë plotësisht të vetëdijshëm se do të ketë reaksion pas funksionalizimit të pikave 1 dhe 31 nga grupet e caktuar, qoftë kriminalë, qoftë kontrabandistë, qoftë të kryetarëve ilegal, të komunave ilegale të cilët janë të lidhur bashkë edhe me krimin e organizuar, por edhe me një mbështetje të strukturave të caktuara nga Beogradi. Dhe, në këto raste, kjo është bërë si dukuri që e kanë gjetur një formë të cilën tradicionalisht e kanë përdorur edhe në Kroaci edhe në Bosnje dhe është çështja e barrikadave, bllokimit të rrugëve të ndryshme.

Unë mund t'ju them edhe në detale në cilat pjesë janë këto barrikada, por mund t'ju them se në aksin rrugor drejt Leposaviqit janë kryesisht në Rudar, është barrikada më e fortë dhe në drejtim të Bërnjakut janë te Zupqi, që nuk do të thotë se nuk ka edhe barrikada tjera dhe pa ashtu ka te ura qendrore e Ibrit. Natyrisht, që të gjitha këto janë të paligjshme për arsye se askush nuk ka të drejtë të bëjë bllokimin e qarkullimit të lirë të njerëzve dhe të mirave materiale. Pra, kjo është e jashtëligjshme dhe standardet demokratike kërkojnë që të ketë lëvizje të lirë për qytetarë për mallra dhe tjerë.

Natyrishisht që në këtë rast më së shumti e izolojnë vetveten dhe këto barrikada më së shumti reflektohen, si viktimë, në rast, janë qytetarët e rëndomtë, të cilët, jo me dëshirën e tyre, qëndrojnë në barrikada, të detyruar, qoftë nga grupet kriminale, qoftë nga strukturat ilegale komunale, të cilët i kërcënojnë me humbje të vendit të punës nëse nuk shkojnë, bëjnë keqpërdorime shpeshherë i qojnë edhe fëmijët e shkollave, i qojnë edhe punëtorët shëndetësorë. Dhe realisht, e kanë krijuar një ambient ku, nëse vazhdon më gjatë mund të paraqitet edhe një krizë e furnizimit me gjëra elementare ushqimore. Ne i kemi të gjitha këto shqetësime dhe bashkërisht me KFOR-in dhe EULEX-in, do t'i trajtojmë dhe nëse nuk bëjnë punë trysnitë e Brukselit ndaj Beogradit, për arsye se edhe Beogradi qëndron pas këtyre barrikadave, atëherë ne duhet të koordinohemi me KFOR-in dhe EULEX-in dhe të mundësojmë lëvizjen e lirë dhe qarkullimin e njerëzve të këto pjesë, duke i shmangur barrikadat, duke i hequr barrikadat.

Unë dua të them pak edhe për sigurinë e qytetarëve tjerë jo serbë. Ju e dini se në disa nga këto komuna, kemi përfaqësues të komunitetit shqiptar dhe të komuniteteve tjera jo serbe dhe po shkojnë në mënyrë kronologjike.

Sa i përket tri fshatrave në komunën e Leposaviqit: Kushtovë, Vllahi, Cerajë dhe Bistricë, kanë pengesa reale për arsye se barrikadat në Rudar pamundëson ta shfrytëzojnë rrugën magjistrale Mitrovicë- Leposaviq e më tutje. Ekziston një rrugë alternative nëpër pjesët malore e cila është e kalueshme për automjete të posaçme dhe komuna e Mitrovicës dy - tri herë ka dërguar ndihma. Kemi kërkuar dhe bashkërisht jemi marrë vesh që kjo rrugë të bëhet më e kalueshme. Ka mundësi me zhavorr edhe në atë kuptim derisa të lirohen barrikadat.

Sa i përket izolimit edhe pengesës së lëvizjes, është e shprehur edhe në Kodrën e Minatorëve, për arsye se më herët kanë pasur transportin me autobus, ndërsa pas këtyre ngjarjeve ai transport nuk është duke u bërë. Ndërsa, me përgjegjësinë më të madhe them pavarësisht se në media dalin reportazhe të ndryshme që fshatrat e komunës së Zveçanit: Zhazhë, Kelmend edhe Buletin, po ashtu janë të bllokuara, nuk ekziston, ajo nuk qëndron. E vetmja është një familje Kelmendi që është pranë fshatit Rudar, që është një kujdes i posaçëm ndaj kësaj familjeje që mos të ketë pengesa, ndërsa qarkullimi i lirë nuk mungon për arsye se i kanë rrugët e hapura.

Qarkullimi i lirë është po ashtu edhe për fshatin Qabër të komunës së Zubin Potokut, në shumicën e rasteve rruga magjistrale Mitrovicë-Bërnjak është e lirë, po e kanë edhe rrugën tjetër të asfaltuar nga Qabra nëpër Vinarc, Gushavc, Suhadoll dhe Mitrovicë, pra s' ka pengesë të qarkullimit në këtë drejtim. Po ashtu edhe fshatrat tjera: Suhodoll, Gushavc, Vinarc dhe Vidimriq, nuk kanë kurrfarë bllokade të rrugëve dhe është qarkullimi i lirë. Dhe dy lagjet më të mëdha, lagja e Boshnjakëve dhe **Tre Soliterët**, e kanë qarkullimin, jo nëpër urën kryesore të Ibrit, por e kanë nëpër urën lindore të Lagjes së Boshnjakëve dhe këndeje kah Suhodolli, prandaj, nuk janë të bllokuar.

Sa i përket gjendjes së sigurisë, në përgjithësi siguria është nën kontroll, menaxhuar nga KFOR-i, EULEX-i dhe Policia e Kosovës, natyrishisht që ka tensione, është pak fragjile,

mirëpo fal angazhimit të gjithë këtyre aktorëve nuk kemi pasur incidente ndëretnike, nuk ka pasur vrasje, nuk ka pasur plagosje. Të them para jush që siguria për të gjithë qytetarët, në veçanti për qytetarët e komunitetit shqiptar dhe jo serbë e të tjerë të cilët jetojnë në veri, është e sigurtë. Ka patrullime më të shpeshta të policisë. KFOR-i me kërkesën tonë, aty ku ka nevojë e rrit prezencën e vet dhe EULEX-i dhe t'ju informojë se në Mitrovicë, janë dy togje të njësive speciale operative të cilat në rast nevojë prej 5 deri në 15 minuta shkojnë në çdo pjesë të bëjnë sigurinë e plotë. Kjo nuk vlen vetëm për tri fshatrat: Kushtovë e Vllahisë, Cerajë dhe Bistricë, ku kalimi është pak më i ngadalshëm. Prandaj në ato pjesë më tepër ka marr përgjegjësi KFOR-i që të bëjë sigurimin e tyre.

Sigurisht që edhe unë i ndaj shqetësime e të tjerëve për të gjithë qytetarët të cilët janë peng të strukturave kriminale dhe kontrabandistëve të ndryshëm të cilët i mbajnë peng edhe komunitetin serb në veri por edhe komunitetet tjera. Ne do të bisedojmë me angazhimin më të madh me KFOR-in dhe EULEX-in që prapë të kemi një plan të përbashkët të veprimit dhe të gjejmë formën e heqjes së këtyre barrikadave për arsye se këta qytetarë që janë qytetarë të Kosovës, edhe një herë them janë peng të grupeve të interesit, qoftë kriminale, qoftë politike dhe kanë nevojë: për lëvizje të lirë, për shërbime shëndetësore, për shkollë, për furnizim me gjëra elementare, për përgatitje për sezonin dimëror dhe shumë të tjera. Pra, edhe një herë e përsëris se vendosja e funksionimit të plotë të pikës 1 dhe 31, me rolin udhëheqës të Policisë kufitare dhe të doganierëve, është një hap i madh drejt shtrirjes së sovranitetit të Kosovës, por është vetëm një hap i madh dhe sfidat ekzistojnë edhe më tutje, siç janë: vazhdimi i hetimeve, arrestimi i kriminelëve, çështja e kthimit të gjyqësorit, por këto janë tema të cilat në vazhdim, bashkë me partnerët ndërkombëtar do t'i përgatisin dhe do t'i realizojmë.

Edhe një herë them se nuk ka arsye objektive që disa qytetarë të disa fshatrave që shihen në televizion, që shprehin njëlloj frike ose një perceptcionit të frikës, ajo është çështje e perceptcionit personal, përndryshe arsye objektive për këto nuk ka. E monitorojmë gjendjen me kujdesin më të madh edhe gatishmëria është më e madhe. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së punës së Kuvendit, koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputetët për një mbledhje mund të parashtrojnë më së shumti dy pyetje parlamentare.

Fillojmë sipas rendit të parashtruar.

Deputeti Fadil Demaku, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Dardani nuk është këtu. Deputet, a doni ta bëni pyetje?

Fjala deputetit Fadil Demaku.

FADIL DEMA KU: I nderuar, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Mendoj se pyetja është me interes dhe do të ishte mirë që ta kem një përgjigje nga ministri. Konsideroj që ta bëjë pyetjen në seancën kur ai të jetë këtu. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Ministri na erdhi, mund ta bëni pyetjen, deputete!

TIME KADRIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Kur pacientët diagnostifikohen si të sëmur kancerogjen, pacientët janë të detyruar të marrin citostatikë. Ata për sigurimin e këtyre barërave me dokumentacion të plotësuar aplikojnë në Ministrinë e Shëndetësisë. Një prej sfidave që po ballafaqohen pacientët kosovar, është edhe siguri i citostatikëve, një terapi që kushton shumë, por në rast të mundësisë të mos sigurimit pacientëve kjo ju kushton me jetë.

Pyetja: A ka Ministria e Shëndetësisë databazë të të dhënave për numrin e pacientëve që kanë aplikuar në Ministrinë e Shëndetësisë për citostatikë, llojin e citostatikëve, në bazë të kësaj t'ju sigurohen pacientëve këto barëra ose, nëse i keni llogaritur sa është përqindja që pacientët të furnizohen me këtë terapi? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Keni të drejtë plotësisht, çështja e citostatikëve është shumë herë çështje me rëndësi vitale për shumë pacientë.

Në Republikën e Kosovës, administrimi dhe dispenzimi i preparateve citostatike, nga lista esenciale është i centralizuar dhe bëhet vetëm në Institutin Onkologjik të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe në të ruhet baza e shënimeve të vizitave dhe të trajtimeve të çdo pacienti.

Shënimet nga kjo bazë e shënimeve, tregojnë se në periudhën prej 28 dhjetor të vitit 2010 deri me 31 gusht të vitit 2011, në Institutin Onkologjik janë kontrolluar 7188 pacientë, prej tyre 5721 pacientë, të cilët kanë pasur nevojë për trajtim me preparate citostatike. Përqindja e furnizimit nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë rreth 80% nga preparatet në listën esenciale. Për këtë qëllim, Ministria e Shëndetësisë deri më tani në vitin 2011, ka shpenzuar rreth 3 milionë euro, që paraqet diku rreth 25% të mjeteve të përgjithshme për barëra në Kosovë.

Lista esenciale e citostatikëve përmban 57 preparate, shumica të cilat janë në dispozicion të pacientëve në përqindjen të cilën e përmenda më herët.

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë?
Regjia, fjalën deputetës Time Kadrijaj!

TIME KADRIJAJ: Në Ministrinë e Shëndetësisë, si zakonisht mungesa e citostatikëve është arsyetuar me tenderimin. Normal që është arsyetuar me tenderimin, sepse vetë stafi i lartë i Ministrisë së Shëndetësisë, ka bërë përzgjedhjen e tenderëve për furnizim me citostatikë dhe gjithmonë është zgjedhë kompania e cila nuk i ka plotësuar kushtet, por që është përzgjedhur nga vetë ministri ose sekretari permanent.

Kjo problematikë ka përfunduar nëpër gjykata, e si pasojë pacientët kanë mbetur duke pritur para dyerve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ministër, a është eliminuar kjo dukuri sot apo pacientët mbeten peng i politikave jo të mira qeverisëse të Ministrisë së Shëndetësisë apo politikave korruptive? Ju faleminderit!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete,
Pacientët janë kah mbesin peng të ligjeve jo të mira të cilat i nxjerrim në Kuvendin e Kosovës, konkretisht kur është fjala për Ligjin e prokurimit, i cili barërat i barazon edhe me material ndërtimor dhe i vë në kushte të njëjta. Rregullat e njëjta të prokurimit vlejnë si për materialin ndërtimor në Kosovë, ashtu edhe për barëra.

Procedurat e prokurimit janë të tilla, që kur respektohen në mënyrë strikte, e mundësojnë përsëritjen dhe zvarritjen e proceseve të procedurave të tenderëve dhe kjo ka pasojë të drejtpërdrejta për shëndetin e pacientëve. Ne si Ministri, jemi duke përgatitur propozimin për ndryshimin e Ligjit të prokurimit në këtë aspekt, ndonëse kjo nuk do të jetë e lehtë që të arrihet, por gjithsesi duhet siguruar kushtet të veçanta për prokurimin e medikamenteve, materialit harxhues medicinal, i cili do të respektoje specifikat e furnizimit me këto materiale të cilat janë shumë të nevojshme për jetën e qytetarit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Pa komente nga jashtë. Këtu pyetjet janë të deputetëve për Qeverinë.

Kuvendin e mbrojmë me punë, por na mbron Gjykata Kushtetuese.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjona, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

SAFETE HADERGJONAJ: I nderuar zoti kryetar,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Me ligjet që rregullojnë funksionimin e disa institucioneve të pavarura, është e rregulluar që pagat e këtyre zyrtarëve të lartë të këtyre institucioneve të rregullohen me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë publik. Ky ligj nuk ekziston dhe mungesa e bazës ligjore, ka sjellë konfuzitet në përcaktimin e pagave të zyrtarëve të lartë të institucioneve të pavarura, por edhe pakënaqësi të disa zyrtarëve të këtyre institucioneve.

Pyetja ime për ministrin e Administratës Publike, zoti Mahir Yagcilar, është se deri ku ka arritur Qeveria në hartimin e këtij ligji për pagat e zyrtarëve të lartë publik dhe kur pritet që ky ligj të sillet në Kuvend për miratim?

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zotëri kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarët që Qeverisë,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

E nderuara deputete, zonja Safete Haderegjonaj.

Së pari dëshiroj t'ju falënderoj për pyetjen e parashtruar në lidhje me Projektligjin për pagat e funksionarëve publik, por gjithashtu ndaj shqetësimet për vonesën në përcaktimin dhe kategorizimin e pagave si mungesë e legjislacionit adekuat.

Ju informoj se Ministria e Administratës Publike, ka përfunduar Projektligjin për pagat e funksionarëve, më konkretisht tani jemi në procesin e vlerësimit të ndikimit financiar të këtij projektligji nga ana e Ministrisë për Financa dhe pastaj do t'i dërgohet Qeverisë sipas procedurave, por gjithashtu është ligji i parashikuar edhe në strategjinë legjislative për vitin 2011.

Ne do të bëjmë përpjekje që projektligji të aprovohet në Qeveri dhe të procedohet në Parlament për aprovim. Vonesat në hartimin e projektligjit kanë ardhur si rezultat i nevojës për definimin e qartë dhe të qëndrueshëm të pagave të funksionarëve publik por gjithashtu, siç e dini projektligji ka qenë në shqyrtim në Qeveri edhe në vitin 2010, por është rikthyer në Ministri për plotësim.

Ministria e Administratës Publike, ka bërë përpjekje që projektligji të finalizohet dhe të përshtatet me standardet dhe praktikat më të mira evropiane, ku në këtë drejtim vlen të përsëritet përkrahjen e pa rezervë SIGMES, DIFIDIT përmes projektit PAIM. Disa nga çështjet për të cilat është konstatuar se ka nevojë të rishqyrtohen janë: pagat e funksionarëve të organeve të pavarura dhe anëtarëve të bordeve të tyre, nuk janë në harmoni me pagat e funksionarëve më të lartë të shtetit: si presidenti, Kryetari i Kuvendit e të tjerë, duke u bazuar në përgjegjësitë që kanë dhe orarin e punës që e mbajnë. Gjithashtu, gradat dhe koeficienti me të cilat kategorizohen kryetarët e komunave dhe kryesuesit e kuvendeve komunale, duhet të ndryshohen për shkak se kryetarët e komunave deri me tani marrin paga duke u bazuar një numrin e anëtarëve të asambleve komunale. Po ashtu duhet të kategorizohen gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë përfshirë në mënyrë të përgjithësuar në projektligj.

Çështja e pagave kompensimeve të funksionarëve publik, duhet të shqyrtohet me kujdes të shtuar, pasi deri me tani pagat e tyre janë paraparë me ligje të veçanta ose me ligje të ndryshme apo me akte të veçanta normative. Në këtë aspekt, janë koordinuar këto çështje, tash janë në fazën e vlerësimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë!

SAFETE HADERGJONAJ: Zoti ministër,

Në strategjinë legislative të cilën e ka sjellë Qeveria në Kuvend, është e paraparë që ky ligj të sillet në Kuvend, më datën 30 prill të këtij viti. Ne jemi në fazën përfundimtare, Qeveria faktikisht është në fazën përfundimtare të hartimit të buxhetit. Buxheti pritet që të vijë në Kuvend në fund të tetorit, do me thënë me 31 tetor.

Zoti ministër, janë afër 30 agjencion të pavarura ta cilat kanë borde regullative, ka borde mbikëqyrëse, e një numër i madh i këtyre bordeve të cilat duhet të përfshihen në buxhet dhe faktikisht nuk ke kurrfarë baze ligjore përcaktimin e pagave të tyre.

Ju e dini shumë mirë se çfarë konfuziteti është tek pagat e këtyre agjencive, sidomos tek pagat e bordeve dhe kryesuesit e bordeve. Më thuaj zoti ministër si ta caktojme pagën e Avokatit të Popullit, e cila plagë parashihet që të rregullohet në bazë të Ligjit për funksionarët e lartë publik.

KRYETARTI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Po, unë në fillim kam thënë që plotësisht i ndaj shqetësimet e juaja, sepse janë vërtetë probleme edhe për Ministrin edhe për Qeverinë, por besojmë që me një procedurë më të shpejtë që presim që të bëhet një vlerësim – ndikim financiar, të procedohet në Parlament dhe ku duhet vërtet të diskutojmë për këto çështje, të cilat janë gjithashtu të ndërlidhura edhe me, ndoshta për debat ta realizojmë edhe aprovimin e Rregullores për klasifikimin e vendeve të punës, kështu që të rrumbullakojmë edhe pagat edhe për shërbyesit civil, por gjithashtu edhe për funksionarët publik. Në këtë rast unë kërkoj ndihmë edhe përkrahje në këto çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputetja Afërditë Berisha- Shaqiri, pyetje për ministrin Blerand Stavilevci.

AFËRDITA BERISHA- SHAQIRI: I nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Një pjesë e konsiderueshme të vendbanimeve të Kosovës, sidomos ato që shtrihen në pjesën kodrinore-malore përballen me një zhvillim shumë të ulët ekonomik. Në këto zona bujqësia është e vetmja mundësi e krijimit të ardhurave për të siguruar mbijetesën. Në kërkim të burimeve më të sigurta të ardhurave, një pjesë e madhe e familjeve janë detyruar të lëvizin drejtë zonave urbane, ku mendohet se ofrojnë mundësi më të mëdha për një jetë më të mirë.

I nderuari, zoti ministër i Bujqësisë, çfarë ka bërë Ministria e juaj në të kaluarën me qenë se ju keni qenë ministër edhe në mandatin e kaluar për këto zona dhe cili është

plani juaj në të ardhmen, në mënyrë që t'u krijohet një perspektivë popullatës, respektivisht të rinjve të këtyre viseve që të mos vijë deri tek depopullimi i këtyre zonave duke krijuar një mbingarkesë të papërballueshme zonave urbane? Në fakt i nderuar ministër, në këtë problem përballlet komuna e Dragashit, komuna nga e cila vi unë dhe zonat e tjera kufitare.

Në komunën e Sharit, sipas disa të dhënave, shifra e papunësisë arrin deri në 60%, prandaj bujqësia është e vetmja alternativë e mbijetesës ku përmes kësaj, qytetarët e kësaj komune, domethënë komunës së Dragashit, por edhe zonave tjera kufitare sigurojnë ekzistencën.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Ju faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete,

Konsiderohet se rreth 60% e popullsisë së vendit tonë jeton nëpër zona rurale dhe meqë për shumicën e tyre, siç e keni potencuar edhe ju, bujqësia është e vetmja mundësi e krijimit të ardhurave, atëherë nënkuptohet se çfarëdo investimi që bëhet në këtë sektor, ndikon në mënyrë direkte apo indirekte në krijimi e kushteve më të mira për jetesë dhe në rritjen e të ardhurave për këta banorë, duke ndikuar edhe në mirëqenien dhe zvogëlimin e fluksit të migrimit prej zonave rurale në ato urbane.

Ministria e Bujqësisë, siç mund ta dini, prej vitit 2008, ka filluar ta mbështesë këtë sektor në mënyrë direkte nëpërmjet granteve investive dhe subvencioneve ku për vitin e kaluar, përveç mbështetjes së përgjithshme në ngritjen e sipërfaqeve të reja me pemë e perime, mbështetjes në përmirësimin e mekanizmit bujqësor, në ristrukturimin e fermave blektorale dhe të tjera, kemi implementuar edhe nën masën për përkrahje të zhvillimit të komuniteteve lokale, të cilën e kemi realizuar nëpërmjet grupeve lokale të veprimit...

Pra, për t'i zvogëluar dallimet në mes të zonave rurale dhe urbane, kemi mbështetur edhe projektet publike dhe ato private që ndikojnë në përmirësimin e standardit jetësor të komuniteteve nëpër zona rurale, ku gjithsej janë mbështetur 13 projekte, që si qëllim kryesor, kanë pasur plotësimin e nevojave të komunitetit dhe ngritjen e standardit të tyre jetësor. Ndërkaq, sivjet përveç mbështetjes direkte që arrin shifrën në mbi 7.4 milionë euro, grante investive dhe subvencione për sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural, në proces të implementimit janë edhe 15 projekte të miratuara pra të këtyre grupeve lokale të veprimit, në vlerë prej rreth 150 mijë euro, të cilat Ministria e Bujqësisë, i mbështetë deri në shkallën 70% të participimit.

Si investime të pranueshme për këtë nën masë kanë qenë rregullimi i infrastrukturës në oborre shkollore, rregullimi i parqeve të ndryshme, i shtratit të lumenjve dhe kanaleve të ujitjes, rregullimi i ndonjë ure me interes të përgjithshëm, rregullimi i rrugëve rurale dhe fushore me karakter të përdorimit të gjerë e të tjerë. Po ashtu për ta parandaluar

migrimin e popullsisë nga zonat rurale në ato urbane, në bashkëpunim të ngushtë edhe me komunat e vendit tonë, nëpërmjet investimeve kapitale, në masë të madhe i mbështesim edhe projektet që adresojnë prioritetet e zhvillimit lokal-rural. Këto investime në këtë vit arrijnë rreth 2.5 milionë euro. Gjithashtu, bazë e secilit plan strategjik dhe zhvillimor në fushat që mbulojmë, është krijimi i mundësive të reja për vende pune nëpër zona rurale si dhe zvogëlimi i dallimeve që tashmë është evident midis rajoneve të ndryshme rurale dhe urbane të vendit, prandaj përveç mbështetjes së deritashme, e cila do të vazhdojë të rritet edhe më shumë gjatë viteve që vijnë, për ta parandaluar migrimin e popullsisë nga fshati në qytet, do të vazhdojmë të rrisim edhe më shumë përkrahjen financiare...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Deputete, e ke fjalën!

AFËRDITA BERISHA -SHAQIRI: I nderuar ministër, Fjala është për zonat e thella kufitare, të cilat vazhdimisht janë të rrezikuara nga zbrazja e popullsisë. Ju sigurisht keni dëgjuar për fonde, ministrja e juaj duhet të ketë pasur projekte të veçanta për këto zona. Keni dëgjuar për fondin IFD, fond ndërkombëtar për zhvillimin e bujqësisë. Mirëpo, me qenë se Ministria e juaj ka një shumë të caktuar të subvencioneve, a mund të na thoni cilat janë kriteret dhe standardet e ndarjes së këtyre subvencioneve që unë shpresoj të mos jenë politike dhe konkretisht çka do të përfitojnë këto komuna, do me thënë zonat kufitare nga këto subvencione.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI BLERAND STABILEVCI: Pyetjen, kur ma parashtuat, unë ju mbeta borxh me qenë se nuk e kam pasur në pjesën e shkruar për komunën e Dragashit. Ne mundemi t'ju sigurojmë shumë të dhëna edhe për komunën e Dragashit, se sa është mbështetur por edhe për këtë që ju pyesni, duhet ta dallojmë këtë pjesë në përthithësi të zonave rurale dhe zonat rurale të ashtuquajtura ELEFEJ, nga shkurtesa në anglisht, pra zona më pak të favorizuara që përfshinë pikërisht zonat e thella dhe, edhe në kuadër të kësaj, ne me riorganizimin e ri të ministrisë, në kuadër të Departamentit të politikave, do ta kemi një divizion të veçantë pra për këto zona më pak favorizuese, që të gjitha këto qoftë në formë direkte, qoftë në formë indirekte, do të jenë pjesë e programeve me projekte të caktuara investive. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Deputeti Hashim Deshishku, pyetje për ministrin Bedri Hamza.
Bedriu na ka njoftuar se nuk është këtu. Nuk e do fjalën, vazhdojmë.

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Vlora Çitaku.
Deputete, e keni fjalën!

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!

Në publikimin plani i veprimit 2011 për implementimin e partneritetit evropian në Kosovës, gjegjësisht nën pikën 3 zbatimi i planit të veprimit për partneritet evropian 2010 dhe adresimi i sfidave të raportit të progresit, e më saktësisht nën pikën 3.2.1 të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteve thuhet: “gjatë vitit janë kthyer 1600 pjesëtarë të komunitetit pakicë, përdërisa parcelat e tokës u janë shpërndarë të kthyerve të pa pronë si dhe mbahet linja e autobusit pa pagesë për komunistin jo shumicë”. Zonja ministre, mu lutem na tregoni se ku janë këto prona për të cilat po flisni në këtë publikim.

KRYETARI: Mminstre, e keni fjalën!

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Ju faleminderit shumë!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

E nderuara deputete Haxhiu,

Para se të ofroj përgjigje në këtë pyetje, më lejoni t’ju informoj rreth mënyrës së hartimit të planit të veprimit për implementimin e partneritetit evropian, dokument ky kyç i institucioneve të Republikës së Kosovës, në kuadër të procesit të integritit evropian dhe dokument që ju jeni referuar në pyetjen tuaj si publikim.

Ky plan ngërthen në vete masat që planifikon Kosova për të adresuar kërkesat që dalin nga procesi i integritit evropian për Kosovën, kryesisht përmes instrumenteve të bashkimit evropian për zgjerim, siç janë Partneriteti evropian, studimi për Kosovën, raporti i progresit si dhe dialogu i procesit të stabilizim asociimit.

Gjatë kohës së rishikimit vjetor të këtij plani, duke u bazuar në këto dokumente, Ministria e integritit evropian koordinon planifikimin e masave që institucionet relevante parashohin për adresimin e sfidave të identifikuara nga mekanizmat e përmendura. Në këtë drejtim, adresa e saktë për raportim në kuadër të zbatimit të masave të parapara me planin e veprimit për implementimin e partneritetit evropian, janë institucionet përgjegjëse të parapara në të njëjtin plan dhe jo Ministria e Integritit Evropian. Për shembull PVP-ja e këtij viti përmban 400 veprime, në të cilat janë të përfshira 44 institucione implementuese, përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës me 6 veprime. Sidoqoftë unë do të përgjigjem shkurtimisht në pyetjen tuaj edhe pse për detaje, duhet të adresoheni tek Ministria për Kthim dhe Komunitete. Parcelat toke janë ndarë për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komunat, si më poshtë: në komunën e Gjakovës, Gjilanit, Kamenicës, Pejës, Vitisë dhe kryesisht për të kthyerit e komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptas.

Në anën tjetër, në drejtim të mundësimit të kësaj mase, procedurat janë filluar edhe nga komuna e Ferizajt dhe Istogut. Po ripërsëris Ministria për Integrit Evropian, vetëm koordinon procesin e integritit evropian, po e them prapë për PVP-në e këtij viti janë 400 veprime dhe 44 institucione implmentuese dhe për detale dhe për hollime të mëdha, ju lus që të adresoheni tek mekanizmat relevant implementues.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë? Regjia, ju lutem fjalën deputetes Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: U thanë që për detalet duhet pyetur Ministria për Kthim dhe Komunitete, mirëpo besoj që edhe ju duhet të informoheni për këto çështje për shkak se është në plan të veprimit. Ajo pronë besoj se është publike edhe një pyetje shitesë është, se me çfarë të drejte ju shpërndani pronat Kosovës qytetarëve të Kosovës, vetëm pse nuk janë shqiptarë, domethënë kjo nuk është e qartë? Po dua të informohem në lidhje me këtë çështje.

KRYETARI: Ministre, vazhdoje!

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: E nderuara deputete,

Nuk është Qeveria e Republikës së Kosovës ajo që shpërndan prona, duhet të ripërsëris, janë institucionet komunale dhe me ligjet tjera rregullohet e drejta e pronës publike ndërkohë që përmbushja e kriterëve politike që dalin nga kriteret e Kopenhagenit, është parakusht për procesin e integritimeve evropiane. Në këtë sfond, trajtimi i komuniteteve joshumicë është prioritar dhe ne kemi për detyrim që qytetarëve joshqiptarë të Kosovës t'u ofrojmë mundësi jetese në Kosovë. Prona janë ndarë edhe për qytetarë shqiptarë. Është shumë jokorrekte të thuhet që pronat janë ndarë ekskluzivisht mbi parametra etnik. Shumë shqiptarë anekënd Kosovës kanë përfituar nga ndarja e parcelave apo objekteve të banimit, që institucionet publike kanë ndërtuar për ta.

KRYETARI: Faleminderit ministre, se u kryen!

Deputeti Glauk Konjufca, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit!

Ministër, në pjesën veriore të Kosovës jetojnë mbi 4.000 shqiptarë dhe siguria e tyre përgjatë tërë këtyre viteve të pasluftës është rrezikuar vazhdimisht. Në javët e fundit gjendja në pjesën veriore të Kosovës është rënduar tej mase dhe qytetarët, prandaj vazhdojnë, qytetarët shqiptarë e kam fjalën, vazhdojnë të mbesin të kërcënuar nga strukturat e paligjshme të Serbisë.

Pyetja ime është: Çfarë masash të sigurisë konkrete keni marrë për mbi 4.000 banorët shqiptarë, që jetojnë në veri? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

BAJRAM REXHEPI: I nderuari kryetar i Kuvendit,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari deputet Konjufca,

Pak a shumë, në këtë informatë unë i dhashë disa të dhëna në lidhje me atë çka kanë ndërmarrë institucionet e Kosovës për sigurinë e këtyre banorëve. Sa për informimin tuaj, 4.000 banorë në pjesën veriore, mendohet të jenë vetëm këto 3 fshatrat: Vinarc, Gushavc, Suhodoll dhe Vidimriç, bashkë me Lagjen e Boshnjakëve dhe 3 Rrokaqiejve dhe me

Kodrën e Minatorëve. Pra, janë të dhëna të përafërta. Përndryshe, në fshatrat tjera, në komunat tjera ka edhe më tepër banorë shqiptarë. Realisht, për në të kaluarën nuk po flas, po nuk qëndron ajo që thoni ju se situata e sigurisë është më e keqe. Përkundrazi, situata e sigurisë për këta banorë është në nivelin e duhur, përveç që në Lagjen e Boshnjakëve, gjithnjë për shkak të natyrës multietnike të grupeve të ndryshme që veprojnë, ku gati çdo individ e njohim edhe personalisht, mund të tensionohet gjendja prej momentit në moment, por në këto raste ne kemi më tepër patrulla të policisë, më tepër prezence të EULEX-it dhe KFOR-it, ndërsa për këto fshatrat tjera, ku edhe në Suhodoll, Vidimriç, Gushavc, Vinarc ka patrullime të kohëpaskohshme, por absolut s'ka kurrfarë rrezikimi të këtyre qytetarëve, qasjen e kanë të lirë komplet. Edhe një pjesë që është më e ndjeshme dhe ka qenë vazhdimisht, është Kodra e Minatorëve, ku aty janë pak më të izoluar, mirëpo aty është gjithnjë një prezencë më e madhe e patrullimeve, qoftë edhe e përfaqësuesve të EULEX-it dhe me kërkesën për ndonjë tensionim të gjendjes aty, përgjigja nga këto struktura që i përmenda është shumë e shpejtë.

KRYETARI: Deputet, pyetje shtesë? Urdhëro, e ke fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Ministër, nëse situata e sigurisë për ata shqiptarë qenka krejt në rregull dhe krejtësisht e qetë, atëherë si e shpjegoni ju faktin që aq shumë shqiptarë nga atje i janë drejtuar me letra vazhdimisht Qeverisë së Kosovës për më shumë siguri? A e kanë ata gabim që po kërkojnë më shumë siguri, nëse qenka gjithçka në rregull?

E dyta, pse qytetarët po iu drejtohen vazhdimisht mediave për të treguar se ata jetojnë në një pasiguri totale atje?

Dhe, unë ju kuptoj juve që thoni se siguria atje nuk është problematike, sepse vetë nuk jeni në lëkurën e tyre. Bile, moti nuk jetoni as atje, në shtëpinë e juaj që e keni pasur, do të thotë, dhe, jetoni shumë komod në Prishtinë, por kjo nuk do të thotë që shqiptarët atje janë të sigurt. Dhe, unë shpreh shqetësimin me këtë rast që Qeveria nuk ka aplikuar një metodë efektive për mbrojtjen e shqiptarëve atje, që është hapja e nënstacioneve policore nëpër fshatrat shqiptare. Pse nuk e keni bërë këtë gjë?

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

BAJRAM REXHEPI: Sa për informimin tënd, unë jam çdo vikend dhe këta një muaj e gjysmë gati çdo ditë kam qenë në shtëpinë time në Suhodoll, ku në vi ajrore nuk i kam 700 metra dhe them me përgjegjësinë më të madhe se siguria është e plotë dhe vazhdimisht qarkulloj nëpër këto pjesë që ti i përmende, dhe, pse disa individë drejtohen me letra... Natyrisht, është në natyrën e njerëzve, të gjithë nuk e kanë të njëjtën konfidencë, siguri. Dikush ka perceptione psikologjike, diku për arsye politike, dikush i ngacmon, gazetarët kanë qejf gjithmonë të kenë storie dhe vetëm të dalë në gazetë, ai i thotë edhe do sende që nuk qëndrojnë. Dhe, ne si institucion i ndërmarrim masat që duhet ndërmarrë. Sa u përket stacioneve nëpër këto fshatra, nuk janë të domosdoshme, për arsye se nuk janë shumë funksionale. Shumë më funksionale janë patrullimet e shpeshta dhe, natyrisht, kjo është çështje operative, që ne këtë lëmi e dimë më mirë dhe nuk kemi nevojë për ta implementur atë.

Ndërsa, sa u përket 3 fshatrave: Koshtovë, Vllahi, Cerrajë dhe Bistricë, atje do të bëhet nënstacioni policor, për arsye se ata janë mënyrë më specifike. Edhe një herë po them, realisht, nuk ka kurrfarë arsye për frikë të këtyre qytetarëve, por nëse dikush frikën e ka brenda vetit, aty duhet gjetur metoda alternative, ndonjë hajmali të fortë ndoshta prej ndonjë hoxhe.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë! Deputeti Liburn Aliu, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

LIBURN ALIU: Meqë pak më parë patëm prezantimin nga ministri Rexhepi, shumë çka u përmend, po jo ajo çka unë do të doja të bëja pyetjen, pra bëhet fjalë për shtrirjen e sovranitetit dhe agjendën kush vendos agjendën në këtë pikë?

Pra, duke qenë të vetëdijshëm për thirrjen që i është bërë KFOR-it dhe EULEX-it që të veprojnë kundër këtyre strukturave ilegale të Serbisë në veri, pyetja ime është: Nëse KFOR-i dhe EULEX-i nuk veprojnë siç duhet dhe siç duam ne, cilat masa do t'i ndërmarrë Ministria e Brendshme për ta vënë sovranitetin në veri?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar deputet Aliu!

Realisht, ne e dimë se në 12 vjetët e kaluara ka pas pak lëvizje, qoftë nga ndërkombëtarët, qoftë nga institucionet tona. Tash edhe një herë them se është bërë një hap i madh me vendosjen e pikave kufitare, funksionalizimin dhe me shtrirjen si një njësi doganore dhe policore, natyrisht me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, me një plan të përbashkët dhe sigurisht që duhet ta shfrytëzojmë edhe prezencën e tyre, t'i koordinojmë gjërat, në mënyrë që të kemi edhe një mbështetje më të gjerë ndërkombëtare për të drejtën tonë legjitime dhe legale.

Më në fund, kjo ka mbërri me deklaratimet edhe të kancelares Merkel, të përfaqësuesve të Unionit Evropian, të Shteteve të Bashkuara e tjerë, dhe është një pozicion shumë më i favorshëm i Kosovës që ta shtrijë ligjshmërinë edhe në pjesën veriore.

Natyrisht, të vetëdijshëm se ka edhe shumë sfida dhe pak e preka që duhet të kthehet edhe Gjyqi i Qarkut në pjesën veriore, duhet të lirohen ata qytetarë nga kriminelët, nga politikanët ekstrem që inkurajojnë dhunë. Këta janë hapat e ardhshëm që do t'i koordinojmë bashkërisht me faktorin ndërkombëtar. Në rast se, po them hipotetikisht, faktori ndërkombëtar nuk i përmbushë këto marrëveshje tonat të përbashkëta dhe mandatin e tyre nuk e implementon në vendosjen e sigurisë dhe rendit e ligjit bashkërisht, atëherë ne e kemi obligim kushtetues dhe me kapacitetet tona, që i kemi në dispozicion, ne do të veprojmë.

Mirëpo, edhe një herë them, më mirë është që të bëhen hapa të ngadalshëm, të sigurt, gjithnjë përpara, se sa të marrim ndonjë hap të pa analizuar mirë dhe të kthehemi dy-tre hapa mbrapa. Deri tash kjo është duke funksionuar mire dhe s'kemi arsye ta ndërrojmë,

pra bashkë me partnerët ndërkombëtarë priten edhe jo javë, po edhe muaj, ndoshta edhe vite, që të vendoset plotësisht edhe ligjshmëria dhe të fillojë integrimi i atyre qytetarëve në institucionet demokratike dhe në proceset demokratike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, pyetje shtesë? Apo... u plotësua norma!
Deputeti Liburn Aliu, pyetje shtesë!

LIBURN ALIU: Duke qenë të vetëdijshëm për politikën e EULEX-it, që aplikon në Kosovë, në raport me Kosovën, në raport me të kaluarën e Kosovës, në raport me identitetin e Kosovës dhe identitetin shqiptar dhe duke marrë për shembull sjelljen e dy policëve dje, që është injoruar edhe nga mediat, dy policëve të EULEX-it, të cilët kanë provokuar në Urën e Ibrit, me elemente serbe, duke i ngritur tre gishta e këso gjërash, pra, personalisht duke shprehur një mosbesim, nga që EULEX-i do të mund të vepronte diçka, do të doja të di më saktë për planin operacional. A vepron Policia e Kosovës, ministria juaj në plan, me një plan operacional të EULEX-it, sepse duke u nisur prej deklarimit të juaj për heqjen e barrikadave, kjo më shumë, ju e bëni atë si një lloj parashikuesi, se sa si një lloj ekzekutori i këtij. Pra, a është ministria e Kosovës në një plan ndërkombëtar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

BAJRAM REXHEPI: Realisht, ju e dini se me aksionin e 25 korrikut EULEX-i s'ka qenë pjesë e planit, për arsye se ka refuzuar dhe kanë mbetur anash, ndërsa në këtë plan të përbashkët operacional, të gjitha subjektet e përmendura kanë qenë të prezantuara, secili e ka pasur të drejtën e vet për t'i bërë vërejtjet dhe secili ka përgjegjësitë e veta. Deri tash, edhe ata janë partnerë që e kryejnë punën e vet ashtu siç është paraparë. Në këtë rast, e bëjnë transportin. Shpesh po thuhet, me të KFOR-it, bëhet me të EULEX-it dhe përfaqësuesit e EULEX-it janë po ashtu në pikën 1 dhe 31, ku e bëjnë pjesën operacionale të obligimeve. Natyrisht, që brenda EULEX-it ka edhe individë të caktuar, që bien ndesh me politikën e EULEX-it, si ishte rasti i atyre dy policëve, mirëpo ata e kanë një lloj imuniteti ndërkombëtar dhe me këtë rast merret vet EULEX-i me ta. Nuk i nënshtrohen ligjeve tona. Ne mund të dëshirojmë, por realiteti është i tillë. Dhe, natyrisht që ne nuk jemi pjesë e planeve të EULEX-it, këtë dua ta bëjë të qartë që ne jemi udhëheqës të proceseve dhe mundemi vetëm në partneritet të jemi, asnjëherë nuk futemi tash në agjendë të EULEX-it. Ata mund të jenë këshillëdhënës, monitorues dhe partnerë në implementim, por në asnjë mënyrë udhëheqës të proceseve dhe të obligimeve që dalin për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit ministër!

Për hir të qytetarëve që kanë shqetësime, frika është njerëzore dhe organet e pushtetit janë për t'u garantuar siguri atyre.

Vazhdojmë me pyetjen vijuese. Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Ferid Agani, ministri shkoi. Doni ta bëni pyetjen, deputete?
Fjala për deputeten Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Unë po e bëj pyetjen, ministri ishte këtu. Sigurisht nuk ka pasur përgjigje për ata edhe ka shkuar, se ishin në pyetje 5 minuta kohë.

Pyetja është kjo: U përmend edhe më herët nga kolegja ime që ministri ka nënshkruar kontrata kolektive sektoriale për pagesa të kujdestarive, por në Ligjin e buxhetit të vitit 2011, nuk ka mjete të ndara për këtë qëllim. Andaj, pyetja është se nga po merren këto mjete për pagesa të kujdestarive dhe sa gjatë do të vazhdojnë të paguhen kujdestaritë, kur dihet se nuk ka buxhet të planifikuar për një gjë të tillë?

Meqenëse ministri nuk është këtu, unë po e bëj një koment tash këtu, një auto përgjigje. Kjo s'është gjë tjetër, vetëm se një koncesion i radhës i koalicionit qeverisës, i cili që nga fillimi që një pazar i madh, ku akterët e koalicionit po sillen si tregtarë të denjë kur po vendosin për qytetarët, mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, sikur ata të ishin pemë dhe perime! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Nenad Rashić.

HYKMETE BAJRAMI: Pyetja është se në Buxhetin e vitit 2011, për pensionet në këtë vit janë ndarë rreth 7.9 milion më shumë se në vitin 2010. Kjo kategori vazhdon të marrë të njëjtat pensione sikurse në vitin 2010.

Çka po ndodhë me pensionet, kur dihet se në Buxhetin e këtij viti janë ndarë të holla për rritjen e pensioneve bazike dhe atyre kontributdhënëse, rritje të cilat është dashur të implementohen që nga muaji korrik?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Hvala, poštovani predsjedniče!
Kolege ministri,
Dame i gospođo narodni poslanici,
Gospođo Bajrami,

Tačno je da imao jedan... i planiranje budžeta prošle godine je bilo usmereno ka jednom povećanju, koje je trebalo zakon da donese. To je bilo planirano od 1 jula ove godine, ali do toga još nije došlo zbog jednog osnovnog elementa ...

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

NENAD RAŠIĆ: Zbog prvog i osnovnog elementa, koji je bio da bez Zakona odnosno bez usvajanja Zakona ne može doći do nikakvog povećanja. A drugi najbitniji faktor je bilo i potpisivanje pisma o namerama, letër e qëllimit, koje je bilo potpisano u martu.

Prema tome, prema samom tom dokumentu koji je potpisan od strane premijera, se kaže da će svaki zakon, a po gotovu zakoni koji imaju velike finansijske udarce ili impakte na budžet će biti pre svega tehnički podržani, u stvari pardoniram, tehnički pripremljeni od strane Vlade, tehnički podržani od strane Svetske banke, i na kraju finansirani, odnosno odobreni od strane Međunarodnog monetarnog fonda. Tako da smo mi naš deo tehničke primene zakona uradili već davno. Svetska Banka je već dva puta imala neke svoje sugestije. Najbitnije je da je na zadnjem sastanku, koji je održan u petak, posle našeg izlaganja promena unutar zakona, oni faktički nisu imali nikakav drugi komentar, tako da ja mislim sa ovim zadnjim promenama, koje smo mi napravili u zakonu, da će Svetska banka biti zadovoljna, da će do kraja ove nedelje potvrditi zajedno sa nama Međunarodnom monetarnom fondu da je zakon u redu i samim tim će Međunarodni monetarni fond da potvrdi da je to sa finansijske, odnosno fiskalne strane zadovoljavajuće i da zakon možda bude osvojen, odnosno da prođe kroz proceduru u Vladu i posle toga dođe kod vas u Parlamentu.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, ke pyetje shitesë? E ke fjalën!
Deputetja, pyetje shitesë!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit! Pensionistët janë kategoria më e prekur e shoqërisë. Këta janë rreth 140.000 veta. Me inflacionin, i cili ka ndodhur, dhe me ngritjet që janë premtuar, do me thënë me këto rreth 8 milionë, pozita e tyre nuk përmirësohet aspak. Kjo shtyrje e ligjit është bërë me qëllime të caktuara, se duhet të kursehen rreth 60 milionë deri në fund të vitit për hir të Fondit Monetar Ndërkombëtar, për ta ruajtur marrëveshjen në të cilën gjendemi tani. Kështu që, ju premtuat që ligji do të vijë së shpejti në Kuvend. Pyetja ime është: A do të paguhet në mënyrë retroaktive, apo do të ndodhë sikur me pagat, sepse këto para janë nda që nga korriku? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër?

NENAD RAŠIĆ: Ne, neće biti retroaktivnog plaćanja. Zakon će ući na snagu onog momenta posle potpisivanja predsednika Skupštine, kao što je i predviđeno. Ja moram da kažem da i samim pregovorima, koje smo imali prošle godine, u vezi sa tim povećanjem o kome smo pričali više puta, verujte mi, da kažem bukvalno, razvukli čmo da to bude do nekih 20 miliona povećanja godišnje. Kad kažem da to povećanje obuhvati sve kategorije unutar 20 miliona. Prva preporuka, odnosno insistiranje MMF-a, Međunarodnog monetarnog fonda je bila da to bude na 15 miliona, pa smo mi nekako organizovano napravili zajedno sa Ministarstvom financija na 20. Više od toga, verujte mi da ne možemo sebi da priuštimo. Ali ono što je dobra stvar u ovom novom zakonu, da će biti predviđeni i porodične, odnosno penzije koje se nasleđuju, a takođe biće predviđene i penzije za invalide rada, ili penzije za ljude koji su na svojim radnim mestima povređeni, pa su zbog tih posledica postali penzioneri i sada imaju potrebe da budu podržani. A znam da možda želje penzionera jesu veće, ja sam konstantno imao sastanke sa njima i dalje ih imam, ali verujte mi i vi, a tražim i od penzionera da mi veruju, da je bolje imati zakon jedan koji će da reguliše status penzionera, nego stalno insistirati na enormno povećanje koje naš budžet ne može da podnese. To je moja preporuka i kao iministra i ljudska da budžet neće moći da podnese ukoliko insistiramo na veliko povećanje. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit, do të thotë këtë e thotë neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së punës së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e 3-të të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 29 dhe 31 gusht 2011

Lus deputetët të kthehen. Në sallë kemi prezentë fizik 58, ndërsa me kartela 98. Pasi që duhet votime, duhet të presim. Prezentë janë aktualisht 61 deputetë.

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e mbledhjeve të 29 dhe 31 gushtit 2011?

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 29 dhe 31 gusht 2011.

Vazhdojmë me pikën e 4-të të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni ka nxjerrë një raport, të cilin tashmë besoj e keni para jush. Dëshiroj fillimisht t'i falënderoj anëtarët e komisionit, të gjithë pa dallim, dhe deputetët tjerë që herë pas here kanë marrë pjesë në punën e këtij monitorimi, në procesin e monitorimit të Ligjit për minierat dhe mineralet, është fjala për disa prej vizitave që janë zhvilluar në lokalitetet prej nga vijnë disa deputetë.

Është ky një veprim jashtëzakonisht i mirë në funksionim të monitorimit të zbatimit të ligjit, dhe po ashtu, besoj që konkluzionet dhe rekomandimet që kemi nxjerrë ose do t'i aprovojmë në Kuvend, do të shërbejnë në të mirë të përmirësimit në përgjithësi të funksionimit të këtyre institucioneve dhe të ngritjes së cilësisë së zbatimit të këtij ligji.

Më lejoni t'i përmend disa prej konkluzioneve dhe rekomandimeve, në një rën anë, dhe në anën tjetër disa prej rritjeve dhe progreseve që është theksuar në kuadër të këtij monitorimi dhe po ashtu, në fund, disa prej sfidave, që konsiderojmë janë të rëndësishme.

Duke marrë parasysh të gjeturat nga takimet zyrtare dhe vizitat në teren, grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet ka arritur t'i identifikojë disa prej çështjeve që konsiderohen si më të rëndësishme, që kanë të bëjnë kryesisht me plotësimin e ligjit, të legjislacionit sekondar dhe me disa prej çështjeve që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve që veprojnë në përputhje me këtë ligj.

Ky ligj është konsideruar që është i zbatueshëm, por ka disa prej pengesave, për çka edhe duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshim të gjendjes dhe për këtë Komisioni njofton Kuvendin se do të marrë iniciativë për hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Njëkohësisht, grupi punues propozon edhe disa rekomandime, të cilat në vijim do t'i përmend.

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik hartoi dhe dorëzoi Kuvendit të Kosovës strategjinë minerale për shqyrtim dhe miratim në afatin prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik themeloi Institutin gjeologjik në afat prej 6 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik themeloi Muzeun shtetëror të kristaleve dhe mineraleve në afat prej 6 muajsh prej miratimit të këtyre rekomandimeve.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik nxjerr aktet e nevojshme nënligjore, siç e detyron Ligji për minierat dhe mineralet, në afat 3 muaj.
- Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore, siç e detyron Ligji për minierat dhe mineralet, në afat prej 3 muajsh.
- Komisioni i pavarur për Miniera dhe Minerale të hartojë strategji për ndërprerjen e punës së subjekteve që ushtrojnë veprimtari ilegale në fushën e mineraleve dhe këtë strategji t'ia ofrojë Kuvendit në afatin prej 3 muajsh nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
- Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë dhe të përfshijë strategjinë legjislative për vitin 2012, Projektligjin për mbetjet minerale.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor çdo 6 muaj t'i sjellë Kuvendit raport të sintetizuar me shkrim në lidhje me ndikimin e mjedisit, shfrytëzimit të mineraleve, veprimtaritë e subjekteve publike dhe private.

Këto ishin rekomandimet zyrtare që ne i kemi nxjerrë. Më lejoni që t'i përmend disa prej çështjeve që janë theksuar si progres. Do t'i mbeteshim borxh, sidomos KPMM-së, por edhe institucioneve tjera, ministrive përkatëse të Qeverisë, pa e përmendur një pjesë të progresit që theksohet edhe në anën legjislative. Me nxjerrjen e disa akteve nënligjore dhe një pjesë e të cilave mbetet për t'u kryer, një bashkëpunim në mes të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si bashkëpunim që kemi konsideruar që është i kënaqshëm dhe mbetet për t'u vazhduar.

Është inkurajues fakti dhe njoftimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se është duke u përgatitur një vendim që të ndalojë eksploatimin e rërës dhe zhavorrit nga lumenjtë, ku me këtë vendim do të përcaktohen përgjegjësitë e secilit institucion që ka përgjegjësi për eliminimin e këtij problemi.

Po ashtu, është inkurajuese edhe informata, që bashkë me Komisionin Evropian ose në mbështetje të Komisionit Evropian është një projekt për monitorimin e ndotjes së ajrit dhe janë vendosur 5 stacione monitoruese në pikat e ndryshme të territorit të vendit.

Po ashtu, pjesë e këtij projekti ka qenë edhe një stacion mobil për monitorimin e cilësisë së ajrit, i cili është realizuar, kurse në vitin 2012 ka informata se do të mbulohen me stacione për monitorimin e cilësisë së ajrit edhe në pjesë tjera.

Po ashtu, inkurajuese është nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të komunave dhe KPMM-së. Pasi që kemi përfunduar këtë monitorim të zbatimit të këtij ligji, po ashtu dëshiroj t'ju njoftoj se ka pasur një aktivitet, që është shumë interesant. Një konference ndërkombëtare me investitorë potencial dhe kjo është po ashtu në përputhje dhe në mbështetje të Komisionit Evropian dhe projektit të tyre të mbështetur, që ka të bëjë me nxjerrjen e një pasqyre të plotë për pasuritë nëntokësore të Kosovës dhe, bazuar në këtë, është organizuar një konferencë ndërkombëtare ditëve që i lamë pas.

Dhe, krejt për fund, më lejoni t'i përmend disa prej sfidave që konsiderojmë që janë serioze dhe janë përmendur edhe nga anëtarët e komisionit, grupit punues dhe në takimet e shumta që kemi pasur me institucionet përgjegjëse të zbatimit të këtij ligji.

Pra, sfida mbetet gjendja e rëndë e lumenjve nga eksploatimi ilegal i rërës si dhe lumenjve afër tyre, pastaj trajtimi i mbetjeve minerale, edhe pse kemi pasur aktivitete të Qeverisë në këtë drejtim, kjo mbetet po ashtu një sfida e rëndësishme.

Mundësia e përfitimit të komunave nga shfrytëzimi i pasurisë minerale, nga takimi që kemi pasur me përfaqësues të komunave del si kërkesë dhe si shqetësim ose si nevojë që të trajtohet në përputhje me ligjin ose në përputhje edhe me nevojat që kanë komunat, në mënyrë që të trajtohen shfrytëzimi ose benifitet që mund t'i kenë komunat, dhe po ashtu edhe një çështje që ka të bëjë edhe me ndotjen në territorin e komunave.

Një çështje tjetër, si sfida mbet numri i madh guroreve në distanca të shkurta në mes tyre dhe pastaj rehabilitimi i sipërfaqeve dhe kthimi i tyre në gjendjen e mëparshme. Ju keni

pasur dhe keni mundësi të shihni hapësira që janë të shëmtuara, si rezultat i mostrajtit të këtyre ambienteve pastaj nga shfrytëzuesit.

Çështje tjetër që unë e përmenda në rekomandim, është plotësimi dhe ndryshimi i ligjit. Përveç rekomandimit, ne kemi bërë disa hapa bashkë me institucionet përkatëse që kjo iniciativë të dalë jo vetëm nga komisioni, por e përbashkët me institucionet tjera përgjegjëse.

Një çështje sfiduese tjetër që mbetet pengesë serioze për angazhimin konkret të Komisionit për Miniera dhe Minerale, është mosbashkëpunimi i mjaftueshëm ose mosmbështetja e mjaftueshme e organeve të drejtësisë dhe të policisë kur është fjala për trajtimin e lëndëve me organet e drejtësisë dhe po ashtu për pengimin e operatorëve ilegalë. Dhe, në këtë plan kemi evidencuar po ashtu një pamundësi të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që t'i konfiskojë pajisjet që përdoren gjatë operimit ilegal.

Unë mendoj që këtu duhet të kyçen seriozisht edhe Ministria e Drejtësisë dhe e Punëve të Brendshme. Kemi raste ku ata që duhet t'i transportojnë këto pajisje, përpos atyre vështirësive financiare, ka edhe vështirësi tjera që lidhen me mosmarrjen e rrezikut të kompanive të ndryshme ose të operatorëve të ndryshëm të cilët mund të kontraktohen, mosmarrja e rrezikut në transportimin e këtyre makinave ose pajisjeve që veprojnë ilegalisht.

Dhe, po ashtu, është një sfidë vonesa e vendimit të Qeverisë, meqenëse për ndalimin e këtyre operatorëve tash kemi marrë informatën nga Ministria e Mjedisit, po shpresojmë që kjo të bëhet më shpejt. Unë mendoj që trajtimi i këtyre rekomandimeve me seriozitet nga ana e institucioneve do ta përmirësonte ndjeshëm këtë fushë dhe po ashtu do ta ngriste cilësinë e zbatimit të këtij ligji dhe do të hynim shpejt në fazën tjetër të ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji.

Dëshiroj t'i ftoj të gjithë deputetët të miratojmë këtë raport dhe po ashtu t'i ftoj institucionet përkatëse në zbatimin e rekomandimeve që dalin nga ky raport. Faleminderit, shumë!

Drejtimitin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Tash, në emër të PDK-së flet Sala Berisha - Shala!

SALA BERISHA - SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përsëndetje, Kabinet Qeveritar, të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka analizuar me vëmendje rekomandimet e nxjerra nga monitorimi i Ligjit për minierat dhe mineralet dhe shkallën e zbatueshmërisë së tij nga institucionet përkatëse.

Duke qenë edhe vet në krye të grupit punues, që e ka bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit për minierat dhe mineralet dhe duke qenë edhe si Parti Demokratike, pjesë e bërjes së ligjit më herët dhe pjesë e fazës së amendamentimit të këtij ligji, kemi pasur mundësi që t'i vërejmë më tepër ato mangësi dhe dobësi në zbatimin e këtij ligji.

Ajo që vlen të përmendet sot këtu, të nderuar kolegë deputetë, është se ky ligj ka hyrë në fuqi në shtator të vitit të kaluar dhe jemi shumë të vetëdijshëm se ndoshta nuk ka pasur mundësi, është afati shumë i shkurtër i mundësisë që të vlerësohet një performancë e zbatimit të këtij ligji, mirëpo si komision parlamentar kemi pasur arsye që ta iniciojmë monitorimin se sa po zbatohet ky ligj.

Duke mos ju marrë shumë kohë në historikun e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sepse e ka pasur një, të shprehem ashtu, ka pasur një lindje jashtëzakonisht të vështirë deri te hyrja në fuqi e këtij ligji.

Paramendoni, vetëm faza e amendamentimit të këtij ligji vitin e kaluar na ka marrë më shumë se një vit. Kjo nuk është rastësisht, sepse minierat jo rastësisht kanë qenë pjesa më e barrikaduar në kuptimin e delegimit të kompetencave nga institucionet ndërkombëtare tek vendorët.

Duke e ditur se minierat janë kategori kushtetuese, gjithashtu resurset natyrore janë kategori kushtetuese dhe janë pronë e Republikës së Kosovës dhe duke i ditur vështirësitë e miratimit të këtij ligji, jemi të vetëdijshëm se ky ligj është i vënë në mënyrën jo ashtu të duhur, prandaj iniciimi, monitorimi i këtij ligji na ka dhënë një rast neve si komision parlamentar dhe si kuvend që të hyjmë një plotësimi dhe ndryshimi urgjent të ligjit në fjalë.

Për të mos u ndalur shumë në elaborimin që e përmendi edhe kryetari i komisionit, efektet e monitorimit dhe sfidat me të cilat ballafaqohen institucionet për zbatimin e këtij ligji, mua më lejoni vetëm të bëj një zbërthim të shkurtër të rekomandimeve që kanë dalë nga komisioni funksional, p.sh. rekomandimi 1, Ministria e Zhvillimit Ekonomik të hartojë dhe t'i dorëzojë Kuvendit të Kosovës strategjinë minerare për shqyrtim dhe miratim.

Më lejoni që të citoj një paragraf nga strategjia. Strategjia minerare parashihet në këtë ligj, në nenin 73 dhe më lejoni, të citoj paragrafin 3, ku thuhet, se: “gjatë përgatitjeve dhe zbatimit të planeve hapësinore dhe urbanistike, të gjitha autoritetet publike duhet të marrin parasysh plotësisht dhe të veprojnë në përputhje me strategjinë minerare të shpallur nga Kuvendi.

Strategjia minerare ka përparësi mbi çdo plan hapësinor ose urbanistik që nuk është në përputhje me të. Kosovës i mungon një strategji minerare, andaj kërkojmë me urgjencë nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik ta sjellë në Kuvend këtë strategji.

Ne e dimë se vitin e kaluar për arsye politike, ndoshta është kthyer kjo strategji, por tani besoj që nuk ka asnjë arsye të mos vijë në Kuvend, edhe pse dokumenti që i është ofruar

Kuvendit para një viti, ky dokument i strategjisë së minierave dhe mineraleve ka kaluar nëpër të gjitha fazat e debateve publike nga ekspertë të ndryshëm dhe është vlerësuar si njëri nga dokumentet më të mira që ka pasur mundësi të vijnë ndonjëherë në Kuvend.

Mandej, rekomandimi i dytë është që Ministria e Zhvillimit Ekonomik të themelojë Institutin gjeologjik, që është i paraparë me nenin 77 të ligjit në fuqi. Edhe këtu janë bërë vetëm përpjekje, mirëpo nuk ka asgjë zyrtare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Mandej, ajo që e vlen të përmendet, rekomandimi i tretë, ku thuhet që Ministria e Zhvillimit Ekonomik themeloi Muzeun shtetëror të kristaleve dhe mineraleve.

Këtu, më lejoni t'ju përkujtoj se Muzeu i mineraleve dhe i kristaleve, si institucion ende nuk është themeluar nga Ministria e Zhvillimit ekonomik, mirëpo atje janë bërë hapa pozitiv në atë drejtim, sepse është duke u ndërtuar Muzeu i kristaleve të Kosovës në Stantërg të Trepçës. Prandaj, ne gjatë hartimit të këtij ligji, para një viti, e kemi bërë, mendoj se e kemi bërë si komision një punë jashtëzakonisht të vlefshme, duke pasur parasysh se sido që të ndodh me kompleksin “Trepça”, Muzeu të mbetet si pronë e Qeverisë së Kosovës dhe këtu duhet, përveç themelimit të Muzeut, që duhet ta bëjë Ministria e Zhvillimit Ekonomik, duhet që menjëherë të vazhdojë në investimin e ndërtimit të atij muzeu, sepse ne si komision parlamentar e kemi vizituar edhe kompleksin “Trepça” dhe kemi qenë në muzeun, i cili është ndërprerë financimi për ndërtimin dhe ka mbetur në gjysmë ndërtimi i objektit të Muzeut të kristaleve të Kosovës.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, është rekomandimi i 4, nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në bashkëpunim me KPMM-në.

Ne jemi të njoftuar nga ministri i Zhvillimit Ekonomik se kanë punuar diçka në këtë drejtim, nuk e di se a janë zyrtarizuar ato akte nënligjore?

Mandej, gjithashtu aktet nënligjore të nxjerra nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, në bashkëpunim me ministrinë, edhe këtu vetëm kanë bërë hapa, por ende zyrtarisht nuk kemi njoftim që kanë hyrë në fuqi.

Rekomandimi i 6 është: Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të hartojë një strategji për ndërprerjen e punës së subjekteve që ushtrojnë veprimtari.

Kryetari i komisionit veç e përmendi se një hap i tillë veç është hedhur përpara.

Qeveria e Republikës së Kosovës të hartojë dhe të përfshijë strategjinë legislative të vitit 2012, Projektligjin për mbetjet minerare. Vlen të përmendet se këtë muaj janë mbajtur dy konferenca shumë të rëndësishme në Kosovë, njëra e organizuar nga Komisioni Evropian, në bashkëpunim me Komisionin për Miniera dhe Minerale, për vlerësimin e resurseve dhe të kapaciteteve të pasurive nëntokësore të Kosovës dhe tjetra konferencë shumë e rëndësishme që është mbajtur para 2-3 ditëve, në Mitrovicë, e organizuar nga UNDP, në bashkëpunim me kompleksin “Trepça”, ku pikërisht në fokus të asaj konference ka qenë: trajtimi i mbetjeve minerare, i cili është shumë i rëndësishëm, sepse

ende në Kosovë nuk kemi ligj për trajtimin e këtyre mbetjeve minerare. Këto, përveç që kanë implikime ambientale negative për mjedisin dhe për komunitetin ku ndodhen ato, mirëpo mbetjet minerare, është një problematikë tjetër se kemi mbetje minerare të trashëguara, siç janë mbetjet e KEK-ut, të cilat paraqesin një problem jashtëzakonisht ambiental.

Dua t'ua sjell këtu një shqetësim. Gjatë vizitës sonë, si grup punues në KEK, përkatësisht në minierën e Mirashit, shqetësim shumë serioz ka qenë edhe nga ekspertët, por edhe nga banorët përreth, sepse me trajtimin e këtyre mbetjeve merret Banka Botërore përmes një projekti që e ka filluar më herët. Si ndotje jashtëzakonisht të rrezikshme janë edhe të ashtuquajturat fenole, por edhe hiri i grumbulluar nga termocentralet dhe në këtë rast shfrytëzoj që t'ia tërheq vëmendjen ose t'ia përkujtoj Komisionit për Ambient që me urgjencë të fillojë, të iniciojë monitorimin se sa po zbatohen ligjet ambientale, në këtë rast, dhe të jenë drejtpërsëdrejti pranë kërkesave dhe ankesave, shqetësimeve të qytetarëve, sepse atje patëm një shqetësim, sepse mu në zonën e pikut, kur është e ndaluar rreptësisht të merret trajtimi me fenolë, Banka Botërore ka filluar t'i trajtojë ato dhe ka qenë e pamundur qëndrimi nga kutërbimi që ka ndodhur në atë zonë, e lëre më të punohet diçka në miniera.

Krejt në fund, ne si grup parlamentar i mbështesim këto rekomandime dhe shpresoj se do dalë nga ky debat edhe ndonjë rekomandim tjetër nga pjesëmarrësit në diskutim. Ne si komision parlamentar, por edhe si grup parlamentar do të merremi shumë seriozisht me vlerësimin e performancës dhe sa do t'i ketë parasysh edhe Qeveria edhe institucionet tjera rekomandimet që kanë dalë nga monitorimi i këtij ligji. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Për Grupim Parlamentar të LDK-së, Hashim Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues i Parlamentit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar punën e Grupit Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe mineralet. Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për miniera dhe mineralet nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ishte të vlerësohet niveli i zbatueshmërisë në praktikë të këtij ligji.

Gjithashtu, komisioni kishte për qëllim të vlerësojë, nëse Qeveria, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe KPM-ja sa janë duke i përmbushur detyrimet që dalin nga ky ligj? Grupi Punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, aktivitetet të tij i ka zhvilluar në bazë të planit të veprimit, i cili përcakton subjektet e përzgjedhura, kohën e realizimit të tyre dhe mënyrën e raportimit.

Grupi punues gjatë gjithë procesit të mbikëqyrjes së ligjit realizoi këto aktivitete: takimet e grupit punues me qëllim të koordinimit dhe planifikimit të aktiviteteve, takimet zyrtare në institucionet dhe vizitat në terren, organizimin e dëgjimeve publike, raportim në mbledhjet e komisionit mbi aktivitetet e zhvilluara.

Grupi punues ka mbajtur disa takime me institucionet shtetërore dhe me kompani private, me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale, komunën e Drenasit, kompaninë e Ferronikelit, komunën e Fushë-Kosovës, KEK-un, pikërisht mihjen e qymyrit në Mirash, guroret private “Gërguri” dhe “Transin grup”.

Gjatë vizitës së grupit punues në firmën “Transin grup” zoti Demir Berisha, parashtroi disa vërejtje KPM-së, sa i përket Rregullores për miniera. Po ashtu, paraqiti vërejtjet edhe për shkak të lëshimit të lejeve dhe licencave, ku theksoi se për të marrë një leje apo një licencë për bartjen e eksplozivit, duhet të pritët një muaj. Ai tha, se duhet të jetë, të ketë një diferencë më të madhe sa i përket eksplozivit prej një gurore në guroren tjetër dhe për këtë duhet të ndryshohet rregullorja e përdorimit të eksploziveve, për arsye se shumë gurore janë hapur dhe gjatë eksploatimit tyre ato e pengojnë njëra-tjetrën.

Duke e marrë për bazë problemet e identifikuara, Grupi Parlamentar i LDK-së, nëpërmjet anëtarëve të vet në grupin punues konkludon se Ligji për miniera dhe mineralet është i zbatueshëm, por ka pengesa, për çka duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshim të gjendjes dhe për këtë komisioni njofton Kuvendin se do të marrë iniciativën për hartimin e Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e ligjit 03 L-106/33, për miniera dhe minerale.

Grupi punues propozon disa rekomandime, ku edhe më herët u cekën:

1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të hartojë dhe t'i dorëzojë Kuvendit të Kosovës strategjinë minerare për shqyrtim dhe miratim në afatin prej 3 muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve.
2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të themelojë Institutin gjeologjik në afat, prej 6 muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve dhe
3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik të themelojë Muzeun shtetëror të kristaleve dhe mineraleve në afat prej 6 muajsh, nga miratimi i këtyre rekomandimeve.

Janë edhe disa rekomandime tjera, por unë nuk do t'i përmendi, se u përmendën edhe më herët.

Grupi Parlamentar i LDK-së nëpërmjet anëtarëve të vet në komisione do t'i shpreh edhe disa rekomandime tjera. Grupi Parlamentar i LDK-së propozon që rekomandimet e Grupit Punues t'i marrë parasysh dhe t'i respektojë afatet të cilat i jep grupi punues dhe Qeveria e Kosovës të hartojë dhe të përfshijë në strategjinë legjislative të vitit 2012 Projektligjin për mbetjet minerare. Si grup parlamentar, i mbështesim këto rekomandime të grupit punues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputetë!

Për grupin e “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht, ne do ta mbështesim përmbajtjen e raportit për shkak të rekomandimeve që përfshihen në të. Duke u bazuar në këto rekomandime, por edhe në vizionin politik të lëvizjes “Vetëvendosje”, ne theksojmë se Ligji për minierat dhe mineralet duhet

medoemos të ndryshojë, në mënyrë që pasuria minerare e Kosovës të trajtohet si pasuri publike me një status të veçantë, për shkak të interesit të veçantë që paraqet ky sektor për vetë Kosovën.

Në ndryshimet që duhet t'i bëhen këtij ligji, duhet të reflektohet prioriteti i ruajtjes së minierave, si pasuri publike, e jo privatizimi i tyre. Minierat në pjesën më të madhe do të duhej të ruhen si kapital strategjik për Kosovën dhe për zhvillimin e tyre. Shteti duhet të japë zgjidhje të tjera që përfshijnë bashkëpunimin me kapitalin privat, por kurrësi privatizimin përfundimtar të tyre.

Politikat e mos privatizimit të pasurisë nëntokësore e minerare janë në interesin afatgjatë të ekonomisë tonë, por edhe në përputhje me praktikën më të mira të shteteve të zhvilluara që ruajnë kontrollin nacional mbi këto asete. Ky ligj pas ndryshimit duhet të bëhet funksional, përmes angazhimit të strukturave shtetërore që do të mund të impononin zbatimin e këtij ligji.

Shqetësuese për ne mbetet situata me operatorët ilegalë, kryesisht në sektorin e materialeve ndërtimore, shfrytëzimit të zallit prej shtretërve të lumenjve. Operatorë të tillë ilegalë ose gjysmë ilegalë, përveç se i bëjnë një dëm të pakthyesëm natyrës sonë, dëmtojnë vazhdimisht edhe ekonominë dhe potencialin zhvillimor të sektorit minerar.

Ata, gjithashtu, dëmtojnë shtetin e Kosovës dhe popullin e Kosovës. Aksioni për të parandaluar këtë veprimtari, duhet të jetë ligjor, institucional dhe i menjëhershëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Për AAK-në, zoti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar!
Të nderuara deputete,
Të nderuar deputetë,
Shumë shkurtimisht po tentoj të them se Grupi Parlamentar i Aleancës i mbështet rekomandimet që kanë dalë prej komisioni, por ajo që shihet duke e lexuar këtë raport, me një fjalë mund të thuhet se rekomandimi kryesor i përbashkët është që - hajde të fillojmë ta zbatojmë ligjin, sepse ka shumë çështje të cilat vërtet nuk kanë pasur pengesë ligjin që të implementohen, por kanë dal pengesa tjera dhe komisioni në parim është dashur që të adresojë më saktë se kush kanë qenë pengesat për zbatimin e këtij ligji.

E mirëkuptojmë idenë dhe nismën që të ketë edhe plotësim të ligjit, por duhet ta kemi tepër qartë se mungesa e strategjisë minerare të Kosovës që do të duhej ta bënte Ministria e Zhvillimit Ekonomik, nuk ka qenë e penguar nga përmbajtja e tashme e këtij ligji, por ka qenë pikërisht mungesa e punës pengesë për zbatimin e këtij ligji. Edhe elementet tjera, të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë ilegale në fushën minerare të Kosovës, nuk është pengesë përmbajtja e ligjit të tashëm, por është pengesë ajo puna që nuk ka ndodhur deri më tash, pavarësisht që është një vit, prej që ka hyrë në fuqi ligji, një vit megjithatë nuk është periudhë tepër e shkurtër që të hartohen, të paktën,

strategjitë e nevojshme dhe aktet nënligjore të nevojshme, por prej kësaj që e shohim ne, me këto rekomandime dhe me këtë raport mund të themi se do duhej të paktën edhe një vit që të fillohet puna taman dhe të realizohen këto rekomandime dhe më pas, pasi të kryhen këto rekomandime, hartimi i strategjive, miratimi në Kuvend dhe të gjitha këto, të fillojë puna reale për zbatimin edhe të atyre strategjive.

Pra, ka pengesa dhe ne e dimë, e kemi thënë edhe si grup, edhe më herët që kanë të bëjnë edhe me lejet për shfrytëzim, edhe me lejet për hulumtim të elementeve në këtë fushë, dhe po e them tepër qartë se mos zbatimi i këtij ligji duhet të jetë fokus jo vetëm në Parlament, por duhet të jetë fokus edhe në Prokurorinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Kryetarja e Grupit Kosova e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje për ministrat dhe për të gjithë deputetët!

Duke e marrë parasysh Rregulloren e punës së Kuvendit dhe esencën e miratimit të ligjeve në këtë Kuvend, do të jetë punë edhe në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, që komisionet parlamentare dhe ky Kuvend të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka sjellë Raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për miniera dhe minerale. Duke marrë parasysh se Ligji për miniera dhe minerale, u potencua edhe nga kolegja se vetëm ka kaluar në shtator të vitit të kaluar dhe rëndësia e këtij ligji ka qenë shumë e madhe që të hiqet Rregullorja e UNMIK-ut dhe të miratohet Ligji për miniera dhe minerale, ndërsa gjatë kësaj kohe, si grup punues dhe si komision parlamentar kemi parë esencën e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale.

Duke marrë parasysh se Ligji për miniera dhe minerale bie në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, takon Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Minerale, të gjitha objektet apo më mirë të themi operatorët ekonomik, që kanë të bëjnë me miniera dhe Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, është parë që komisioni ka dhënë disa rekomandime.

Për arsye se ministri është sot prezent këtu, duhet të cekim, se këto rekomandime, të cilat janë dhënë në Raportin e monitorimit të Ligjit për miniera dhe mineralet, duhet të jenë rekomandime që ministri nga dita e sodit që të miratohen, të jenë strikt vendime për zbatimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Esenca nuk është vetëm të miratohet ligji dhe të hyjë në fuqi, por esenca e gjithë ligjit është që ministria si ekzekutiv të zbatojë pikë e për pike Ligjin për miniera dhe minerale. U panë rekomandimet që u thanë këtu. Kemi qenë në terren dhe kemi parë gjendjen faktike si qëndron dhe është një raport shumë i përpiluar në realin e të pamurit të gjithë deputetëve, çka kanë parë prej akteve nënligjore dhe prej ambienteve në të cilat kanë qenë të monitorojnë Ligjin për miniera dhe minerale, është shumë e drejtë të thuhet se

Qeveria duhet t'i sjellë Kuvendit strategjinë për minerare, mirëpo ajo do të mbetet në ditët e ardhshme.

Kemi parë çështjen e implementimit të Ligjit për miniera dhe minerale në Komisionin e Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, i cili komision ceku mjaft mirë problemet e tilla me të cilat ballafaqohet, jo për arsye të Ligjit për miniera dhe minerale, por për arsye se duhet të formohet një grup, në të cilin duhet të veprojnë edhe Ministria e Punëve të Brendshme, për mundësi më të lehtë të funksionimit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Mineraleve.

Në esencën, të gjitha rekomandimet nga Koalicioni për Kosovën e Re do të përkrahen për monitorimin e ligjit, mirëpo edhe njëherë potencoj që për arsye të prezencës së ministrit për Zhvillim Ekonomik këtu, që këto rekomandime të merren si vendime dhe të nxirren aktet nënligjore, se kemi qenë edhe në ministri, është një kohë e shkurtër, mirëpo esenca e ligjit është shumë më e rëndësishme dhe ministri është i detyruar që t'i nxjerrë aktet nënligjore për zbatueshmërinë më të lehtë të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Të tjerat grupe s'janë paraqitur. Atëherë, kemi edhe dy diskutues, zoti Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë jam munduar që të nxjerr nga ky raport disa rekomandime, të cilat janë të dobishme dhe të cilat bazohen vetëm në implementimin e ligjit, mirëpo para se të fillojë implementimi i ligjit, në paraqitjet e mëparshme në këtë Kuvend kam ngritur disa shqetësime mbi ndotjen e ambientit në Republikën e Kosovës, në përgjithësi dhe me theks të veçantë në regjionin e Drenasit, nga kompania e Ferronikelit.

Në raport kam parë p.sh. që sipërfaqësisht është përmendur çështja e ndotjes të ambientit dhe çështja e ndotjes së ambientit është një çështje shumë serioze, për të cilën jo pritja e ligjeve, por duhet çdo minutë të aktivizohen grupet punuese profesionale dhe multidisciplinare që të qesin dorë një orë e më parë në të gjeturat, të cilat sot janë momentalisht në Republikën e Kosovës, përreth kompanive private, siç janë: Ferronikeli, Sharcemi dhe kompanitë tjera të cilat edhe mbetjet e mineraleve që i trajtojnë, janë jashtëzakonisht shqetësuese, por janë edhe dëmtuese afatgjate për shëndetin e popullatës.

Prandaj, ne kemi përgjegjësinë institucionale dhe humane që ne të vëmë dorë sa më shpejtë dhe kam propozuar, që nuk po shoh në këtë raport që të formohen grupet punuese profesionale që në regjionin e Drenasit, në një perimetër prej 20 km të fillohen hulumtimet, siç i kemi bërë për mbetjet minerale në regjionin e Trepçës, për kontaminimin me plumb, të bëhen njëjtë në regjionin e Drenasit për kontaminimin që i bëhet shëndetit të popullatës, vegjetacionit, bagëtive, ujit nga mbeturinat që i ka shkaktuar deponia e tyre dhe të adresohen penaltitë për shkak të mos respektimit të rregullave, sepse në prononcimet që kemi nga menaxhmenti i Ferronikelit, me ironi

thuhet: “ne i respektojmë të gjitha parimet e Bashkimit Evropian lidhur me mbrojtjen e ambientit” dhe në atë mënyrë neve, o na ofendon, o e vlerëson që shteti nuk funksionon.

Prandaj, ne nuk jemi që ta ndalojmë prodhimin ekonomik në Ferronikel, por nuk mund të lejojmë që Ferronikeli të jetë një dëmtues i shëndetit, i ambientit, i tokës nga nxjerrjet e mineralit dhe një dëmtues i ujit, i cili në atë ujë duhet shumë shpejtë të bëhen dhe kjo në afat prej 2-3 javësh, mund të nxirren analizat e qarta mbi shëndetin, mbi sasinë e mbetjeve metalike nga përthithja e ajrit në gjakun e fëmijëve, në urinën e fëmijëve, në shtazë po ashtu, dhe në vegjetacion.

Prandaj, këto do t’i ketë barrë Republika e Kosovës, do t’i ketë buxheti i Kosovës shëndetin që ta trajtojë dhe në mënyrë indirekte, do të thotë, ne me një dorë jemi duke marrë nga zhvillimi ekonomik ose nga lehtësirat që i bëjnë, por me dorën tjetër jemi duke harxhuar buxhetin duke trajtuar në institucionet tona sëmundjet të cilat edhe nuk mund të trajtohen.

Prandaj, kërkoj që në mënyrë serioze, edhe njëherë, Ministria e Ambientit, Ministria e Ekonomisë, Industrisë dhe Shëndetësisë të jenë me një komision multidisiplinar dhe të angazhohen në hulumtimet e këtyre kërkesave që unë i parashtroj dhe të cilat janë shumë shqetësuese.

Të njëjtat gjëra mund të vlejné edhe për Sharrcemin, i cili nuk do mend që të studiohet, vetëm shkoni ndaloni në pikën kufitare dhe nëse nuk i fshini xhamat për nja 15 minuta, do të keni një kontaminim të xhamave dhe dukshmërinë do ta keni nga ajo fabrikë që në një mënyrë edhe ajo vepron sikur të mos kishte asnjë institucion monitorues, as penaltues, as vlerësues të situatës qoftë shëndetësore dhe të tjera.

Prandaj, lus ministrat, lus edhe Qeverinë, Kuvendin dhe Komisionin për Miniera që të mos bazohen shumë në pritjet mujore, por të aktivizohen sa më shpejtë dhe të krijohen grupet punuese, të angazhohet Ministria e Shëndetësisë, të fillojë me mbledhjen e gjakut të popullatës rreth e përqark, të analizohen sa është përmbajtja e kontaminimit në gjak, siç e kemi bërë për Trepçën, në dy kampet, të cilat kanë qenë shqetësim edhe në Bashkimin Evropian. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Ishte një, u bënë dy. Armend Zemaj, mbas tij Fadil Demaku dhe, në fund, mbas këtyre dyve, ministri!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Më lejoni të paraqes një shqetësim timin personal në aspektin e zbatueshmërisë së këtij ligji. Grupi Punues e ka bërë punën e vet, por qëllimi i mbikëqyrjes parlamentare është të fus në rekomandimet, të cilat kanë karakter veprues dhe të menjëhershëm.

Prandaj, problemet të cilat i ka identifikuar grupi punues, ka konkluduar se ligji është i zbatueshëm, por ka pengesa dhe në bazë të rekomandimeve, të cilat janë të paraqitura, nuk do të thotë që ka pengesa, por dikush nuk e respekton dhe nuk e zbaton ligjin.

Prandaj, ne e kemi formimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e cila vepron që 6 muaj, është ndarë nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe koha e nxjerrjes së akteve nënligjore ka qenë e mjaftueshme, sidomos në këtë fushë, e cila ka shumë rëndësi në ruajtjen e ambientit dhe mbrojtjen e jetës së qytetarit.

Këtë pse po e them? Jo më shumë se sa atë çka ka mundur të bëjë ministria, por po të shikohet rekomandimi 6, ku thotë: “Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të hartojë një strategji për ndërprerjen e punës së subjekteve që ushtrojnë veprimtari ilegale në fushën e minierave dhe këtë strategji t’ia ofrojë Kuvendit, në afatin prej 3 muajve, nga miratimi i këtyre rekomandimeve”. Po të përkthehej në shqip, kjo punë i bie që, urdhëroni ju që keni veprimtari ilegale, të cilët e ndotni ambientin, e prishni ambientin, rrethinën, vidhni, keqpërdorni, i keni afat edhe 3 muaj, dhe plus 3 muaj deri sa të miratohet, ku e dimë të gjithë se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ekziston ka qe vite të tjera.

Prandaj, këtu duhet të thuhet taksativisht: ka keqpërdorime, ka veprimtari ilegale, ligji duhet të veprojë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Zhvillim Ekonomik duhet t’i konkretizojnë veprimet dhe t’i ndalin këta keqpërdorues. Edhe këtë detyrë është dashur ta paraqes komisioni dhe ta gjejë si të gjetur dhe ta paraqes këtu si rekomandim, i cili duhet të fuqizohet menjëherë me votë të Kuvendit.

Prandaj, edhe rekomandimi i 6 dhe 8, më shumë janë të përmbledhura në mënyrë dhe të cilat nuk e kanë esencën e mbikëqyrjes parlamentare, për çka edhe ... në fillim grupi punues. Ligji me një fjalë duhet thënë: “Ligji nuk zbatohet”, jo ka pengesa, nga kush ka pengesa? A janë njerëzit brenda Ministrisë për Zhvillim Ekonomik, a janë njerëzit jashtë, të cilët e sfidojnë shtetin? Ju i shihni gurëthyesit, i shini ata njerëz, d.m.th. çdo ditë përballeni, ne i kuptojmë, por duhet të kenë rekomandime të qarta pa hezitim dhe të merret vota e Kuvendit nga të gjithë, sepse ka të bëjë me mbrojtjen e jetës së qytetarit në të gjitha nivelet.

Edhe njëherë unë e vlerësoj punën të cilën janë munduar ta bëjnë, por rekomandimet duhet të jenë strikte dhe të thuhet në mënyrë shumë decitive, ligji është i zbatueshëm, sepse nuk kemi nxjerrë ne ligj në kundërshtim me normat juridike dhe kushtetuese, por ligji nuk zbatohet. Aktet nënligjore nuk janë nxjerr, njerëzit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale nuk po e kryen punën ashtu siç ia cakton ligji dhe të cilat i kanë kompetencat dhe këto duhet të jenë të qarta, përndryshe mua personalisht më lë dyshime që këtu ka ndonjë konflikt interesi nga anëtarët e komisionit të cilët e kanë monitoruar ligjin.

Prandaj, këto janë shqetësime, thashë edhe njëherë, të miat personale dhe mendoj që në mënyrën shumë të sinqertë duhet të merren edhe nga anëtarët e komisionit, edhe nga Qeveria dhe nga Komisioni për Miniera dhe Minerale. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Raporti për mbikëqyrjen e zbatimi të Ligjit për minierat dhe mineralet paraqet punën e mirë të grupit punues. Rekomandimet e Raportit shërbejnë për mundësinë e ndryshimit apo plotësimit të ligjit. Kjo ka ardhur si rezultat i takimeve që kanë pasur në komuna dhe nëpër vende ku operojnë industritë dhe janë vërejtur se ka zbrazëti ligjore dhe nevojë për plotësimin e tyre.

Një çështje është njohja e të drejtës së komunave, ku operojnë këto industri, për vënien e taksës për ndotjen e ambientit brenda territorit të atyre komunave. Kjo të futet në rekomandime, si taksa ambientale. Unë kam marrë pjesë në një takim që kanë pasur anëtarët e komisionit në komunën e Drenasit, më 13 korrik 2011, edhe në komunë, edhe në takimin që kanë pasur me menaxhmentin e Ferronikelit dhe në takimin në komunë, përveç shumë çështjeve dhe shqetësimeve që janë ngritur, mendoj se një çështje ka qenë shumë e drejtë që është ngrit nga ata.

Konkretisht, një pjesë e rentës mineraleve që ndahet nga kompania e Ferronikelit për KPMM-në, t'i kthehet si të hyra komunës, për shkak të ndotjes së ambientit, dëmtimit të infrastrukturës dhe shumë faktorëve të tjerë të cilët i përmendën edhe kolegët tjerë deputetë dhe kjo do të ishte mirë që të bëhej me ligj dhe ky ligj të jetë i zbatueshëm për të gjitha komunat që përafërsisht ballafaqohen me çështje dhe probleme të njëjta.

Dhe, në fund të fundit, do të ishte e drejtë, pasi që në ato komuna operojnë këto industri, qytetarët e atyre komunave të kishin një trajtim më të veçantë dhe më të privilegjuar, duke pasur parasysh edhe dëmet që shkaktojnë këto. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Beqaj.

BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë me vëmendje i dëgjova të gjitha diskutimet që kanë të bëjnë me monitorimin e Ligjit për miniera dhe minerale. Kam pasur rastin që pikëpamjet e mia t'i them edhe para komisionit dhe dëshiroj që para Kuvendit dhe qytetarëve të bëj edhe një shpjegim shtesë, të cilin nuk e dëgjova në asnjë nga deklaratimet e deputetëve.

Sa i përket zbatimit të ligjit, sepse kemi dy çështje që i diskutojmë, flasim për zbatimin e ligjit dhe flasim në ndërkohë për nevojën për amendamentim aty ku shihet që ka pengesa në ligj. Ligji është aprovuar në shtator të vitit të kaluar. Strategjia minerare që ka qenë obligim nga ky ligj, ka ardhur në Kuvend të Republikës së Kosovës, Kuvendi e ka refuzuar dhe pa shpjegim e ka refuzuar, gjë të cilën e ka bërë të pamundur ministrisë që të vazhdojë, sepse procedurat janë procedura për kthim, me shpjegime të caktuara.

Për informimin tuajin, ne jemi detyruar që t'i marrim transkriptet e mbledhjeve të Kuvendit, për të parë se çka është debatuar në atë ligj, vetë i kemi marrë, vetë i kemi analizuar dhe unë e kam njoftuar edhe komisionin në takimin që e kam pasur me ta, se ministria e ka përgatitur strategjinë dhe pret që ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Prandaj, rekomandimi i dalë që ministria duhet brenda 6 muajsh, po ju them që është i tejkaluar, për shkak se unë e kam njoftuar edhe komisionin, se kjo strategji konform transkripteve që ne i kemi analizuar vetë, pa letër me shkrim nga Kuvendi, kemi bërë hartimin e saj dhe tani presim ta procedojmë në Qeveri.

Prandaj, për këtë kanë qenë në dijeni të gjithë deputetët, të cilët kanë qenë prezentë në takimin, ku unë i kam referuar bashkë me KPMM-në. Në këtë drejtim, kjo nuk do të pret 6 muaj, do të kryhet shumë më shpejt, Qeveria do ta kryej punën e saj, ndërsa do t'i mbetet Kuvendit për aprovimin e kësaj strategjie. Në ndërkohë, udhëzimet administrative, të cilat thirremi se nuk janë aprovuar, dy udhëzimet të cilat janë aprovuar dhe nuk kanë pasur të bëjnë me strategjinë minerare, janë aprovuar por, të nderuar deputetë, udhëzimet administrative duhet të jenë në harmoni me ligjin dhe në harmoni me strategjinë minerare, të cilin Kuvendi paraprak e ka refuzuar dhe nuk e ka proceduar, prandaj ka qenë e vështirë që të aprovojmë udhëzimet administrative, të cilat aprovohen para se të aprovohet një strategji nga ana e Kuvendit të Kosovës.

Udhëzimet janë të gjitha të gatshme dhe konform ligjit aktual, pa strategjinë ato mund të procedohen qysh nesër, pa asnjë lloj problemi, por do të kemi situata kur do të kemi kolizione në aspektin e udhëzimeve administrative dhe ligjeve dhe kjo do ta sjellë situatën që pastaj do të komplikohet edhe më tutje.

Prandaj, për ta konkluduar çështjen e strategjisë minerare, strategjia shumë shpejt do të vijë në Kuvend, përkundër asaj, po them, që asnjëherë nuk kemi marrë me shkrim nga Kuvendi arsyet, të cilat janë, punët të cilat duhen që këtë strategji ta përmirësojmë, sepse është kthyer njëherë nga Kuvendi. Por, e kemi shfrytëzuar bazën ligjore që Kuvendi është ndryshuar, sepse po të ishte i njëjti Kuvend, ne do të duhej patjetër ta marrim me shkrim dhe ne kemi proceduar në përgatitje.

Çështja e dytë, sa i përket Institutit gjeologjik, dëshiroj të theksoj që edhe Instituti gjeologjik ka qenë plan, por nuk ka qenë i përfshirë në buxhetin as të ministrisë paraprake, as të ministrive të tjera. Prandaj, ka qenë e vështirë, ne kemi marrë një konstatim dhe jemi duke e përgatitur këtë, në mënyrë që Instituti gjeologjike të funksionalizohet.

Kemi edhe institute të tjera, të cilat kanë funksionuar dhe nuk kanë funksionuar, prandaj ne jemi shumë të përgjegjshëm që atëherë kur themelojmë institute, ato duhet të jenë të themeluara në mënyrë të mirëfilltë.

Lidhur me Muzeun e kristaleve dëshiroj të theksoj se Ministria e Zhvillimit Ekonomik, si pasuese e Ministrisë, një pjese të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, ka bërë, ka kryer obligimin e vet financiar ndaj Muzeut të kristaleve konform marrëveshjes paraprake. Një pjesë tjetër e investimeve kanë qenë Ministria e Ambientit, e cila nuk e ka pasur në buxhet të këtij viti, unë nuk e di qysh është miratuar as strategjia, as ligji paraprakisht, por nuk ka qenë dhe ne si ministri kemi bërë një rialokim të mjeteve, në mënyrë që të përfundojnë punimet dhe realisht të vazhdojë Muzeu i kristaleve, i cili do të jetë në menaxhim të ministrisë. Pra, kemi një angazhim shtesë financiar të pa planifikuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik që kjo të bëhet gjatë këtij viti.

Lidhur me mbetjet minerare, Ligji aktual ka obliguar udhëzim administrativ dhe nuk ka obliguar ligj dhe ne konform këtij ligji kemi përgatitur udhëzimin administrativ, por nëse kjo tash del konkludim nga rekomandimet për plotësim dhe amendamentim të ligjit, atëherë sigurisht se do të bëhet edhe ligj, pa asnjë lloj problemi.

Sa i përket guroreve pa licencë, të shfrytëzimit të resurseve, dua t'ju informoj që ne jemi në komunikim të drejtpërdrejtë në baza ditore me KPMM-në dhe ka shumë e shumë padi nëpër gjykata, të cilat presin të trajtohen. Nuk është asnjëherë në pikëpyetje se a është duke funksionuar ligji apo nuk është duke funksionuar, a është në zbatim apo nuk është në zbatim. Ne jemi ata të cilët bashkë me KPMM-në do t'i bëjmë procedurat tona të cilat... ndërsa pjesa tjetër e drejtësisë është pjesë e cila ka të bëjë në mënyrë të drejtpërdrejtë me sistemin e gjyqësisë.

Prandaj, në këtë drejtim, edhe një herë unë i falënderoj të gjithë deputetët për rekomandimet e tyre. Do të jemi shumë të koncentruar për ta prurë strategjinë dhe besoj se Kuvendi me një efikasitet çfarë e ka treguar gjatë këtyre ditëve në diskutim lidhur me ligjin, do ta aprovojë edhe strategjinë, sepse pa strategji as udhëzimet administrative nuk kanë asnjë vlerë, as çështjet tjera të cilat lidhen edhe me ambientin nuk mund të trajtohen në mënyrë të mirëfilltë.

Ne kemi pasur një strategji, strategjia nuk ka kaluar dhe nuk ka qenë në duart tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Çka po do, Shaip? Do pas ministrit, Shaip Muja. Shkurt, një minutë e ke!

SHAIP MUJA: Unë, zoti kryesues, problemin e paraqitjes në gjyqe të atyre keqpërdoruesve që posedojnë licencat dhe nuk përmbajnë rregulla të punës, unë mendoj se është një blerje e kohës. Por është shumë urgjente që të krijohen grupet, sepse gjyqi nuk mund të nxjerrë..., nuk ka mekanizma momentalisht aq profesional shpejt që të arrijë ta vlerësojë shkallën e dëmtimit të ambientit dhe të keqpërdorimit të licencave që i posedojnë ata persona.

Prandaj, Ministria dhe ministrat kanë mundësi që brenda ditës të krijojnë grupe profesionale me përshkrim të detyrave që të fillojnë analizat në mënyrë specifike për probleme që janë duke u ngritur, e jo të pritet ligji, të pritet strategjia, të pritet vendimi

gjyqësor, në një mënyrë është duke u bërë edhe ..., pas tri vitesh dhe kur përfundon problemi, do të na mbetet neve të merremi me problem, ndërsa operatorët do të ikin nga Kosova. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministri e ka fjalën, shkurt!

MINISTRI BESIM BEQAJ: Faleminderit, kryesues!

Ministrat mund të bëjnë grupe për të analizuar dhe ato analiza janë të mirëseardhura, por asnjëherë ministrat nuk mund të marrin vendim mbi gjyqësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Zotërinj deputetë dhe deputete,

Tash diskutimi rreth këtij raporti mbaroi. Unë ju lus që të uleni në banka, sepse herë po hyni, herë po dilni!

E dyta, dua t'ju sjell në vëmendje që gjatë votimeve që janë studiuar herëve tjera, kanë ndodhur keqpërdorime. Dhe ne do të provojmë të bëhemi seriozë, t'i numërojmë si duhet ato votime dhe qysh po votohet.

Pra, nëse dikush thotë s'kam kartelë, e voton me dorë, do t'ia regjistrojmë emrin kush është ai që po voton me dorë. Pse? Sepse ka njerëz që po votojnë me kartelë, edhe i herë po thonë po votojmë me dorë.

Prandaj, ju lus juve dhe regjinë, votimi i parë është votimi për prani dhe unë ju thërras tash të votoni për prani në sallë, me kartelë. Hiqni a i vëni, bëni çka doni, votimi i parë është për praninë. Harroni kartelat e huaja, se do të regjistrohen emrat të gjithë, edhe ai që voton pa kartelë a me dorë, qysh thoni ju, ai dihet cili është.

A jemi gati, teknika? Votojmë tash për praninë!

Me kartelë, në sallë janë të pranishëm 72 deputetë. 72, e këtu thotë që brenda janë 76, domethënë 4 veta s'kanë kartelë.

(Ndërhyrje)

Mirë, 74 janë me kartelë dhe 2 janë pa kartelë.

Ju lutem, para se të votojmë, ne i patëm disa vërejtje që dukeshin shumë interesante e thelbësore, po asnjëra prej tyre nuk u kthye në rekomandim, ndonëse u tha... Jo, jo, s'është kthyer në rekomandim. Dihet qysh punohet në Kuvend. Hartohet rekomandimi dhe thuhet – propozoj këtë rekomandim. Ajo nuk ndodhi, prandaj ju thërras të votojmë për Raportin e Komisionit për Zhvillimin Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale. Dhe, votojmë tash!

71 janë “për”, 3 abstenojnë, që bëjnë 74. Zero ka “kundër”, 2 vetë qysh votojnë ata? Me emra, kush janë ata që donë të votojnë me dorë. S'ka! Faleminderit!

Do të thotë, me 71 votë “për”, 3 abstenime dhe 0 “kundër”, kalon ky raport.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financa të pushtetit lokal

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financa të pushtetit lokal dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e merr kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj për arsyetimin e Raportit me rekomandime. Zonja Hadërgjonaj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Sipas Rregullores së punës së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet e ka edhe mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së ligjeve në fushën e financave.

Komisioni për Buxhet e Financa në planin e punës për këtë vit ka paraparë monitorimin e Ligjit për financat e pushtetit lokal. Me qëllim të përmbushjes së këtij aktiviteti, Komisioni ka bërë monitorimin e këtij ligji dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Komisioni, në mbledhjen e datës 8 qershor 2011, ka krijuar grupin punues prej 5 anëtarëve, i cili ka hartuar dhe aprovuar Planin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Grupi punues, bazuar në autorizimet e marra nga komisioni, ka zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim të mbledhjes së informatave mbi nivelin e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal.

Sipas planit të punës, Komisioni ka ftuar ministrin e Financave për të dhënë informatat që ishin në fokus të interesimit të anëtarëve të komisionit. Në mbledhjen e datës 22.6.2011, zëvendësministri i financave, zoti Ramadan Avdiu, ka raportuar për nivelin e zbatimit të Ligjit si dhe rolin dhe përgjegjësinë e Ministrisë në zbatueshmërinë e Ligjit dhe i është përgjigjur edhe me shkrim disa pyetjeve të cilat kanë qenë në interes për anëtarët e komisionit.

Vizitat në terren janë përqendruar në dy nivele, në nivelin qendror, ku është vizituar Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal, kurse në nivelin lokal janë vizituar komuna e Prishtinës, Ferizajt, Shtërpçës, Pejës, Istogut, Suharekës dhe komuna e Prizrenit.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për financa të pushtetit lokal, grupi punues ka arritur të mbledhë të dhëna të mjaftueshme mbi nivelin e zbatimit të ligjit.

Në bazë të të gjeturave nga vizitat në terren, ka bërë vlerësimin se sa është niveli i zbatimit të ligjit, ka identifikuar çështjet e ngritura nga institucionet që janë vizituar, si dhe ka rekomanduar masa konkrete që duhet të ndërmerren për të lehtësuar zbatimin e ligjit.

Ligji për financat e pushtetit lokal në përgjithësi implementohet nga komunat, Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal dhe nuk janë identifikuar probleme të mëdha që ndërlidhen me zbatimin e ligjit.

Komunat i kanë të nxjerra rregulloret me të cilat realizojnë të hyrat që i parasheh ligji, por ato ndryshojnë në mes komunave në mënyrë që të përshtaten me nevojat specifike të komunave.

I pa zbatueshëm është neni 30, pjesa 5, për huamarrjet komunale dhe zotimet afatgjate, të cilin nen e ka bërë të pa zbatueshëm aprovimi i Ligjit për borxhet, në kuadër të të cilit rregullohen edhe borxhet komunale dhe garancionet.

Vërejtjet e ngritura nga niveli komunal më tepër kanë qenë të natyrës së përgjithshme, që ndërlidhen më shumë me menaxhimin e financave komunale dhe implementimin e Ligjit për financat publike dhe përgjegjësitë dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Thesari, por edhe të ligjeve të tjera.

Komunat shprehin shqetësimet e tyre për mos dërgimin e fondeve të nevojshme për ushtrimin e kompetencave të deleguara nga niveli qendror, për shembull për zyrat për integritet evropiane, ruajtjen e pyjeve, teatrot, zyrat për kthim e komunitete e tjera.

Shqetësim i disa komunave është vonesa e alokimit të hyrave vetanake nga niveli qendror që shkakton vonesë në planifikimin dhe shpenzimin e tyre.

Mos lejimi i fleksibilitetit të komunave që mjetet e planifikuara brenda një viti fiskal për një projekt kapital të barten në një projekt tjetër kapital me rastin e financimit të atij projekti të planifikuar nga ana e donatorëve, kufizimet që iu bëhen komunave në bartjen e mjeteve nga një kategori në tjetrën, si për shembull për raste emergjente, kufizime këto të cilat i bën Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi. Disa komuna kanë shprehur shqetësime për mos organizimin e mjaftueshëm të trajnimeve për stafin që merret me financa për të ngritur kapacitetet e zyrtarëve financiarë, për përpilimin e pasqyrave financiare. Si pasojë e kësaj disa komuna kanë marrë vërejtje nga auditori i përgjithshëm në raportet e auditimit.

Rekomandimet e paraqitura nga komisioni janë të natyrës së themelimit të mekanizmave, informimit dhe organizimit të trajnimeve nga ana e Ministrisë së Financave për komunat, në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i burimeve financiare.

Këto rekomandime janë në përfitim të zbatuesve të Ligjit për financa të pushtetit lokal, të institucioneve qeveritare dhe komunale dhe në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Komisioni rekomandon që me qëllim të zbatimit më të mirë të nenit 5, të përcaktojë delegimin e kompetencave, që Ministria e Financave të monitorojë procesin e delegimit të kompetencave në mënyrë efikase dhe të sigurojë që së bashku me kompetencat e deleguara të bëhet edhe bartja e buxhetit dhe të transferohen të punësuarit.

Në të njëjtën kohë, rekomandohet që Ministria e Financave të sigurojë se nga buxheti i institucionit, i cili delegon kompetencën, të bëhet edhe zbritja e buxhetit dhe numri i të punësuarve, në mënyrë që të shmanget rritja e numrit të të punësuarve.

Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal të jenë më aktivë në informimin e komunave për dispozitat e Ligjit numër 03/L-175 për borxhet publike, përkatësisht detyrimet lidhur me borxhin dhe garancitë komunale që i përcakton kreu X i Ligjit për borxhet publike.

Ministria e Financave dhe Ministria e Pushtetit Lokal, pas publikimit të të dhënave zyrtare dhe përfundimtare nga regjistrimi i fundit i popullsisë, të ndryshojnë shtojcën 1 të Ligjit për financa të pushtetit lokal dhe Komisioni i granteve të bëjë ndarjen e grantit të përgjithshëm duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë, si dhe të rishikohet neni 35 paragrafi 3 i Ligjit për financat e pushtetit lokal.

Ministria e Financave në bashkëpunim me komunat të krijojnë një mekanizëm unik për planifikimin e të hyrave vetanake. Kjo do të rritë efikasitetin e parashikimit të të hyrave tek komunat, respektivisht do të kontribuonte edhe në parashikimin e parasë së gatshme për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ministria e Financave të rrisë efikasitetin e trajnimeve për zyrtarët financiarë të komunave, në mënyrë që ata të jenë të përgatitur për përpilimin e pasqyrave financiare.

Rekomandohet që komunat të jenë më efikase në evidentimin dhe ruajtjen e pronave komunale dhe që komunat të angazhohen më shumë në rritjen e të hyrave vetanake, si dhe të rrisin transparencën e këtyre të hyrave.

Komisioni për Buxhet dhe Financa njëzëri e ka miratuar këtë raport me rekomandime dhe njëkohësisht i rekomandon Kuvendit që ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Qeveria s'është paraqitur. Për më keq, edhe s'janë këtu hiq. Do të duhej të ishte ministri i Financave ose i Pushtetit Lokal. E kanë keq, e kanë gabim që s'janë këtu dhe kot mbajnë fjalime edhe deputetët edhe ata, ne do të bëjmë, nëse s'janë të zotë të monitorojnë aty ku jepet një raport për zbatimin e një ligji.

Hasime Krasniqi flet për Grupin Parlamentar të PDK-së!

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!
Të nderuar deputetë dhe deputete,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet Raportin e Komisionit për Buxhet e Financa lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit për financa të pushtetit lokal dhe njëherësh kërkon nga institucionet përkatëse që të bëjnë zbatimin e këtyre rekomandimeve të dhëna nga ana e komisionit, me qëllim që Ligji për financa të pushtetit lokal të jetë praktikisht sa më i zbatueshëm dhe në interes të nivelit qendror dhe lokal, që të bëhen të gjitha përmirësimet ku është praktikisht i pa zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Për Grupin e LDK-së, deputeti Sali Asllanaj!

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ta mbështes këtë raport, duke vlerësuar punën e grupit punues në të cilin kam marrë pjesë edhe vetë, duke pasur parasysh kontributin e çmueshëm që kanë dhënë zyrtarët financiar të komunave, gjegjësisht drejtorët e drejtorateve për ekonomi e financa, përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Ky raport është një pasqyrim besnik i monitorimit tonë që kemi bërë nga organet përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, do të thotë komunat, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave dhe një mbështetje logjistike që kemi pasur nga Shoqata Gjermane GIZ.

Është e vërtetë se Ligji mbi financat lokale është shumë i kufizuar, kryesisht përcakton burimet buxhetore të cilat mund të vjelin komunat vet dhe grandet nga buxheti qendror në formë të grandeve të përgjithshme dhe atyre specifike, si dhe mënyrën e shpërndarjes së këtyre grandeve nga Komisioni i grandeve.

Ligji mbi financat lokale është realisht një ligj i cili mbetet nën kornizën e Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi dhe shi për këtë, shumica nga vërejtjet e përfaqësuesve të komunave rezultojnë në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi se sa në vetë ligjin e monitoruar.

Komunat gati njëzëri kërkojnë autonomi financiare lokale, e që gjithnjë duke pritur në masën prej 70 deri 80% të buxhetit nga grandet qendrore, që për mua është një lloj absurdi. Hiq komunën e Prishtinës, e cila të ardhurat vetanake i ka gati në nivel 50 me 50, komunat tjera, kush më shumë e kush më pak janë të varura nga grandet qendrore.

Për mua, nuk mund të pretendojmë as ne, as komunat për një autonomi të tillë në këtë sistem tatimor dhe në këto burime buxhetore vetanake me të cilat disponojmë tash. Autonomia lokale është e lidhur ngushtë me autonominë financiare, gjegjësisht burimet vetanake buxhetore të secilës komunë.

Vërejtjet tjera të natyrës burokratike procedurale që kanë komunat ndaj organeve qendrore janë të një natyre tjetër, që nuk janë objekt i këtij ligji, por si thirrje për thjeshtësim të procedurave burokratike mund të konsiderojmë se është e domosdoshme.

Do të duhej që komunave t'u ndihmojnë sa më shumë për qasjen në këtë vi zhvillimore të tyre, sepse në asnjë komunë nuk kemi dëgjuar asnjë iniciativë të tillë, edhe pse Ligji mbi financat lokale e lejon, kurse për së afërmi rregullon një ligj tjetër, i cili ka të bëjë me borxhet. Mendoj se komunat për projekte të mëdha kapitale do të duhej që të shfrytëzojnë këtë të drejtë, e Ministria e Financave t'ua lehtësojë procedurat dhe t'i ndihmojë në aftësimin plotësues në këtë drejtim të stafeve të komunave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Albana Fetoshi, për Grupin e “Vetëvendosjes”!

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e Financa e ka formuar një grup punues, i cili do të bënte mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal. Kjo është një gjë e mirë, sepse nuk mjafton që vetëm të miratojmë ligje, por njëkohësisht duhet të sigurohemi se a po zbatohen këto ligje.

Ne e dimë që në këtë Parlament janë miratuar edhe shumë ligje të cilat janë shumë të dëmshme për Kosovën, madje me procedurë të shpejtë, si ligjet e ashtuquajtura që dalin nga pakoja e Ahtisarit.

Edhe Ligji për financat e pushtetit lokal është ligj që derivon nga pakoja e Ahtisarit dhe shumë nene në këtë ligj janë të pa pranueshme për ne, sepse janë shumë të dëmshme për Kosovën.

Neni 7 i këtij ligji, në lidhje me burimet financiare të komunave, në pikën 6 parasheh edhe ndihmën financiare për Republikën e Serbisë për komuna.

Grupi punues në kuadër të përzgjedhjes së institucioneve qendrore dhe komunave të cilat i ka vizituar, mendoj se nuk e ka bërë përzgjedhjen e duhur, sepse do të duhej që ta vizitonte edhe ndonjërin nga këto komuna që dalin nga pakoja e Ahtisarit.

Ne do të duhej që të informoheshim se si vijnë ndihmat financiare prej Serbisë në komunat me shumicë serbe, si menaxhohen ato financa, a janë të informuara institucionet qendrore të Kosovës, a kalojnë këto mjete përmes llogarisë së Thesarit të Republikës së Kosovës e tjera.

Në raport flitet në mënyrë shumë të përgjithësuar për rregulloret që i kanë nxjerrë komunat, e të cilat përcaktojnë kushtet për taksapaguesit e komunës. Komunat kanë bërë skema tarifore për taksat të cilat janë të ndryshme nëpër komuna, por në raport nuk tregohet se sa janë të ndryshme këto tarifa nga komuna në komunë.

Ky raport ka mund të jetë shumë më i detajuar sikur të vizitoheshin më shumë institucionet që lidhen me zbatimin e këtij ligji. Nuk mjafton vetëm që të takohen zyrtarët e ministrave dhe komunave, do të duhej që të takoheshin edhe shumë institucione nëpër komunat përkatëse, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në të hyrat e komunave, si për shembull drejtoritë regjionale të policisë, inspektoratet e ndryshme, drejtoritë e arsimit, ato të shëndetësisë e tjera.

Gjithashtu, në këtë raport do të duhej që të informoheshim në mënyrë më specifike se sa janë bartur kompetencat nëpër komuna dhe financat për ato kompetenca të bartura.

Mendoj se raporti si tërësi është shumë i përgjithësuar, me gjithë të gjeturat dhe rekomandimet e ofruara.

Për fund, ne do të votojmë kundër raportit me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal, sepse ky ligj derivon nga pakoja e Ahtisarit dhe ka nene që janë të pa pranueshme për ne.
Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Xhevdet Neziraj!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuari zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës përkrah rekomandimet që i ka dhënë Komisioni për Buxhet e Financa, mirëpo shqetësuese për Grupin e Aleancës është mospranimi i ministrit të Financave dhe ministrit të Pushtetit Lokal, kështu që propozoj që kryetarja e komisionit, këto rekomandime që i ka bërë komisioni t'ua dërgojë ministrave ja në formë elektronike, ja personalisht dhe t'i shqyrtojnë vërejtjet dhe rekomandimet të cilat i ka dhënë komisioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, deputeti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Unë mendoj se, duke vazhduar aty ku e la Xhevdeti, për fillim të them se do të duhej të kuptohej nga secili ministër dhe nga secila qeveri se ata janë të obliguar të zbatojnë rekomandimet e Kuvendit. Ndryshe, vizita për përkujtim do të ishte e mirë, por ata edhe nëse s'janë prezent, ndoshta do t'i pyesim një ditë, pas 4 a 5 muajve, çka ka ndodhur me këto rekomandime që sot do t'i aprovojmë.

Ndoshta edhe sot do të ishte mirë që të kemi, të them ashtu, rekomandim të punës që dy ministrat të raportojnë pas tre muajve çka ka ndodhur me rekomandimet e sotme.

Përndryshe, edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e mbështet raportin e grupit punues dhe të komisionit. Dy çështje të cilat janë të përmbajtura edhe në rekomandimin në njëfarë mënyre, por të cilat mendoj se janë me rëndësi qenësore, të cilat ne dëshirojmë t'i theksojmë sot kanë të bëjnë:

E para, që duhet të rritet transparenca e aprovimit dhe shpenzimit të buxhetit në nivel të komunave dhe të rriten kontaktet e drejtpërdrejta me grupet e interesit dhe komuniteteve lidhur me buxhetet komunale. Nuk ka nevojë të thuhet se sa kjo është e rëndësishme, dhe pikërisht ndikimi i komuniteteve dhe i qytetarëve në shpenzimin e buxheteve për të siguruar një cilësi më të lartë të shërbimeve është shumë më lehtë i realizueshëm në komuna se sa në nivel të Kosovës, por edhe pse ka do komuna fragmentare, të fragmentuara apo të pjesërishme, në komuna ende kjo nuk është arritur.

E dyta, është se niveli i mbledhjes së tatimit në pronë dhe taksave tjera komuna është ende shumë i ulët dhe komunat duhet ta rrisin efektivitetin. Natyrisht që disa komuna thonë se ne i kemi mbledhur 100% të tatimit në pronë, por nëse shohim planin lidhur me tatimin, ai plan domethënë ka qenë i planifikuar që të mbledhen diku 50% të të ardhurave që mund të mbledhen me tatimin në pronë dhe atëherë 100% është në fakt 50% i mundësive potenciale. Këto dy çështje meritojnë një kujdes më të madh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Mustafa! Fjalën e ka deputetja Jelena Bontiq, për SLS!

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Kao član Komisije za budžet i finansije imala sam priliku da budem i član Komisije sa zadatkom nadgledanja sprovođenja Zakona o finansijama lokalnih vlasti. Terenski rad i obilazak lokalnih samouprava širom Kosova omogućio nam je uvid u probleme i izazove sa kojima se predstavnici lokalnih vlasti susreću.

Probleme koje smo sa predstavnicima lokalnih vlasti zajedno utvrdili, možemo podeliti u dve grupe. Prvu grupu problema čini hronični problem finansija, odnosno nedovoljnih sredstava za razvoj opština na Kosovu. Znamo da su kosovski budžeti ograničeni i realno mali.

Druga grupa problema su administrativne, odnosno regulativne prirode, sporo transferisanje sredstava opština, način rada trezora, veliki centralizam i nefleksibilnost kod prenosa sredstava između kapitalnih ulaganja u jednoj fiskalnoj godini, samo su neki od problema.

Sa našim partnerima, predstavnicima lokalnih vlasti smo takođe konstatovali da neophodna dalja decentralizacija ne znači ne poštovanje opštih pravila. Složili smo da ima jako puno prostora da se odnos centralne i lokalne vlasti unaprede zarad boljeg života građana.

Izveštaj generalnog revizora koji je ova Skupština razmatrala, imao je puno poražavajućih zaključaka o radu lokalne samouprave. Podsetiću vas da je stanje opštinskih dokumentacija bilo tako da revizor u nekim slučajevima nije mogao dati svoje mišljenje.

Kao predstavница stranke koja se najdirektnije zalaže za potpunu decentralizaciju kosovskog društva, smatrajući to uslovom za razvoj svih sfera društva, a informišući se

kroz rad komisije o svim problemima na terenu, sa svojim kolegama i koleginicama iz Samostalne liberalne stranke glasaćemo za usvajanje ovog izveštaja jer mislimo da oslikava stanje lokalnih samouprava u pogledu primene Zakona o finansijama lokalnih vlasti. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! E kam edhe një emër këtu, që shkruan Sali Morina. Ai s'është hiq, dhe kush ia ka prekur kartelën, më mos t'i prek kartelat e huaja. Këto janë lojna! Ose është lojë ose gabim, por dine se këtu shkruhet krejt. Prandaj, ju thash të bëhemi serioz se si votohet...

Ju lutem, nuk ka më diskutues. Këtu sipas fytyrave e trupave, janë 65 vetë. Unë kërkoj nga regjia që votimi i parë të jetë me kartela për prani këtu, dhe votojmë tash për prani!

Faleminderit! Janë 57. Sa janë që nuk kanë kartela, tash, le t'i çojnë duart, a si të donë, se brenda janë 65 deputetë. Kush janë këta 6 deputetë, a donë të votojnë a s'donë? Po pra, janë 65.

Ju lutem, votojmë për Raportin vjetor për buxhet e financa, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financa të pushtetit lokal. Regjia, votojmë tash!

“Për” kanë votuar 63, 3 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për financat e pushtetit lokal.

Tash ora është 13:00. Në orën 14:00, vazhdojmë punën!

(Ndërhyrje)

Urdhëroni! Po këtu ka njerëz që donë për të vazhduar, po ka njerëz që s'po donë të vazhdojnë. Unë po jap pushim deri në ora 14:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: Po vazhdojmë!

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e merr kryetarja e komisionit funksional, deputetja Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e Raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuari ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur me datën 15 qershor 2011, shqyrtoi Raportin vjetor të punës për vitin 2010 të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë këtë raport.

Nga raporti vërehet se mjetet e Trustit Pensional të Kursimeve janë diku rreth 450.7 milionë euro.

Gjatë vitit 2010, Trusti ka pasur kthim bruto prej 26 milionë euro nga investimet, gjë që ka mundësuar që kursimeve pensionale të kontribuuesve të Trustit t'u rritet vlera neto për 5.18%.

Në fund të vitit 2010, në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës kanë qenë rreth 38 milionë euro të pa investuara, kurse 450 milionë euro ishin të plasuara.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të investuara rreth 30% të totalit të investimeve të Trustit; në Britani të Madhe 8%, kurse në Kosovë 7.5% të investimeve.

Sipas Ligjit në fuqi, Trustit nuk i është lënë mundësia që të bëjë vetëm investime në tregjet financiare, kështu që Trusti angazhon menaxhues, domethënë angazhon ndërmarrje të specializuara të cilat merren me investimin e mjeteve në tregjet financiare dhe këta menaxhues të mjeteve financohen nga mjetet operationale të Trustit.

Në Komision janë shprehur shqetësimet rreth angazhimit të menaxhuesve të mjeteve ku është kërkuar sqarim nga kryetari i Bordit të Trustit rreth zgjedhjes së këtyre menaxhuesve dhe janë shprehur shqetësimet për angazhimin e mjeteve nga këta menaxhues në disa shtete të cilat janë në krizë financiare.

Nga përfaqësuesit e Trustit u kërkuar sqarim për të dhënat e prezantuara në raport për disa aktivitete të Trustit në vitin 2010, si çështja e tërheqjes së mjeteve nga bankat e Kosovës, nga një bankë e Kosovës, pastaj për mjetet që investojnë qytetarët e të cilat nuk janë atribuar në llogaritë individuale. Me interes ishte edhe të dihej se si është kompensuar vlera e humbjes në vitin 2008 – 2009.

Interesimi ishte edhe për çështjet e pagave të punëtorëve të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, sidomos për postet udhëheqëse dhe kriteret të cilat janë përdorur për të caktuar bazën e të ardhurave personale për stafin udhëheqës.

Çështjet që janë ngritur në Komision janë sqaruar nga përfaqësuesit e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, kështu që bazuar në sqarimet e ofruara, Komisioni ka

vlerësuar se Raporti vjetor i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010 i përmbush kushtet ligjore për raportim, që dalin nga Ligji numër 03/L-84 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut numër 2005/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës dhe njëzëri anëtarët e Komisionit e kanë miratuar këtë raport dhe kanë rekomanduar që raporti të miratohet edhe në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hadërgjonaj! Për Grupin e PDK-së flet deputeti Latif Gashi!

LATIF GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës së Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010 dhe ka vlerësuar se i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim dhe si i tillë është vlerësuar edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, andaj do të votojmë për miratim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, zoti Naser Osmani!

NASER OSMANI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për herë të parë po shqyrtojmë një raport që ka të bashkëngjitur edhe pjesën e auditimit për një vit dhe kjo krijon mundësi që deputetët të kenë informacione të bollshme në kuptimin e asaj që të mbajnë Trustin Pensional të përgjegjshëm për politikën investive dhe për menaxhimin e këtyre mjeteve.

Sa i përket Raportit financiar të Trustit Pensional, cilësia e informacionit është përmirësuar dukshëm dhe menaxhimi i mjeteve është bërë konform ligjit dhe mendoj se si raport të tillë duhet ta kalojmë.

Mirëpo, asnjë raport nuk është ideal dhe mbetet shumë punë për t'u bërë që ky raport të jetë me standarde profesionale të raportimit.

Raporti është i ngarkuar me shumë të dhëna të panevojshme, siç janë biografia e disave që nuk duhet të kenë vend në raport, pasi që biografia e tyre është lexuar në momentin kur janë bërë anëtarë të Bordit.

Po ashtu, janë edhe disa të thëna të panevojshme që më tepër kanë karakterin e të dhënave statistikore demografike, se sa e kanë vendin aty dhe ka po ashtu disa krahasime jo të qëndrueshme me disa shtete në regjion dhe merren shtetet varësisht prej arsytimit të cilin duhet ta bëjmë. Kjo ka të bëjë me atë taksën menaxhuese që, thjeshtë, në raport shihet se ka një pakënaqësi nga Trusti, si një taksë e vogël, mirëpo duhet ta kemi në konsideratë që kjo taksë menaxhuese prej 0.65% është aprovuar në këtë Kuvend me kërkesën e vetë Trustit Pensional, mirëpo nga ana tjetër mund të kenë të drejtë që të kërkohej edhe një ndryshim për arsye se kjo nuk mjafton edhe për këtë pjesën e shpenzimeve investive dhe për shpenzimet operationale, sidomos për pjesën e shpenzimeve investive pasi që sasia e mjeteve të Trustit është rritur edhe ka nevojë për

shpenzime më të mëdha për menaxhimin e këtyre mjeteve, mirëpo nuk ka vend assesi në këtë raport që shprehen pakënaqësi lidhur me shpenzimet e mjeteve operationale, do të thotë mjeteve që kanë të bëjnë me paga dhe mëdijtje, pasi që ky institucion edhe më tutje qëndron si një institucion më së miri i financiar në këtë drejtim.

Ajo që më e keqja është në përmbajtjen e këtij raporti, zoti kryesues, është që ka disa shprehje të opinioneve që kanë më tepër karakter politik dhe nuk i takon këtij institucioni t'i paraqes, e më së pakti në raport. Është fjala për disa vlerësime të tyre që i kanë bërë për kohën e fushatës zgjedhore që partitë politike janë deklaruar lidhur me mjetet e Trustit Pensional, duke harruar që Kuvendin e përbëjnë subjektet politike e ata e bëjnë ligjin, ndërsa Trusti është ai institucion që implementon ligjin të cilin e nxjerr Kuvendi dhe nuk është vënë në raport për këtë institucion që është aq shumë profesional për çështje financiare.

Ajo që neve më së shumti si deputetë na intereson lidhur me Trustin Pensional, është çështja e plasmanit të mjeteve apo shpërndarja e tyre që është bërë, që paraqitet në tri kategoritë, janë në tri cilësi, domethënë të mjeteve në aksion, 40% e shumës së Trustit, mjeteve në kthimin absolut, është fjala për 30% të mjeteve të Trustit dhe investimet tjera të ashtuquajtura po ashtu me një përqindje prej 30%.

Në pjesën e parë të investimeve, domethënë është fjala gjithnjë për 40% të mjeteve, mund të konsiderohen si një kontinuitet që mban një ekuilibër të interesave të kontributdhënësve, pra të investimeve të kujdesshme që mbajnë tregun e parave dhe fletobligacione kryesisht të mjeteve mbahen në bankën në Belgjikë, në Vanguard, një institucion që është i respektuar për siguri të lartë investive.

Pjesa e dytë e mjeteve është pjesa e kthimit absolut. Janë mjete me qëllim të investimit, të mbajtura nga rreziku eventual i inflacionit global. Domethënë, janë mjete që kthehen 100% ashtu si edhe plasohen.

Pjesa e tretë e mjeteve, po ashtu 30%, janë në bankat komerciale. Kjo është ajo pjesa që neve më tepër na zgjon kureshtjen. Thjeshtë, është në bankat komerciale, në Bankën Qendrore të Kosovës dhe në tregun e parave të gatshme. Diku janë 6.8 sipas raportimit të Bankës Qendrore, apo 7.5 sipas raportimit të Trustit që mbahen në Bankën Qendrore dhe Banka Qendrore, domethënë është fjala gjithnjë për mjetet pa ndërmjetësues menaxhues dhe janë 9% apo 38 milionë të cilat mandej Banka Qendrore i ka plasuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Britaninë e Madhe, në Japoni, ndërsa pjesa tjetër është e plasuar në tregun e parave të gatshme.

Këto janë të dhëna të mira që të kemi një pasqyrë, mirëpo mungon një e dhënë kryesore që të kemi një pasqyrë më detale lidhur me Trustin Pensional. Unë konsideroj se mungon ajo që është esenciale – cilat janë interesat e mjeteve të plasuar të Trustit Pensional sipas këtyre të ashtuquajtura kategori? Mendimi im personal, kategoria më e mirë është kategoria e tretë, domethënë që ka të bëjë me plasimin e mjeteve në bankat komerciale, thjeshtë në Kosovë. Kjo është ajo në të cilën ne vazhdimisht kemi qëndruar dhe kemi insistuar që Qeveria duhet të bëjë dokumente ligjore valide në bashkëpunim me Bankën

Qendrore të Kosovës, që mjetet e Trustit që nuk janë pak, diku 450 milionë, që përqindja e tyre më e madhe të jetë e plasuar në Kosovë, duke u paraqitur Qeveria si garantuese e një sasive të mjeteve të cilat do të ishin përdorur për qëllime të caktuara. Prandaj, mendoj që duhet të ketë një debat lidhur me politikën menaxhuese të këtij institucioni, por nuk ka vend që të bisedojmë tash në raport për arsye se kemi një temë të caktuar. Unë e di që shumë kolegë të mi kanë për ta përdorur tash foltoren edhe të përmendin që Trusti këta dy muajt e fundit ka një humbje prej 22 milionë, mirëpo ne përpara kemi të bisedojmë për Raportin vjetor për vitin 2010 dhe unë thërras kolegët që aprovojnë këtë raport, ndërsa të përgatitemi për diskutime profesionale për politikën menaxhuese që normalisht ka si konsekuencë ndryshimin e Ligjit të këtij institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Florin Krasniqi, për Grupin e “Vetëvendosjes”!

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit!

Ne, si Grup Parlamentar, nuk do ta votojmë këtë raport, do të votojmë kundër. Arsyet janë të shumta, por do të përpiqem t’i sqaroj disa prej tyre.

Ne, si Lëvizje dhe si Grup Parlamentar mendojmë që këto mjete ishte dashur të investohen në Kosovë, po çka ka ndodhur, nuk do të merremi me të kaluarën.

Ky raport është shumë i detajuar, po në fakt për pesë vitet e fundit, kur merret parasysh inflacioni dhe të ardhurat prej këtyre investimeve, del negativ, çka do të thotë se Kosova dhe punëtorët e Kosovës në Trustin Pensional kanë humbur para për këto pesë vjetet e fundit.

Fakti se kjo humbje që i është shkaktuar Trustit Pensional dhe askush nuk është marrë në përgjegjësi, as Bordi, as menaxhmenti, është shqetësues për neve.

Ne mendojmë se këto mjete duhet të kthehen në Kosovë, jo të harxhohen në Kosovë, por të investohen në Kosovë. 450 milionë janë shumë para për tregun financiar të Kosovës, andaj ne si parlamentarë dhe si përfaqësues të popullit kemi obligim që të punojmë për t’i kthyer këto para sa më shpejt në Kosovë dhe të zhvillohet ekonomia vendore me këto mjete.

Arsyet themelore pse ne nuk do ta votojmë, është fakti se edhe sot, dhe gjithë ditën vazhdojnë të humbin para të këtij Trusti. Dhe një kolegë e përmendi se ne nuk do të flasim për atë, por mendoj se është e dhembshme në qoftë se ne nuk flasim, se sot brenda ditës me siguri janë humbur 100.000 a nuk di sa janë humbur të këtij Trusti në investimet që janë bërë gabimisht, mendojmë prej Bordit dhe menaxhmentit. Andaj, ne nuk mund ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit edhe prej teje! E ka fjalën Xhevdet Neziraj, për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës!

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuari zoti nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër dhe kolegë deputetë,
Raporti i Trustit Pensional paraqet një përmbledhje të aktiviteteve kryesore të Trustit, si organizimi i brendshëm, mandej performanca e investimeve dhe shumë detaje tjera.

Unë do të kisha përmendur një thënie që është në raport, se si e arritur e Trustit në vitin 2010 është kthimi i mjeteve financiare të humbura, mirëpo na ka ndodhur që mu në këtë pjesë të vitit, të kemi prapë humbje. Një e arritur tjetër që Trusti është lëvduar, është edhe ulja e taksës menaxhuese nga 0.80 në 0.65 dhe mandej ankohen se kjo tarifë 0.65 nuk i mbulon shpenzimet operationale të tyre dhe ne besojmë si Grup që kjo taksë duhet të ulet edhe më tepër për arsye se shpresojmë se të ardhurat personale në Trust janë të larta dhe mund t'i harxhojnë mjetet për shpenzime operationale më mirë se sa që duhet, për arsye se ulja e kësaj takse ka kontribuar në atë sepse është rritur numri i kontribuesve në pensione.

Një problem dhe një shqetësim tjetër për Grupin e Aleancës është vetëm të shikojmë faqen 25, ku është alokimi i mjeteve të investuara në vitin 2010 dhe nga kjo shohim se vetëm 7% të këtyre mjeteve janë të investuara në bankat e Kosovës, ndërsa mbi 92% janë të investuara jashtë vendit. Kjo është shqetësuese për ekonominë e Kosovës, është shqetësuese për ekonomistët dhe është shqetësuese për të gjithë. Mirëpo, me ndryshimin e ligjit, që do të bëhet në të ardhmen dhe Qeveria e Kosovës në këtë drejtim duhet të përgatit legjislacionin si të letrave me vlerë dhe tregjeve financiare me qëllim që investimet të bëhen në Kosovë, të menaxhohen në Kosovë, për arsye se Kosova ka nevojë për këto investime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Xhevdet! Fjalën e ka për Aleancën Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Muzejene Selmani!

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Duke marrë parasysh se Raporti vjetor 2010 i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës është shqyrtuar edhe nga Koalicioni për Kosovë të Re dhe duke marrë parasysh rekomandimet e komisionit parlamentar, në raport shihet një gjendje në të cilën ka kaluar Trusti për vitin 2010 dhe paraqitet gjendja faktike e të gjitha kursimeve kah janë dorëzuar, nëpër cilëndo bankë, mirëpo esenca e krejt kësaj çështjeje u potencua edhe nga deputeti i LDK-së që çështja e investimeve të Trustit të investohet në banka komerciale.

Do të jetë kjo një temë e posaçme, ndoshta në seancat e radhës. Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah në parim Raportin e Trustit Pensional për vitin 2010. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Selmani! Për Grupin SLS, Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Način na koji funkcioniše Trust kosovskih penzionih štednji i njegova uspešnost duboko determinišu ekonomske i socijalne prilike na Kosovu. Naravno da je za građane Kosova najbitnije pitanje veličine njihovih penzija i budućnost njihovih penzionih štednji. Mi anas, kao odgovorni ljudi moramo sagledavati koja su to moguća poboljšanja.

Podatak da se doprinosi uplaćuju za ukupno 235 hiljade radnika i činjenica da su doprinosi na Kosovu realno mali, govori pre svega o stanju kosovske privrede. Međutim, treba biti jasan da se uspeh Trusta kosovskih pensionih štednji zasniva na uspešnost menažiranja i plasmanima sredstava kojim raspolažu.

U tom smislu, mislimo da je plasman slobodnih finansijskih sredstava vršen sa merom, imajući pri tom u vidu odnos 40 prema 30% po osnovu sigurnosti finansijskog ulaganja.

Zadatak svih nas je da stvorimo uslove da se jedan od podataka iz ovog izveštaja u što kraćem periodu reši. Naime, od ukupnog plasmana, od oko 450 miliona evra, samo se mali deo plasira na Kosovu i to nažalost samo u bankarski sektor.

Sa druge strane, Kosovu su neophodne investicije za pokretanje proizvodnje. To je jedini način za rešavanje velikih problema standarda svih građana. Zato je na svima nama da se založimo da se što pre stvore uslovi kako bi se omogućio da svetski fondovi, pa i ovaj kosovski, pronađu interes za investiranje na Kosovu.

Izveštajnu godinu koju razmatramo na globalnom planu, karakterišu najveći berzanski lomovi u istoriji sveta. S toga je realan uspeh očuvanja poslovanja ovakvih investicija.

Činjenica da postoje pomaci u radu, daje pravo na optimizam. Neki od ovih pomaka imaju i simboličan značaj, kao što je smanjenje udela plata u budžetu Trusta.

Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke podržaće ovaj godišnji izveštaj. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi!

NIJAZI IDRIZI: Inderuari kryesues,

I nderuari zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Në raport shihet se deri më tani Trusti ka investuar kryesisht në tregjet financiare ndërkombëtare, por edhe në Kosovë në depozita bankare në Reiffeisen Bank dhe në NLB Prishtina, që është një hap i rëndësishëm dhe inkurajues për rritjen ekonomike të vendit tonë.

Për orientimin e investimeve edhe më të mëdha të mjeteve të Trustit në Kosovë, duhet që edhe më tutje të zhvillohet tregu financiar i vendit. Për të arritur këtë, duhet të angazhohet edhe më tepër Banka Qendrore e Kosovës, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Për gjenerimin dhe administrimin e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës duhet të angazhohet edhe më shumë Ministria e Financave. Po ashtu, është e nevojshme të ndryshohet Ligji mbi Fondin Pensional të Kosovës, i cili do të bëjë të mundur që së paku 20, 30% të vlerës së mjeteve të Fondit të Trustit të investohet obligativisht në letrat me vlerë në tregun financiar të Kosovës.

Kjo është një zgjidhje që duhet të merret parasysh dhe të zbatohet sa më shpejt për shkak se sot kudo në botë, e sidomos në vendin tonë ka mungesë të parave të gatshme të cilat ofrohen me interesa të favorshme për ndërmarrësit.

Duhet të bëhet liberalizimi më i shpejtë i tregut të pensioneve me qëllim që të shfrytëzohet i tërë potenciali për kursime dhe investime për pensionet e ardhshme, që qytetarët tanë mos të mbeten vetëm me pensione bazë që jepen nga buxheti i Kosovës, por të kenë edhe pensione nga kursimet e tyre vetanake.

Të shpresojmë që për këtë zgjidhje të proklamuar të institucioneve tona financiare dhe legjislative do të punojmë edhe më tepër, sidomos Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Financave, Banka Qendrore dhe Kuvendi i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka më diskutues tjerë. Sipas shënimeve tona, kemi 75 deputetë në sallë, megjithatë ta aprovojmë tash. Regjia, bëhu gati për regjistrimin elektronik të pranisë, ju lutem. Regjistrimi elektronik i pranisë! Votojmë për prezencë, deputetë!

Janë 69 të pranishëm, sipas regjistrimit elektronik, ka edhe të tjerë që do të deklarohen.

Regjia, votojmë tash për shqyrtimin e Raportit vjetor të punës të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2010, votojmë tash!

“Për” 57, “kundër” 10, zero abstenim, dhe pa kartelë është edhe 1 “kundër”, 11 u bënë. Kush është “kundër” tjetër? Nuk ka. Atëherë, 11 janë “kundër”, 57 “për”, 5 abstenojnë.

Konstatoj që Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2010.

Kalojmë në pikën e shtatë:

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Komisioni funksional për Buxhet e Financa, në pajtim me nenin 37 pikë 2 të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe nenit 17 pikë 3 të Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, ka shqyrtuar Propozim-buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 23 qershor – 31 dhjetor 2011 dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimet për miratim.

Radhitja e diskutimeve është, kryetarja e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!
I nderuari zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 37 pikë 2 të Ligjit numër 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale, fondet për Agjencinë sigurohen nga buxheti i Kosovës.

Buxheti i Agjencisë përcaktohet nga Kuvendi i Kosovës, por me propozimin e mbikëqyrësit kryesor shtetëror.

Duke pasur parasysh faktin se në seancën plenare të datës 23 qershor të vitit 2011, Kuvendi ka emëruar mbikëqyrësin kryesor shtetëror dhe katër mbikëqyrës shtetëror të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është obligim i Kuvendit që të bëjë edhe miratimin e buxhetit të këtij agjencioni.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, në mbledhjen e mbajtur me datën 24.8.2011, ka shqyrtuar kërkesën buxhetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave dhe i ka rekomanduar Kuvendit një buxhet të këtij Agjencioni Shtetëror për 6 muajt e vitit 2011.

Ky propozim i cili ka ardhur këtu në Kuvend, është miratuar njëzëri nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Komisioni i ka rekomanduar Kuvendit të miratojë buxhetin për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave për periudhën 23 qershor dhe 31 dhjetor, mirëpo shpenzimet janë llogaritur vetëm për 4 muaj, kurse për disa shpenzime të Agjencionit janë llogaritur prej 23 qershorit, që i shihni të bashkëngjitura në tabelën që iu ka bashkëngjitur shkresës që i është dorëzuar Kuvendit, në shumën prej 189.786.04 euro.

Sipas linjave buxhetore të paraqitura, kuptohet në tabelën 1 dhe 2, si aneks i këtij rekomandimi dhe rekomandohet Ministria e Financave që në pajtim me nenin 17.3 të Ligjit numër 04/001 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2011, të bëjë ndarjen e mjeteve buxhetore duke bërë shkurtime përkatëse në ndarjet tjera buxhetore në vlerën e njëjtë për buxhetin e rekomanduar për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011.

Njëkohësisht, Komisioni ka rekomanduar që Ministria e Financave të përfshijë Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si organizatë të veçantë buxhetore me kode të reja brenda tabelave të buxhetit për vitin 2011.

Rekomandoj që Kuvendi të bëjë miratimin e kësaj kërkesë buxhetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave, në emër të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e PDK-së, flet Hasime Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar dhe analizuar rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e Agjencisë Shtetërore për

Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe si Grup Parlamentar e mbështesim rekomandimin me qëllim të funksionalizimit të plotë të këtij institucioni, i cili do të ndikojë në plotësimin e prioriteteve të Qeverisë së Kosovës, plotësimin e standardeve evropiane, përmbushjen e planit të veprimit për vitin 2011 për implementimin e partneritetit evropian, si dhe sundimin e ligjit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Naser Osmani!

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Pajtohem që të përkrahet, ashtu siç e ka rekomanduar Komisioni për Buxhet dhe Financa, meqenëse në qershor kur është prurë nga Qeveria që të votohet ky institucion apo njerëzit që janë në të, është dashur të jetë edhe pjesa e mbulimit financiar. Por, meqenëse ne kemi punuar në komision dhe kemi ardhur deri te një përfundim për mjetet e nevojshme për këtë gjashtëmujor të nevojave të këtij institucioni, konsideroj që është çështje e ministrit të Financave se ku do t'i gjejë burimet, por nuk do të ishte mirë që të prekë pozicionet tjera që të bëjë ndërhyrje, se ajo nënkupton revidim të buxhetit dhe për një gjë të tillë është një procedurë krejtësisht tjetër, por shpresojmë që kanë rezerva tjera prej nga do t'i mbulojnë këto mjete dhe konsideroj që edhe kjo shumë të cilën ne e kemi caktuar, nuk ka për t'u shpenzuar pasi që ka kaluar një periudhë e gjatë, nuk ka për të pasur as kohë për procedura, sidomos për këtë pjesën e investimeve kapitale dhe konsiderojmë që ministri i financave, sipas nevojës për këtë institucion, të bëjë mbulimet e shpenzimeve deri në përfshirjen e tyre për buxhetin e vitit 2012. E përkrahim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, deputetja Albana Fetoshi.

ALBANA FETOSHI: Ju faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ndarjen buxhetore, do me thënë ndarjen buxhetore të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupin Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, Muzejene Selmani

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah rekomandimet për miratimin buxhetit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 23 qershor deri më 31 dhjetor 2011. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupin Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në emër të saj, zoti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, rekomandimet e Komisionit të Buxhetit i miraton, mirëpo një shqetësim është se Qeveria e Kosovës duhet të bien një vendim që të gjitha agjencionet të paguhen në një normë të caktuar dhe të mos ketë laramani në mes të agjencioneve të ndryshme për arsye se po kemi problem me caktimin e pagave dhe shpenzimeve tjera për arsye se në Kosovë janë diku mbi 28 agjencione të cilat paguhen në forma dhe mënyra të ndryshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Për Grupin Parlamentar SLS, deputetja Jelena Bontiq!

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržala je analizu predloženog budžeta novoformirane Nezavisne agencije za zaštitu ličnih podataka, formiranje ove agencije od velikog značaja za kosovsko društvo. Što se samog budžeta tiče, mišljenja smo da je realan, iskazuje stvarne potrebe za rad ove agencije, zato ga i u celini podržavamo.

Smatramo da je kod izvede ovog budžeta, postignut napredak jer su troškovi iskazani transparentno i u skladu sa mogućim budžetskim opterećenjima za razliku od nekih već postojećih agencija. S tim u vezi, smatramo da bi trebalo napraviti uporednu analizu budžeta svih agencija i utvrditi dali su postojeće razlike posledice samo specifičnosti rada pojedinih agencija i dali praksa pokazuje potrebu za eventualnim korekcijama. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Nuk ka më të tjerë që donë të flasin. Për këtë rekomandim, unë ju njoftoj që në sallë janë 67 deputetë. Për të mos krijuar mundime të forta, votojmë tash dokumentin! Regjia, votojmë tash!

Me 66 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa për buxhetin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për periudhën 23 qershor deri më 31 dhjetor 2011.

Kalojmë në pikën 8 të rendit të ditës, që është:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Unë e ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, kush e paraqet ligjin, ministrin Bajram Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit të Kosovës ta praqes dhe arsyetojë Projektligji. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Në këtë seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, para jush paraqes Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës është miratuar nga Qeveria me vendimin nr. 02/33, të datës 17.08.2011.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në mbulimin e fushës së organizimit, funksionimit dhe kompetencave të Qeverisë dhe të ministrive, duke saktësuar ndarjen e punëve dhe të raporteve në mes tyre, si institucione ekzekutive dhe raporte me organet e administratës dhe institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj përcaktohen parimet udhëheqëse të Qeverisë si pushtet ekzekutiv që udhëhiqet nga parimi i respektimit të ligjit, përgjegjshmëria, transparenca, si dhe nga parimi i efikasitetit dhe efektshmërisë.

Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës përcakton përbërjen, mandatin e Qeverisë, fillimin dhe përfundimin e mandatit të anëtarëve të Qeverisë, si dhe Qeverinë në largim. Pa ashtu, me këtë projektligj përcaktohet statusi i anëtarëve të Qeverisë, metodat e punës së Qeverisë, si dhe aktet me të cilat vendos Qeveria.

Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian. Para dhe gjatë hartimit të këtij projektligji, janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjëra nga natyra e kësaj fushe.

Kam nderin që pata rastin t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj, të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti ministër!

Atëherë, fillojmë me radhën e diskutimeve për ligjin. I pari e merr fjalën zoti Idriz Vehpi i cili flet si kryetar i komisionit funksional. Zoti Idriz Vehapi!

IDRIZ VEHAPI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderur zëvendëskryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Komisioni funksional, me datën 09.09.2011, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe me këtë rast ka vlerësuar se i njëjti i plotëson të gjitha kriteret e parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Atëherë, kalojmë me përfaqësuesit ose shefat e grupeve parlamentare. Unë këtu e kam në regjistër, që për Grupin Parlamentar të PDK-së, do të flasë Xhevahire Izma.

XHEVAHIRE IZMAKU: Ju faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për Qeverinë e Kosovës dhe është mirë që sot për herë të parë Kuvendi po krijon një infrastrukturë ligjore për funksionimin dhe strukturën e Qeverisë.

Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës përcakton pra organizimin dhe funksionimin e Qeverisë, mënyrën e punës dhe procedurat e vendimmarrjes, bashkëpunimin e Qeverisë me institucionet e tjera të përcaktuara në Kushtetutë. Ne, në punët tona në vazhdim në Komision do të japim kontributin aty ku mendojmë se duhet të shtohet diçka apo të shtojmë diçka tjetër. Mendoj se tani ka nevojë të mbështet ligji, në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin Parlamentar “Vetëvendosje”, flet Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për Qeverinë që po e shqyrtojmë sot, është më se i domosdoshëm, sepse deri më tani parimi organizativ i strukturimit të Qeverisë kanë qenë disa rregullore, fillimisht të UNMIK-ut, e më pastaj të mëvonshme të hartuara nga vetë Qeveria. Pra, se Qeveria ka nevojë për një bazë ligjore, e cila themelon dhe shuan postet ministrore, kjo është më se e qartë. Po ashtu, duhet pasur parasysh edhe faktin tjetër se ndryshimet në strukturën qeveritare kanë edhe ndikim financiar, andaj së bashku me Ligjin për Qeverinë duhet të hartohet edhe vlerësimi i ndikimit financiar.

Mos ekzistenca e një ligji për Qeverinë dhe kufizimi i rolit të Kuvendit të Kosovës për të përcaktuar strukturën e Qeverisë, të cilën ai e zgjedh, ka bërë që struktura qeveritare të rritet pambarimisht, duke mos pasur një bazë ligjore që vendos rregullat e krijimit dhe shuarjes së portfoleve ministrore. Por shtrohet pyetja, se ky projektligj, në formën që na ka ardhur para nesh, me këtë format dhe në këtë mënyrë, a i plotëson këto nevojat e domosdoshme për të krijuar një transparencë më të madhe në të gjitha segmentet e organizimit të saj dhe përgjigja është padyshim se - jo. Për më tepër, ky projektligj, në këtë mënyrë si është sponzoruar, është edhe antikushtetues dhe si i tillë i mungojnë qëllimi dhe përkufizimet e tij.

Ky projektligj në njëfarë mënyre synon pikërisht që ta legalizojë gjendjen aktuale që dominon në këtë Qeveri dhe jo të krijojë bazë ligjore për funksionimin e saj. Siç dihet, kjo Qeveri tashmë ka kryeministrin, 6 zëvendëskryeministra, 19 ministra dhe 33 zëvendësministra. Secili nga këto poste ka edhe kabinetin e tij. Përbërja e kabinetit për këto poste ministrore është e përcaktuar me Rregulloren për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrave. Duke llogaritur shpenzimet

vjetore për paga bruto, shpenzimet e komunikimit dhe të reprezentacionit, del se Qeverisë së Kosovës vetëm për këto kategori të shpenzimeve i nevojiten afër 4 milionë euro në vit, pa llogaritur në këtë mes shpenzimet për blerjen e aparateve mobil, automjete dhe shpenzimet për karburante, të cilat po ashtu kapin shufra milionëshe.

Për shkak të mostransparencës së Qeverisë, është e pamundur që të dihet numri i përgjithshëm dhe vlera e saktë e telefonave mobil, numri dhe vlera e automjeteve zyrtare dhe shpenzimet e zyrtarëve të lartë publikë për karburante. Pikërisht neni 3, pika ku tregon përbërjen e Qeverisë, pikërisht nuk e precizon numrin e ministrave, duke lejuar hapësirë që kjo çështje të rregullohet jo mbi bazën ligjore, por mbi bazën e kalkulimeve politike ditore dhe ta shndërrojë Qeverinë në instrument për të plotësuar këto kalkulime, siç po ndodhë edhe tani. Kjo logjikë, në fund e shndërron paranë publike në mjet për të blerë mbijetesën qeveritare e jo një diçka që duhet të përdoret për rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.

Ndërkaq, duke qenë se Kosova është Republikë parlamentare dhe se Qeverinë e zgjedh Kuvendi, është nevojë imediate që vetë Qeveria t'i nënshtrohet një kontrolli parlamentar, kurse ky projektligj, në nenin 27, pika 2, thotë se Qeveria e njofton Kuvendin për programin e punës dhe planin periodik të punës, për më tepër ky nen është kundërshtim me vetë Kushtetutën e Kosovës, në nenin 97, pika 1 e saj ku thotë se: "Qeveria për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës", e jo siç thotë projektligji se ajo e njofton Kuvendin.

Përfundimisht, Kosovës i nevojitet një ligj për Qeverinë, por jo në këtë formë çfarë e kemi para neve. Kuvendi i Kosovës zgjedh Qeverinë e vendit, por sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas këtij projektligji që na ka ardhur, në momentin që Qeveria zgjidhet, kryeministri i ka duart e lira që të shkarkojë tërë kabinetin e tij qeveritar, ta zëvendësojë me anëtarë të rinj, të shuaj dhe themelojë ministri dhe poste ministrorë pa pasur nevojë të marrë pëlqimin e Kuvendit.

Nuk ekziston bazë e qartë ligjore për themelimin dhe shuarjen e posteve ministrorë. Qeveria nuk është treguar transparente në publikimin e kostos së Qeverisë për vlerësimin e ndikimit financiar. Përmbajtja e Rregullores së punës së Qeverisë nuk është konform Ligjit për qasjet në dokumentet publike. Me këtë Rregullore nuk lejohet publikimi i transkripteve dhe procesverbaleve të mbledhjeve të Qeverisë, si dhe nuk parashikohet pjesëmarrje publike në përcjelljen e punimeve qeveritare.

Ligji për Qeverinë duhet t'i jap të drejtë Kuvendit për të themeluar dhe shuar postet ministrorë. Qeveria së bashku me draftin e ligjin, në Kuvend duhet të dërgojë edhe vlerësimin e ndikimit financiar të Ligjit mbi Qeverinë, në të cilin parashihen shpenzimet për pagat e anëtarëve të Kabinetit, të veturave zyrtare, shpenzimet e komunikimit telefonik, reprezentacionit e tjera.

Konform Ligjit për qasje në dokumente zyrtare, Qeveria e Kosovës duhet që të publikojë këto raporte të shpenzimeve, Rregulloren për nivelin e pagave të anëtarëve të Qeverisë dhe të anëtarëve të kabinetit të tyre, raportin mujor për shpenzimet e telefonave apo të

komunikimit, të cilat hartohen nga Departamenti i Teknologjisë Informative, bazën e të dhënave të të gjitha automjeteve të cilën e posedon Njësia për monitorimin e përdorimit të automjeteve, të dhënat e detajuara për kodin e veçantë ekonomik për shpenzimet e reprezentacionit dhe Rregulloren për kompensimin për vizita zyrtare jashtë vendit.

Pas miratimit të Ligjit për Qeverinë, Qeveria duhet të ndryshojë Rregulloren e saj të punës dhe ta përshtatë atë me Ligjin për Qeverinë dhe Ligjin për qasjen në dokumente publike. Duke qenë se ky projektligj në këtë mënyrë se si na ka ardhur, nuk i përmban asnjërën nga këto rekomandime, Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do ta përkrah as në parim këtë projektligj në këtë format. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tash e ka fjalën Lidhja Demokratike e Kosovës, flet në emër të grupit deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi i LDK-së, pas shqyrtimit të këtij propozim ligji, me qëllimin më të mirë që ky ligj të bëhet akoma ma i mirë, do të kishim theksuar disa prej momenteve më të rëndësishme, ndërsa pastaj ne do të angazhohemi në kuadër të komisionit funksional, gjegjësisht të grupeve punuese në implementimin e ideve tona.

Konkretisht, në nenin 3, ani pse çështja e Qeverisë është kategori kushtetuese dhe përshkruhet në Kushtetutë se është kompetencë e kryeministrit dhe organizimit të brendshëm, megjithatë duke i parë praktikatat dhe presionet e vazhdueshme, ne mendojmë po qe se ka vullnet politik, në këtë ligj ka mundur të theksohet cili është ai maksimumi, madhësia më e madhe që mund ta ketë Qeveria, ndërsa më pak do të mund pastaj të jetë vullneti i Qeverisë të organizohet, kjo për arsye se, siç dihet, Qeveria, Kabineti qeveritar i Republikës së Kosovës është një prej më të mëdhenjve, të them ndoshta edhe në Evropë, por edhe nuk përjashtohet mundësia nën presionet e ndryshme që kjo edhe të rritet edhe në të ardhmen. Prandaj, që mos të jetë pasojë e presioneve të ndryshme dhe e koalicioneve të vogla dhe të mëdha, ne jemi të propozimit që të përcaktohet një maksimum sa kishte për të qenë madhësia e Kabinetit qeveritar.

Te neni 8, pika 2, sikurse propozojmë që të mos figurojë formulimi: “të jetë i detyruar”, ku bëhet fjalë tek Qeveria në dorëheqje, por “duhet” apo “mundet”, por jo “të jetë i detyruar”.

Ndërsa, tek neni 8, pika 5 dhe 6, ne propozojmë që Qeveria në dorëheqje apo Qeveria me mandat të rregullt, por që nga momenti kur përshkruhen zgjedhjet, të mos ketë të drejtë të lidhë kontrata të cilat pastaj krijojnë obligime të financimit në vitet e ardhshme, ngase siç dihet, në kohën e fushatave mund të propozohen dhe të premtohen projekte të cilat nuk janë me prioritet dhe të cilat krijojnë dilema se a është motivi i fushatës dhe premtimeve apo është motivi i mirëfilltë i financimit të të njëjtave kontrata, çka Kosova

veç ka pasur praktika të tilla, që në kohë të fushatës të lidhen kontrata, të cilat pastaj i kanë krijuar probleme Kosovës. Pra, propozimi ynë në grupin punues që do të jetë që të ketë formulime të sakta që do të limitohet, të limitohet Qeveria në dorëheqje apo Qeveria në prag të zgjedhjeve të rregullta.

Ndërsa neni 27, pika 2, që lidhet me Planin e Qeverisë, Planin e punës apo planet periodike, ne mendojmë se këtu duhet të ketë një formulim qoftë që Qeveria e njofton apo e paraqet planin, por unë mendoj se duhet edhe të përkufizohet për të cilin afat kohor po bëhet fjalë. Do të kishte qenë më e mira që gjithmonë, me qenë se Parlamenti e diskuton buxhetin dhe e voton Ligjin për buxhetin, kishte për të qenë mirë që edhe Plani i punës së Qeverisë të jetë në të njëjtin kohë, që deputetët ta dinë se për cilin buxhet dhe për cilën strukturë të buxhetit po bëhet fjalë konform të një plani të punës të Qeverisë. Apo, nëse ka mungesë vullneti politik për këtë, atëherë së paku të jetë më së largu deri në marsin e vitit të ardhshëm, për vitet e rregullta apo tre muaj pas konstituimit të Qeverisë dhe këtë propozojmë që, kur bëhet fjala për planin, që i njëjti t'u paraqitet deputetëve me shkrim.

Në përgjithësi, pra, ne e mbështesim në parim këtë ligj dhe do të angazhohemi që në grupin funksional apo në grupet e punës të kontribuojmë me idetë tona, në mënyrë që ligji të dalë sa më komplet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi i grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Mendoj se rrjedha logjike e gjithë kësaj pune kishte për të qenë që Kuvendi ta bëjë Ligjin për Qeverinë. Nominalisht ndodhë që Kuvendi e voton në fund të fundit, mirëpo ndoshta kishte qenë dashur që Kuvendi të mendojë se çfarë Qeverie do. Sidoqoftë, mendoj se më mirë është të ketë ligj për Qeverinë, se sa mos të ketë ligj për Qeverinë, kështu që sikur edhe disa herë më përpara, fjalën e fundit, të parën, ne do ta votojmë në parim këtë projektligj, edhe pse mendojmë se ka probleme, ka të meta të cilat po përcillen, që janë përcjellë edhe prej praktikës së Qeverisë në të kaluarën, mirëpo mendojmë se me votimin në parim, ende do të ketë gjasa që në komisionin funksional dhe në komisionet tjera, të cilat do të angazhohen që të punojnë në këtë projektligj, të bëhen disa përmirësime.

Do t'i përmend disa probleme thelbësore që kanë të bëjnë me qeverisjen në Kosovë. Një prej tyre është pengimi i ndërtimit të një udhëheqësie normale qeveritare. Ne kemi provizion kushtetues që ministrat, në momentin që e marrin detyrën duhet të japin dorëheqje prej të qenit deputet. Kjo mund edhe të duket në rregull, mirëpo menjëherë pastaj qoftë me Kushtetutë, qoftë me ligj, e kemi të paraparë që kryeministri të nesërmen në mëngjes mund t'i shkarkojë prej pozitës.

Kjo nuk është mënyra rrjedhojë që punohet nëpër kuvende, nëpër demokraci parlamentare, ka mënyra tjera për shkak se, nëse e shihni projektligjin dhe i lexoni pozicionin, kompetencat, detyrat dhe të drejtat e ministrave dhe i krahasoni me ato të

këshilltarit politik, ju dalin njëjtë. Do të thotë, nëse pesha ose pesha me të cilën zë vend një ministër, është e barabartë me të këshilltarit politik, i cili mund të shkarkohet për dy minuta punë, jo më tepër se dy minuta me një shkrim në letër, atëherë Kosova lirisht mundet të ketë një ministër, i cili është edhe kryeministër dhe çka do qoftë në të njëjtën kohë dhe të tjerët t'i ketë këshilltar të cilëve ju ndanë detyrat. Domethënë, vetë fakti që kemi krijuar një situatë të tillë, mendojmë se krijojmë ndërvarësi tepër problematike edhe për sa i përket konstalacionit politik në Kosovë, për shkak se në Kosovë pak ka qeveri pa koalicioni dhe në këto rrethana do të jetë shumë e vështirë për kryeministrin që ta largojë ose ta shkarkojë një ministër eventualisht shumë të keq, nëse vjen nga partia e partnerit të koalicionit, për shkak se në të njëjtën kohë atë person do ta qonte në shtëpi për gjithë jetën.

Domethënë, këto janë probleme të cilat po na përcillen që një kohë dhe mendoj se duhet të zgjidhen. Edhe unë kisha përsëritur diçka që u tha më përpara. Kemi nenin 21, ku thuhet që Qeveria bashkëpunon me Kuvendin. Do të jemi të qartë, Qeveria i nënshtrohet Kuvendit, Kuvendi është organ i cili e zgjedhë dhe Qeveria nuk e njofton Kuvendin, por e ka të përcaktuar me ligj se cilat janë marrëdhëniet në mes Kuvendit dhe Qeverisë. Mendoj se edhe neni 26, te aktet, se çfarë akte mund të nxjerrë Qeveria, cilat janë ato vendime të cilat mund t'i marrë Qeveria, të cilat mund ta kenë peshën e dekretit, sepse në mënyrën e si është formuluar neni 26, Qeveria ka të drejtë që të nxjerrë akte të cilat e kanë fuqinë e ligjit dhe ato janë esencialisht, në shumicën e vendeve quhen dekrete. Do të thotë, i kemi dy pika fokale ekzekutive në Kosovë që po na krijohen.

Në periudhën kur jemi duke e amenduar Kushtetutën, e kemi një pikë fokale Presidentin dhe në anën tjetër e kemi pikë fokale Qeverinë, e cila përpos kompetencave të drejtpërdrejta ekzekutive që i ka, po i jep vetes të drejtë edhe për të nxjerrë dekrete edhe, nëse në një shtet, nëse një shtet i cili duhet të jetë funksional, ekzistojnë dy pika të fuqishme ekzekutive, atëherë historia e demokracive na dëshmon që ato shtete kanë dështuar. Mundemi edhe të përmend cilat shtete, ato janë: Egjipti, Bellorusia, janë shtete në të cilat ose ka pasur revolucion ose është gati për të pasur revolucion për shkak se piramida e shtetit nuk funksionon me dy pika fokale ekzekutive dhe duhet të spastrohen.

Fundi i fundit, edhe një herë Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim këtë ligj. Mendojmë se përkundër të metave, është mirë që të kemi Ligj për Qeverinë e Kosovës, do të provojmë që gjatë punës nëpër komisione ta përmirësojmë për aq sa është e mundshme, mirëpo mendojmë se shumë shpejt Kosova për ta rregulluar sistemin e vet qeverisës, do të përballet edhe me elementet tjera qoftë kushtetuese, qoftë ligjore, në mënyrë që ne të mos jemi i vetmi vend në botë, në të cilin thuhet: të gjithë zyrtarët politikë janë qatipa dhe nuk mund të ketë sistem të ndërtimit të lidërshit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!

Për Koalicionin Kosova e re, Deputeti Muhamet Msutafa.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe ne e përshëndesim përgatitjen e këtij projektligji mbi Qeverinë e Republikës së Kosovës për arsye se konsiderojmë si një hap në drejtimin e duhur që të përkufizohen më mirë kompetencat dhe përgjegjësitë e Qeverisë, si pushtet ekzekutiv. Dhe pikërisht kjo që e thash në fund, duhet më tepër të vjen në shprehje në tërë frymën e ligjit dhe përmbajtjen e ligjit se Qeveria është një pushtet ekzekutiv. E duke u nisur nga kjo nevojë, ne do të angazhohemi aktivisht në punën e komisioneve që të korrigjohen disa dobësi të këtij projektligji, të cilat mund të them se janë të konsiderueshme.

Në rend të parë, duhet të jetë e qartë se Qeveria është përgjegjëse për gjendjen sociale ekonomike e politike në një shoqëri. Në qoftë se në një shoqëri punët nuk shkojnë mirë dhe ka probleme, qoftë në tërësi, në aspektin e zhvillimit ekonomik, në aspekte sociale, në aspekte të stabilitetit ekonomik, në aspektet e shtruarjes së pushtetit në kuptimin e plotë, edhe Qeveria duhet të mbahet përgjegjëse dhe duhet të jetë përgjegjëse.

Nuk është sa duhet në këtë ligj e theksuar se Qeveria ka një rol dhe një përgjegjësi primare në zbatimin e ligjit dhe të politikave, si dhe të objektivave programore të cilat i prezanton në Kuvend. Ato strategji, politika të cilat Qeveria i bien në Kuvend dhe aprovohen prej Kuvendit, kanë fuqinë ligjore dhe duhet të zbatohen. Ne kemi pasur situata kur diçka është aprovuar në Kuvend si strategji, dhe mandej ajo strategji është harruar dhe Qeveria ka propozuar krejt diçka tjetër. Domethënë, e dimë se si kanë rrjedhur shumë projekte në fushën e energjetikës, e mos të flasim edhe në sektorë tjerë.

Prandaj, për t'i ikur kësaj, mendoj se në organizimin e Qeverisë brenga kryesore do të jetë cilësia e punës së Qeverisë dhe cilësia e vendimmarrjes. Për të pasur një Qeveri efikase dhe vendime të përgjegjshme, është e domosdoshme që të ngritet baza profesionale dhe baza analitike e përgatitjes së vendimeve dhe ndërtimit të një procesi të përgjegjshëm të vendimmarrjes, i cili merr për bazë alternativat më të mira. Prandaj, këto çështje ndoshta në atë hyrjen duhet të jenë më shumë të theksuara.

Një çështje tjetër është te përgjegjësia e ministrave. Ne do t'i mbajmë ministrat përgjegjës për gjendjen në sektorë të caktuar të cilët ata i mbulojnë. Nuk mund të jetë një ministër i qetë para Kuvendit, në qoftë se në sektorin e caktuar ne kemi probleme. Marrim shembull, merreni një shembull kudo, por në qoftë se në provimin e pjekurisë nacionale na dalin rezultatet që nuk rriten apo dobësohen prej viti në vit, një ministër duhet të japë llogari në Kuvend. Ose në qoftë se rritet vdekshmëria e foshnjave apo nënave ose në qoftë se bien norma e rritjes ekonomike ose në qoftë se rritet inflacioni, këto janë çështje që ministri duhet ta ndiej përgjegjësinë. Ne kemi shembuj kur ministrat japin dorëheqje për shkak të një fatkeqësie të komunikacionit në hekurudhë, prandaj derisa nuk e ndërtojmë një shoqëri që ndien përgjegjësi të tillë, ne nuk mund të kemi garanci se projektet dhe programet të cilat vijnë në Kuvend, do të aprovohen. Prandaj, në nenin 16, mendoj që kjo duhet të jetë qartazi e formuluar.

U tha këtu, ajo që është problematike për mua, që mund të vjen në Kuvend një ligj me përmbajtje të tillë, e që dëshiroj t'ju bashkëngjitëm dy diskutimeve të mëparshme,

është titulli para nenit 27, ku shkruan: “Bashkëpunimi i Qeverisë me Kuvendin”, domethënë ne kemi këtu nivele të barabarta. Në Kushtetutë, Qeveria sigurisht i ka kompetencat e veta dhe e ka pavarësinë e vet, është pushtet ekzekutiv. Ndoshta fjala “bashkërenditje” do të ishte, se nevojitet një bashkërenditje, domethënë që Programi i punës të Qeverisë të harmonizohet me Programin e punës së Kuvendit, ajo është diçka tjetër, por edhe më poshtë, ne nuk e kemi një tekst shumë të qartë që Qeveria duhet t’i përgjigjet Kuvendit, t’i raportojë Kuvendit dhe të marrë direktivat e Kuvendit dhe të zbatojë qëndrimet e Kuvendit.,

Prandaj, në këtë nen dhe në disa aspekte për të cilat unë fola, më tutje duhen ndryshime rrënjësore dhe ne do t’i bashkëngjitemi aktiviteteve dhe deputetëve tjerë për përmirësimin e tekstit dhe do të votojmë për të kaluar në fazën e mëtejme të shqyrtimit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pra, të mbaj për fjale, se je pjesë e koalicionit. Fjalën e merr deputetja Jasmina Zhivković e SLS-së.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem!

I parlamentarna grupa SLS je analizirala predloženi Nacrt zakona o vladi. Zbog same suštine i važnosti ove materije koja se reguliše ovom Nacrtom zakona, grupa će podržati Nacrt zakona, a do konačnog usvajanja ima vremena da radi na detaljisanju i formulaciji odredaba zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit!
Duda Balje, për Grupin “6+”.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Nakon analize dotičnog Nacrta zakona koji pokriva najznačajni aspekt organizacije i funkcionisanja vlade, načina rada i procedure o donošenju odluka u vladi i saradnje vlade sa drugim institucijama određenim Ustavom Republike Kosovo, Parlamentarna grupa „6+“ je donela odluku da podrži zakon u načelu. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë, si edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, natyrisht që e mbështes këtë ligj, edhe pse i duhet Kosovës, edhe pse konsideroj se është shkruar mirë. Por, duke pasur parasysh se është ligji i Qeverisë për Qeverinë dhe mund të shërbej si model edhe për ligjet tjera, mendoj që bën ta mprehim dioptrinë dhe të pretendojmë që ta bëjmë edhe më të mirë.

Që në fillim do të dëshiroja të theksoja 2 – 3 vërejtje që mund të lihen për fund, por që janë të natyrës stilistike. Ky ligj na vjen në dy gjinitë. Në gjuhën shqipe kjo nuk është në rregull me standardin e drejtshkrimit gjuhësor dhe mendoj që nuk është mirë ta praktikojmë, sepse vetëm ngatërrohet.

E dyta, në shumë pjesë ndahet në mënyrë shumë artificiale, absurde lidhorja, që në gjuhën shqipe nuk mund të ndahet.

Dhe, e treta, janë edhe do formula që ligji nuk i duron, si për shembull, duhet, duhet, duhet. Ligji nuk ka shprehje të tilla - duhet.

Po kam edhe një sërë vërejtjesh të natyrës funksionale, të cilat dua t'i theksoj këtu, meqë nuk jam në komisionin që do të punojë në amendamentim, me shpresë se kolegët e mi do t'i kenë parasysh dhe do t'i bëjnë amendamente, që nuk po ndodhë gjithmonë.

Së pari, që në preambulën e ligjit është referenca që është bërë praktikë te ne të bëhet vetëm në nenin 65 të Kushtetutës së Republikës, që flet për kompetencën e Kuvendit për të nxjerrë ligje, por nuk e kuptoj pse mos të jetë edhe referenca te neni 93, paragrafi 3, që obligon ose e autorizon Qeverinë për t'i propozuar ligje kuvendit, edhe në funksion të raportit më të natyrshëm. Mendoj që kjo referencë madje duhet të jetë edhe në shumë ligje të tjera.

Në nenin 2, te parimet udhëheqëse, ligjshmëria, së pari është hartuar në atë mënyrë që do të mund të rishkruhej edhe një herë, por vërehet edhe me syrin e thjeshtë se është fshirë pas asaj se Qeveria ushtron aktivitet e saj në përputhje me kushtetutën. Është një hapësirë ku do të duhej të ishte - ligjin ose ligjet në fuqi dhe pastaj marrëveshjet ndërkombëtare.

Me vetë faktin që ne po miratojmë një ligj për Qeverinë, e bën të domosdoshme që të jetë edhe - ligjin, sepse Qeveria s'mund të injorojë ligjet që e detyrojnë Qeverinë ose e obligojnë Qeverinë.

Në nenin 3, te përbërja e Qeverisë, paragrafi 5, në të vërtetë nuk flet për përbërjen, por po flet për zgjedhjen e ministrave. Kurse neni pasues është për zgjedhjen e ministrave. Mendoj që duhet të bartet atje.

Neni 4, neni vijues, Zgjedhja e anëtarëve të Qeverisë, flet vetëm për kushtet që duhet t'i plotësojnë ministrat për të qenë ministra, për t'u kualifikuar, por jo për procedurën e zgjedhjes. Kjo do të dukej ndoshta edhe formale, por kjo çështja e procedurës së zgjedhjes mendoj që në praktikën tonë është e pa rregulluar. Pajtohem me vërejtjet që u thanë se praktika që ne në një farë mënyre vetëm të bëjmë mandatimin e kryeministrit dhe me këtë të nënkuptohet pastaj se u krye e gjithë puna e formimit të Qeverisë dhe as mos të informohet siç duhet Kuvendi kur emërohet dikush ministër ose kur shkarkohet e zëvendësohet e tjera, vërtet është e pa precedencë dhe, mendoj, jo në rregull. Në këtë nen, po ashtu, ka nevojë për një ripunim të tërë nenit. Në nenin 8, në gjuhën shqipe flitet për Qeverinë në largim, kurse në gjuhën serbe është "Vlada u ostavci", që do të thotë Qeveria në dorëheqje. Qeveria në largim dhe Qeveria në dorëheqje nuk janë e njëjta gjë dhe mendoj që duhet të harmonizohen.

Neni 9 flet, dëgjoni ju lutem, për papajtueshmërinë e anëtarëve të Qeverisë! Çfarë kuptimi ka "Papajtueshmëria e anëtarëve të Qeverisë", me kënd? Është fjala për atë

inkompatibilitetin e funksionit të Qeverisë. Duhet të precizohet, sepse kuptohet sikur është fjala për mospajtimet midis qeveritarëve, etj.

Në nenin 12, ose neni 11, më falni, se e paskam kërcyer, flitet për imunitetin dhe kërkohet që çështja e imunitetit të rregullohet me një ligj të veçantë. Ne kemi një ..., nuk di që kemi një ligj! Vetëm nëse e shkruan Gjykata Kushtetuese, e cila jo vetëm që po e interpreton Kushtetutën, por edhe po na e drafton, po na e shkruan Kushtetutën, siç po dëshiron! Megjithatë, mendoj se çështja e imunitetit do rregullohet në mënyrë uniforme dhe jo ndryshe për një institucion dhe ndryshe për një institucion tjetër.

Neni 12, një nen me shumë paragrafë, shumë i ngatërruar, shumë konfuz, mendoj që do të duhej rishikuar, sepse ka ngatërresa jo vetëm kuptimore gjuhësore, por edhe konceptuale.

Te neni 13, kompetencat e kryeministrit shkojnë edhe përtej Kushtetutës në paragrafin e parë. Por, menjëherë një paragraf më vonë ato reduktohen në kompetencën, të drejtën e kryeministrit për të nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi dhe kuptohet sikur jo edhe marrëveshje ndërkombëtare. Në Kushtetutë lejohet e drejta e kryeministrit për të nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare, prandaj edhe duhet të sqarohet.

Në nenin 25, kërkohet që pagat e anëtarëve të Qeverisë të rregullohen me një ligj të veçantë. Nëse nuk gabohet, ky Kuvend ka miratuar një ligj për pagat e funksionarëve të lartë shtetërorë dhe mendoj që aty është rregulluar çështja, por jo tash për Qeverinë një ligj të veçantë.

Neni 27, Raporti me Kuvendin. U fol këtu dhe unë mendoj që është një raport që do rregullohet. Askund nuk përmendet obligimi i Qeverisë për t'i raportuar Kuvendit. Në Kushtetutën tonë ka një nen që thotë, që flet për ndarjen e pushteteve, po zakonisht harrohet ajo pjesa tjetër e nenit, që flet edhe për kontrollin dhe balancimin e pushteteve, por edhe kontrollin e pushteteve. Mendoj që kjo çështje duhet të rregullohet. Shprehjet e tilla, sikur "Qeveria i dërgon materialet Kuvendit", janë shumë të paqarta. Çfarë materialesh...

(Ndërhyrje)

...ligjet, aktet? Për më tepër, në nenin 27, në paragrafin 10, flitet për obligimin për pjesëmarrje në mbledhje të Kuvendit dhe të komisioneve, por thuhet vetëm me shumicën e votave të anëtarëve të organeve përkatëse. Do të thotë, nuk është fjala për interpelancë. Në Rregulloren tonë dhe në praktikën tonë është një raport tjetër. Mendoj që duhet ruajtur ai dhe mendoj që raporti me Kuvendin duhet të jetë më i rregullt në funksion të funksionimit parlamentar dhe të evitohet mundësia e anashkalimit të Kuvendit, që është bërë një tendencë e përgjithshme në shoqërinë tonë. E konsideroj shumë të rrezikshme!

Neni 35, për mendimin tim, është po ashtu shqetësues dhe do rishikuar! Flet për Qeverinë apo, vini re, "Institucionet e autorizuara, të cilat disponojnë dhe administrojnë pasurinë e Kosovës". Nuk e kam gjetur diku këtë formë as në ligjet, në vendet tjera, as në

legjislacionin tonë të mëparshëm. Të disponojë Qeveria pasurinë e Kosovës, më duket pak si tepër dhe pak e panevojshme dhe shumë abuzive. Qeveritë edhe ndërrojnë dhe mendoj që duhet të korrigjohet. Besoj që edhe kjo duhet të korrigjohet në funksion të një raporti më të mirë me legjislativin. Nuk flitet në këtë ligj për agjencionet ekzekutive dhe rregulloret e mëparshme kanë pasur një pjesë tjetër. Nuk është rregulluar mirë çështja e administratës dhe sekretarëve permanent, e dini që kemi probleme këtu dhe ka konfuzion në funksionimin e tyre, por besoj se këto çështje, si edhe këto që i theksova, do të rregullohen me amendamentim. I lus kolegët që punojnë në to, që t'i kenë parasysh! Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr Kryetari Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të faleminderit, Hydajet!
Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!
I përshëndes ministrat dhe zëvendësministrat që janë këtu!
Kjo është, unë nuk mund të mos e them një përshtypje elementare. Ky është ligji më i rëndësishëm, që është votuar ose është dashur të votohet 3 vjetët e fundit, mbasi që është shpallë pavarësia. Këtu po shoh që s'ka interes të madh të deputetëve të flasin, po as i Qeverisë që të jetë këtu. Kjo është fenomenale, por është edhe paradoks i jashtëzakonshëm, do të thosha unë. Unë kam menduar që do të jetë tepër e rëndësishme, prandaj e kam lexuar tepër kujdesshëm këtë ligj, që e konsideroj ndër më të rëndësishmit që ka kaluar nëpër këto banka në 3 vjetët e fundit.

Dhe, e dyta, jam përgatitur që t'i them disa fjalë, bile t'i bëj edhe amendamente, sepse kam vërejtur që në leximin e parë ka ndodhur të jepen ide të shkëlqyeshme për ligjet, por në amendamente janë humbur. Komisionet s'i lexojnë çka thuhet herën e parë. Unë menjëherë, le të më lejohet, në mes të tjerëve zotit Hysenit t'i them që e ka lexuar shkëlqyeshëm ligjin, po zoti Hyseni, nëse s'bëhen amendamente menjëherë, këto po humben.

Prandaj, unë po them menjëherë në fillim që kemi sot në shqyrtim një nga ligjet më fundamentale të funksionimit të pushteteve në Kosovë, Ligjin për Qeverinë e Kosovës. Ky është një ligj që provohet të kalojë në Kuvend që disa vjet, që dy - tri legjislatura. Po, unë tash po flas prej dy legjislaturave, prej kur Kosova është shtet i pavarur dhe sovran dhe është qesharake që të punojë me rregullore ose të UNMIK-ut, ose s'di të kujt, Qeveria, e cila rreh gjoksin tre vjet, që është shtet sovran e i pavarur, më në fund, prandaj unë do të votoj për këtë ligj, në parim. Duhet të kalojë ky ligj, por nuk duhet të kalojë qysh s'është i mirë për këtë vend. Nga teksti, që ne kemi përpara, unë mund t'ju them që kam pasur në dorë variant edhe më të mirë për Qeverinë, që ka kaluar nëpër duar tona dikur e s'është aprovuar, se që është ky ligj.

Do të thosha që kemi një kthim mbrapa, pse - unë nuk e di! Por, nga ky tekst që ne kemi në dorë sot, gjithsesi që janë disa pika, në parim, që duhet të shqyrtohen për t'u bërë amendamente dhe këtu kam parasysh edhe diskutimin shumë të përmbajtshëm

substancial të zotit Muhamet Mustafa. Pra, duhet të shikohet, të precizohen kompetencat e Qeverisë, të precizohet raporti i Qeverisë me Kuvendin, të precizohet raporti i Qeverisë në lidhje me atë që e quajti kolegu - disponim i pasurisë së Kosovës, të shihet raporti i Qeverisë në transparencën e saj publike dhe institucionale dhe, në fund, për zgjidhjet kushtetuese.

Është mirë që këto që i thashë, menjëherë të provoj t'i jap si amendamente. Natyrisht, do t'i përcjellë edhe atje, po unë dua të mbeten të regjistruara edhe në këtë mbledhje sot.

Amendamenti im numër 1 është - Neni 3.1.2. duhet të jetë: "...një apo dy zëvendëskryeministra". Domethënë, se thuhet atje, një e sa të doni më shumë. Një ose dy, jo më shumë se dy, i bie.

Amendamenti 2 – Neni 3.2. duhet të jetë kështu: "Kuvendi i Republikës së Kosovës, nëpërmjet amendamentimit të Ligjit për Qeverinë vendos për themelimin apo shuarjen e posteve zëvendësministrare, ministrare". Ju e dini me çka ka të bëjë kjo. Kjo ka të bëjë që të mos mund të rritet Qeveria, për shkak të voluntarizmit, ose për shkak të pjesëtimeve politike, apetiteve të hatashme të anëtarëve të koalicioneve të çuditshme që kanë për të ndodhur në këtë vend, sepse kemi një sistem zgjedhor, ku pakicat bëhen shumicë, ku përfaqësimi është joproporcional etj. Domethënë, ky arbitraritet nuk mbrohet ndryshe, veç se me këtë formulim. Është Kuvendi, që këtë ligj edhe kur të bëhet ligj, për ta ndërruar përbërjen e Qeverisë, domethënë numrin, përpjesëtimin, e amendamenton domethënë për çdo qeveri. Përndryshe, ne jemi, 19 më duket janë ministri tash, kjo mund të shkojë deri në sa të doni, sepse përpjesëtimi mund të jetë, këta thonë - po na duhet për shkak të koalicionit, po nëse e ke 3 me 2, ajo është... mund t'i bësh edhe 30 me 20, përpjesëtimi është i njëjti, po ma rënd t'i paguash 30 ministra. Domethënë, nuk është punë përpjesëtimi, është punë makutie pushtetore e atyre që hyjnë. Dhe, kjo duhet të mbrohet prej Kuvendit.

Amendamenti numër 3 – Neni 10.2, të jetë: "Çdo anëtar i Qeverisë duhet t'i përmbahet Kodit të sjellës së anëtarëve të Qeverisë, i cili kod nxirret nga Qeveria në afatin prej 3 muajsh". Këtu thuhet 6, unë kërkoj që të thuhet 3 dhe hiç më shumë! S'ka nevojë 6 muaj për të vendosur që duhet t'i përmbahet Kodit Qeveria!

Neni 26, të cilin nuk e kam ndërtuar në amendament, sepse do punë shumë, që ka të bëjë me aktet që i nxjerr Qeveria me fuqi ligji. Kjo duhet të studiohet, është shumë nen i ngatërruar atje, jo i bien, e nëse për 5 ditë Kuvendi s'i voton, mundet për 45, po ai vepron ligji, tani mbas 45 ditësh nëse s'e voton Kuvendi, bien çdo gjë. Sa sherri ose e mira mund të bëhet për 45 ditë, me ligj, mos vet. Kështu që, ai nen nuk bën assesi në këtë formë të mbetet.

Amendamenti im numër 4 – ka të bëjë me nenin 27.10. dhe unë këtë po e lexoj, që duhet të duket kështu: "Anëtarët e Qeverisë janë të obliguar" – jo duhet, as në indikativ, se marrin pjesë, nuk po e kuptojnë këtu njerëzit, janë të obliguar "që të marrin pjesë në seancat e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare". Atje thuhet, nëse shumica, ajo i bien - nëse nuk lyp shumica e Kuvendit ose e një komisioni, anëtari i Qeverisë nuk

lodhet, nuk shkon as s'do të duket, me formulimin që e keni atje! Unë insistova te 7.10-shi, se jam i sigurt për amendamentin që e propozoj, po krejt neni 27 duhet të rimerret i tëri, për shkak se ka punë me Kuvendin dhe nuk është sqaruar në mënyrë kushtetuese, domethënë ky nen është antikushtetues në mes të raporteve të dy pushteteve, të Qeverisë dhe të Kuvendit dhe duhet të shihet mirë.

Amendamenti im numër 5, që është neni 35.1. duhet të jetë: “Qeveria disponon dhe shfrytëzon pasurinë e Republikës së Kosovës, vetëm duke marrë pëlqimin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.” . Meqë, referendum për pasuritë, të pyesësh çdo njeri nuk mundesh çdo ditë, është Kuvendi si përfaqësues i zgjedhur direkt i qytetarëve ose i popullit, si të doni, i cili jep leje që të disponohet me këtë pasuri. Përndryshe mund të jenë ideal e jo ideal qeveritarët, por nuk mund ta disponojnë, si thuhet në këtë formulim.

Unë i thashë të gjitha këto edhe me brengën e një funksionimi të pushteteve, që janë në raporte, edhe për të ritheksuar që ky ligj, për këtë ligj është mirë të shihet Kushtetuta. Në Kushtetutë, Qeveria nuk ka të drejtë të nxjerrë vendime me fuqi ligji, në atë Kushtetutë që e kemi ne të shkruar. Këtu thuhet që po. Të shihet! Të shihet, sepse është bërë modë, më lejoni kolegë të dashur, që të bisedohet për Kushtetutën dhe të bisedohet për Kushtetutën vetëm duke iu drejtuar Gjykatës së famshme Kushtetuese të Kosovës, po këtu përvojat janë e s'janë të mira, dhe ju po e shihni pse. Sepse ne e kemi plot gojën pavarësi dhe plotë gojën sovranitet, por njeri më së shumti i nënvizon psikologjikisht ato edhe që s'i ka fort. Institucionet tona të pavarura nuk janë bash të pavarura, nga pak të varura janë. Bile, në ligjet sistimore nuk është mirë që t'ju japim shans që të bëhen edhe më të varura-të pavarura. Prandaj, po i bie kësaj sot këtu. Po i bie sot kësaj këtu, sepse jemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdojani fjalën!

SABRI HAMITI: ...pra, po flasim për një ligj, por po flasim dhe për raporte të mëdha kushtetuese. Dhe, po flasim në Kuvend. Dhe, unë po flas në Kuvend. Dhe, po flas, a e patë, jo në emër të grupit, po flas në emër të Sabri Hamitit, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Po flas në emër të 33.770 votave qytetare të marra në krejt Kosovën. Dhe, nëse flas me këtë firmë, me këtë firmë po ju them që ajo që po ngjet me presione që i janë bërë Kuvendit që 4 muaj rreth të ashtuquajturit mandat ose jo mandat, është instrument, zonja dhe zotërinj, që fjala e lirë e cila ende provon të prodhohet në këtë institucion, funksionon. Ende është i vetmi institucion në Kosovë, që edhe flet, po edhe voton dhe i numëron votat. Keni kujdes, institucionet që politikisht e përbëjnë edhe këtë Kuvend dhe i prodhojnë edhe këta deputetë, qoftë si paraqitje para opinionit, shumë prej tyre kanë harruar që mund të flitet, që mund të votohet dhe duhet të numërohen votat. Prandaj, deputeti, përfaqësuesi i popullit duhet ta ketë mendjen jo të robëruar, po të çliruar dhe të sjellë ide këtu. Dhe, deputetët duhet ta kenë fuqinë të thonë – këtë të drejtë s'mund të ma marrë askush dhe është Kuvendi ku duhet të thuhet kjo. Dhe, në emër të interpretimeve të ligjeve themelore, qoftë dhe të Kushtetutës që është akti më i madh, nuk mund ta rishkruaj atë ai që s'e ka detyrë. Ligje fundamentale shkruan Kuvendi dhe deputetët vetë duhet të jenë të zotët, nëse ka nene të ligjit themelor ose aktit themelor të

Kushtetutës, që ka dyjësi, e s' do të duhej të kishte, si ai i famshmi 75, atëherë le të ulen, le ta fshijnë krejt ose le ta shkruajnë qysh duhet. Pra, këtu nëse s' ruhet fjala e lirë edhe për të gjitha këto, ne nuk e kemi fituar demokracinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Fjalën e ka deputetja Teutë Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Ka qenë koha që të kemi në dorë një Projektligj për Qeverinë, që besoj do të jetë në funksion të ngritjes së nivelit të shtetit ligjor, organizimit dhe funksionalizimit të tij në parimet e përcaktuara me qartësinë e kompetencave, konkretizimin e tyre, e të tjera.

Në lexim të parë, sponsoruesi i këtij projektligji e ka arritur këtë objektiv, edhe pse ka hapësirë për vërejtje, korrigjime dhe përmirësime.

Së pari, në memorandum, sipas mendimit tim, është bërë një qasje jo logjike, kur thuhet se "Projektligji është hartuar në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Kosovës nr.01/2007". Ndoshta gaboj, nuk jam e këtij profesioni, por nuk mund të hartohet një projektligj duke ia përshtatur një rregulloreje, sepse është e kundërta. Rregulloret hartohen edhe i përshtaten një ligji.

Së dyti, unë e shoh një mangësi në përbërjen e Qeverisë, sipas këtij projektligji. Më duket se propozohet një organizim i papërcaktuar që do t'i mundësonte një kryeministri krijimin e një formacioni shumë të gjerë, që nuk përkon me përvojat e hapësirës evropiane, e bile as të rajonit. Do të ishte ngarkesë për buxhetin edhe kështu të varfër. Dhe, në fund, janë premtimet që edhe me ligj të ruhet formacioni ekzistues, pse jo me mundësi edhe të zgjerimit të Qeverisë aktuale. Propozimi i projektligjit, që Qeveria të përbëhet nga një apo më shumë zëvendëskryeministra, ministra, deri në 2 ministra pa portofol, ka mbetur të propozohet vetëm 1, 2, 3 apo më tepër kryeministra dhe të hyjmë në Librin e Gjinis.

Na mbetet të përcaktojmë këtë përbërje edhe me ligj dhe mos të keqpërdoret kjo mundësi jo vetëm nga kryeministri aktual, por edhe nga kryeministrat tjerë, sepse nuk është e nevojshme që për çdo mandat të një qeverie të hartojmë projektligje.

Së treti, ndoshta është mirë të përkufizohet rasti i mbarimit ose i përfundimit të mandatit të një ministri, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 7 pika 4, duhet sqaruar dhe ndoshta të shtohet edhe me dorëheqje, si akt moral. Po ashtu, mendoj se duhet përcaktuar në nenin 9 të këtij ligji se anëtarët e Qeverisë nuk mund të mbajnë asnjë marrëdhënie tjetër pune, publike apo private, me orar të plotë. Që në praktikën tonë, disa ministra edhe ligjërojnë ose janë të angazhuar në universitete publike, besa më shumë private.

Ndërsa, në disa raste, në disa shtete e kanë këtë privilegj anëtarët e qeverisë, mirëpo nuk e keqpërdorin. Fatkeqësisht, këtu tek ne kjo keqpërdoret maksimalisht. Me një dispozitë i kishim shpëtuar ministrat nga kjo lodhje dhe ishin angazhuar më tepër në përgjegjësitë e përcaktuara me këtë projektligj.

Projektligji ka nevojë për një përkujdesje më të mirë gjuhësore dhe kërkoj falje, kryetar i Kuvendit, krejt në fund më duhet ta përmend një çështje, e cila me të vërtetë, si deputete e kësaj legjislature, si deputete e re, më duhet ta përmendi se në seancën e paradites, fjalët të cilat janë përdorur nga kryesuesi i Kuvendit si “disa fytyra”, “disa njerëz”, nuk përkoinjë me sjelljen e një mësimdhënësi ndaj nxënësve, e aq më tepër të një kryesuesi të Kuvendit me deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit!

I nderuari kryetar i Kuvendit,

I nderuari Kabinet Qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Më lejoni që të vazhdojmë me punën dhe t’i paraqes disa vërejtje, disa komente dhe disa propozime të mia lidhur me këtë projektligj.

Vërejtja ime e parë ka të bëjë me përbërjen e Qeverisë, çështje kjo e cila rregullohet me nenin 3 dhe që në formë të ndryshme u diskutua edhe nga disa deputetë parafolës. Sipas këtij projektligji, propozohet që Qeveria, përveç tjerëve të ketë edhe deri në 2 ministra pa portofol. Ndërsa, unë propozoj që këtij neni t’i hiqet pika 1.4, duke lënë në strukturën përbërëse të Qeverisë Kryeministrin, deri në 3 zëvendëskryeministra dhe ministrat. Pra, propozoj që edhe numri i zëvendëskryeministrave në njëfarë forme të përcaktohet apo të reduktohet me këtë projektligj.

Si vërejtje ime e dyta, është propozimi që ka të bëjë me paragrafin 1.2 të nenit 4, për të cilin kërkoj të riformulohet kështu: “Personat, ndaj të cilëve nuk ka filluar procedura penale për ndonjë vepër penale, që ndiqet sipas detyrës zyrtare”, sepse nëse mbetet siç është e propozuar në këtë projektligj, atëherë do të jepte mundësinë që për kryeministër, zëvendëskryeministër apo për ministër të propozohet dhe zgjedhet edhe personi ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet penale, apo i cili është dënuar penalisht nga Gjykata e shkalles së parë, për vepra penale tejet të rënda, përfshirë këtu edhe krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me nenet 1 dhe 12, respektivisht paragrafin 5 të nenit 12, sepse sipas nenit të parë përcaktohet se me këtë ligj rregullohet organizimi dhe funksionimi i Qeverisë, kurse nga neni 12 paragrafi 5 shihet se organizimi i Qeverisë, ministrave, përfshirë edhe njësitë vartëse të tyre, do të përcaktohen me Rregulloren për organizimin dhe strukturimin e Qeverisë. Jam i mendimit që çështja e organizimit të Qeverisë, si një çështje tejet e rëndësishme, duhet të rregullohet me dispozitat e këtij ligji, e jo me ndonjë akt nënligjor që buron nga ky ligj.

Më pastaj, do të ndalesha te një kompetencë, të cilën neni 13 paragrafi 2 pika 2.3 ia njej apo ia jep kryeministrit. Më konkretisht, sipas kësaj dispozite të këtij paragrafi, kryeministri mund të kërkojë që Qeveria ta rishqyrtojë dhe ta ndryshojë vendimin e saj,

nëse vlerëson se vendimi i marrë nga Qeveria mund të ketë pasoja të dëmshme. Madje, në këtë paragraf theksohet që zbatimi i këtij vendimi të pezullohet derisa Qeveria të trajtojë kërkesën e kryeministrit. Mendoj se një dispozitë e këtillë, që jep mundësinë e ndryshimit të vendimit të marrë, nuk duhet të ekzistojë fare në një ligj, i cili rregullon punën e Qeverisë, në të cilën kryeministri ka dhjetë këshilltarë dhe secili ministër ka nga 5 këshilltarë, të cilët detyrë parësore duhet të kenë që t'i këshillojnë paraprakisht eprorët e tyre, përfshirë këtu edhe kryeministrin, në atë mënyrë që mos të marrin vendime, të cilat do të jenë aq të dëmshme, sa që do të duhej të ndryshoheshin qysh në mbledhjen e parë të radhës së Qeverisë.

Një vërejtje tjetër ka të bëjë me kërkesën, që ministrat, citoj: “të krijojnë dhe zbatojnë masa kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe të nxisin vetëdijesimin kundër mashtrimit”, që është i theksuar, që është nxjerrë nga neni 16 paragrafi 1.5. Një dispozitë e këtillë i ngjason dispozitave të ligjeve të karakterit ideologjik socialist, sipas të cilave i pari i institucionit do të duhej të ishte i besuar i partisë, me vetëdije dhe moral të lartë, të cilët kanë për detyrë që në ministrinë, të cilën e udhëheqin, të propagonin moralin kundër mashtrimit dhe korrupsionit. Duke analizuar këtë dispozitë, njeriu thjeshtë mund të shtrojë pyetjen: E çka nëse vet ministri është i korruptuar? Kush do ta përmbush këtë përgjegjësi të tij?

Dhe, në fund, një vërejtje sa i përket teknikës së hartimit të këtij projektligji. Në pjesën dërmuese të ligjit, kur flitet për zëvendëskryeministrin, kryeministrat dhe ministrin apo ministrat, përdoret njëjësi dhe shumësi i këtyre emrave, por jo vetëm kaq. Këtyre emrave iu shtohen edhe përcaktuesit e gjinisë femërore, gjë që fjalët e tilla thuajse i bën të pakuptimta, andaj mirë është që përveç në nenin 3, ku theksohet se Qeveria ka më shumë zëvendëskryeministra dhe ministra, në të gjitha pjesët tjera të tekstit të këtij ligji, këta emra të përdoren vetëm në njëjës, siç është vepruar në nenin 20 të këtij ligji.

KRYETARI: Faleminderit! Hë, Burim, çka u bë? Urdhëro, e ke fjalën, deputeti Burim Ramadani!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumica e elementeve u thanë, që desha për t'i thënë, por shumë shkurtimisht po mundohem vetëm tri elemente t'i përmend.

Është një përshtypje, ose të paktën përshtypje imja personale është se ka qenë qëllimi që të bëhet sa më shumë tekst dhe të duket sa më interesant i gjithë ky projektligj, por po e përmendi nenin 12 pika 4.1, ku thuhet se anëtarët e Qeverisë e mbështesin punën e Qeverisë. Realisht, është shumë e palogjikshme që edhe kjo të futet në projektligj, ose në ligj nesër, për shkak se anëtarët e Qeverisë janë vetë Qeveria. Domethënë, Qeveria përbëhet prej kryeministrit, zëvendëskryeministrave edhe ministrave. Domethënë, ata duhet ta mbështesin veten. Tash, na me ligj po ua përcaktojmë që ministrat ta mbështesin veten. Ky është element që nuk ka nevojë fare të jetë në ligj.

Neni 12 pika 2.4 thotë: “Qeveria i zgjedh mosmarrëveshjet ndërmjet ministrave.”. Çka i bie kjo punë, kur në nenin 13 pika 1.2, thuhet që “Kryeministri bashkërendon dhe

kontrollon punën e anëtarëve të Qeverisë”? Bashkërendimi e ka kuptimin edhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të ministrave brenda Qeverisë dhe nuk ka nevojë fare që të jetë përsëritje e të njëjtit send, e të njëjtit element. Dhe, në nenin 12 i bie që Qeveria është vetëm kryeministri. Pra, ai që i bashkërendon dhe i zgjidhë mosmarrëveshjet është Kryeministri. Në rastin konkret, thuhet që Qeveria, atëherë është veç një njeri është krejt Qeveria.

Edhe neni 8 pika 4, thuhet se pas pranimit të dorëheqjes së një ministri, kryeministri mund të kërkojë që ai të vazhdojë ushtrimin e detyrës deri në zgjedhjen ose emërimin e ministrit të ri. Kjo besoj që nuk duhet fare të jetë në projektligj, sepse mund të keqpërdoret dhe s’flitet vetëm për tash, por përgjithmonë sa ka në këtë shtet qeveri. I bie që nëse një ministër jep, për një arsye krejt banale, ndoshta për një aferë korruptive ose seksuale, dorëheqje, atëherë kryeministri ka të drejtë që ta mbajë atë në detyrë, derisa ta emërojë një tjetër e kështu ta vonojë edhe emërimin e tjetrit, ndërkaq ai ministër ose ajo ministre vazhdon punën edhe përkundër faktit se ka bërë një skandal tepër të madh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Përfaqësuesi i Qeverisë, nëse do për ta marrë fjalën! Nuk do!

Atëherë, të lajmëruar për diskutim nuk ka. Shkojmë në votim për në parim të projektligjit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Prezent janë 76 deputetë.

Konstatoj se me 61 votë “për”, 7 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e 9-të të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Zëvendëskryeministra,
Të nderuar deputetë,
Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për të huajt, i sponzoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për të huajt është hartuar duke u bazuar në strategjinë legislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë. Projektligji adreson të gjitha çështjet të cilat kanë të bëjnë me të huajt, që nga hyrja, lëvizja, si dhe qëndrimi i tyre në Republikën e Kosovës dhe përfshinë në zbatim të gjitha institucionet përkatëse që kanë të bëjnë me këtë fushë.

Pra, projektligji rregullon hyrjen dhe qëndrimin në Republikën e Kosovës dhe daljen e të huajit nga Republika e Kosovës. Arsyet për hartimin e këtij projektligji janë përcaktimi i dispozitave sa më të qarta të të drejtave dhe detyrimeve më rastin e hyrjes, daljes dhe qëndrimit të të huajve në Republikën e Kosovës, definimi i organit përkatës, si dhe ndarja e kompetencave ndërmjet organeve të zbatimit. Gjithashtu, në këtë projektligj, përcaktohen edhe dispozitat ndëshkuese, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në ligjin aktual, por janë rregulluar me akt nënligjor.

Ky projektligj përmban 8 kapituj dhe gjithsej 99 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Hartimi i projektligjit është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria për Financa dhe Ministria e Integritetit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me “acquis comunitaire”.

Të nderuar deputetë,
duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin e këtij projektligji.
Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Fjalën e ka raportuesi i Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!
Në emër të Komisionit për Siguri, Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë të Kosovës, ne e kemi marrë projektligjin dhe meqë është në lexim të parë, atëherë do t'i marrim amendamentet, të cilat bëhen edhe nga deputetët edhe nga grupet parlamentare, do ta shqyrtojmë në komision dhe do ta sjellim për lexim të dytë.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarit ose përfaqësuesit të grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për ministrat,

Grupi Parlamentar ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për të huajt dhe ka ardhur në përfundim, se ligji i përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të huajt, prej momentit të hyrjes në shtetin tonë: mënyrës të hyrjes, qarkullimit, punësimit, vendqëndrimit, po edhe largimit nga shteti ynë.

Besoj që grupi parlamentar, me disa propozime rreth këtij projektligji që ka të bëjë edhe me prioritetet gjatë hyrjes, kushtet për hyrje, si dhe një komponent i rëndësishëm, siç është bashkimi familjar, i cili nuk është trajtuar mjaftë në këtë projektligj, si dhe dënimet, gjobat për ata që i thyjnë nenet, gjegjësisht, parametrat e këtij ligji, si dhe komponentin me rastin e adoptimit të fëmijëve, do të japë kontributin e vet në komisionin parlamentar dhe ky ligj do t'i plotësojë kriteret, për të qenë një ligj funksional dhe ligj i zbatueshëm, andaj si grup parlamentar propozojmë që ky të miratohet në parim.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDK-së, deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në parim do ta përkrahë Projektligjin për të huajt, natyrisht që ka mungesë të disa dispozitave që i trajtojnë disa çështje, aty edhe do të fokusohemi. Vetëm t'i numërojmë disa, siç janë: lidhur me lejen e qëndrimit për të huajt që janë viktimë të trafikimit dhe po ashtu, dispozitat ligjore për rregullimin e punësimit të huajve që janë me qëndrim jo legal. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Ne si grup parlamentar kemi shqyrtuar Projektligjin për të huajt. Në vazhdim do t'i përmend disa vërejtje në lidhje me këtë projektligj.

Fillimisht, neni 34.4 duhet të riformulohet në tërësi që ta arrijë efektin e duhur, më pastaj neni 52 i këtij projektligji, po ashtu, mendoj që duhet të sqarohet. Pra duhet të sqarohet se çka kuptojmë me “qëndrim të përhershëm”, sepse kështu si është, ka mangësi. Neni 68, ndoshta ka një arsye që unë nuk e di, mirëpo më duket pak e çuditshme të kufizohet lëvizja e dikujt me qëndrim të përkohshëm brenda një komune, do të ishte vështirë të zbatohet. Praktikisht, më duket e panevojshme, sepse Kosova për nga territori është e vogël dhe ndoshta ky përkufizim është në kundërshtim me parimin e lëvizjes së lirë, madje, duke pasur parasysh që ka komuna aq të vogla, sa që edhe është e pamundshme të zbatohet ky nen.

Në fund, ne si grup parlamentar do ta mbështesim këtë projektligj dhe kontributin do ta japim në komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështesë në parim Projektligjin për të huajt, megjithëse këtu kemi një pyetje që do të duhej, ndoshta edhe sot, por edhe në komision, të sqarohet dhe kjo pyetje ka të bëjë me "udhëtimin ujqor" në Kosovë!

Në projektligjin që është paraqitur, në Kuvend të Kosovës, në nenin 29, pika 2, përmendet "udhëtimi ujqor në Kosovë". Nuk e di nëse është menduar për Liqenin e Ujqemirit apo për Liqenin e Vërmicës, por kjo bie ndesh me nenin 27, pika 1, ku thuhet, se: "i huaji ka hyrë në Republikën e Kosovës, ku e kalon kufirin shtetëror, gjegjësisht do të thotë saktësisht, kur ka kaluar vendin, ku bëhet kontrollimi kufitar dhe ne e dimë që në këto dy liqene nuk ka kontrollim kufitar ose pikë kufitare, në të cilin mund të verifikohen ose të identifikohen qytetarët e huaj që vinë në Kosovë. Mund të jetë gabim logjik, mund të jetë e saktë, apo mund të jetë edhe gabim në përkthim ose në përmbledhje të projektligjit bazuar në rrethanat e vendeve tjera, apo ndoshta, pak me shaka, por ndoshta është menduar edhe Porti i Shën Gjinit, si pikë kufitare për Kosovën, për shkak të asaj marrëveshje të mëhershme që është dhënë në opinion, për mundësinë e shfrytëzimit të Portit të Shën Gjinit nga ana e shtetit të Kosovës.

Sidoqoftë, kjo zoti ministër, do të duhej që të jetë saktësisht e sqaruar, për shkak, se unë e di që ato që quhen "Blue Borders" janë në Kosovë, në liqenin e Ujqemirit dhe në liqenin e Vërmicës, por kjo e obligon faktikisht Qeverinë e Kosovës dhe ministrinë e juaj që të hapë pika kontrolli në këto rrugë, domethënë, përmes këtyre liqeneve. Raste të tilla të kalimit mund të jenë, ndonjë rast pikniku ose diçka, me ndonjë barkë të vogël, sepse nuk është diçka që Kosova mund të ketë ndonjë port, me të cilin shtetasit e huaj, mund të kalojnë përmes rrugëve ujore.

Nëse është gabim, duhet të fshihet. Besoj që në komision, te zoti Isufi, do të sqarohet kjo shumë saktë dhe shumë mirë, në mënyrë që gabimet e tilla, nëse janë gabime të mos përsëriten asnjëherë më. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Koalicionin për Kosovë të Re, Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë, deputetë të nderuar,

Ne para vetit sot kemi një projektligj, i cili është në dukje mjaftë voluminoz, por megjithatë vlen të përmenden disa mangësi, të cilat kemi hasur gjatë shqyrtimit të këtij projektligji.

Duke filluar që nga neni 6, te paragrafi i 2, e gjithashtu te nenet tjera vërejmë mjaftë kundërthënie mes paragrafëve, brendapërbrenda, të një neni.

Në radhë të parë kemi, do të thotë, te neni 6, paragrafi 2.1, 2.2, 2.3, 2.4, ku përmenden, do të thotë, çështjet vitale, të cilat mund ta cenojnë sigurinë e qytetarëve të Kosovës, çështjen kombëtare, pastaj shëndetin moral publik dhe kërcënimet serioze që mund t'i paraqet ndonjë i huaj për shtetin e Kosovës.

E ndërsa, në nenet e mëposhtme shihet qartë, se disa përmenden, disa nuk përmenden, prandaj për të pasur një kompleks të tërë dhe një përmbledhje më të mirë të gjitha këtyre, do të ishte dashur që në amendamentimin që do të bëhej në komision të përmendet siguria e lirë e qytetarëve të Kosovës dhe siguria shtetërore në përgjithësi, jo të ndalet, qoftë në një element apo në një element tjetër.

Te neni 25, kemi gjithashtu ku shihet qartë, se zyrtari policor shkurton afatin e vazhimit të vizës të personit të huaj, i cili hyn në territorin e Kosovës. Unë mendoj, se zyrtari kufitar policor nuk mund të posedojë informata të bollshme për të marrë një vendim të tillë, ngase Ministria e Punëve të Brendshme është ajo, e cila ka këtë kompetencë për zgjatjen apo mos zgjatjen e vizës së personit të huaj.

Te neni 26, ku këtu vërehet në një diskrepancë mjaftë e madhe dhe një mospërputhje brendapërbrenda neneve, e ku transportuesi obligohet që në rast se i huaji, gjegjësisht pasagjeri, i cili ka hyrë në territorin e Kosovës dhe nuk i plotëson kushtet që ty hyjë këtu apo ka hyrë ilegalisht, të merret me kthimin e të huajit në vendin nga ka ardhur.

Unë mendoj, se transportuesi nuk është në gjendje të vërtetojë validitetin dhe gjitha ato të dhëna, qoftë për dosje kriminale, penale apo tjera.

Neni i 1, thotë: “transportuesi mund ta sjell të huajin në pikën e kalimit kufitar, nëse i plotëson kushtet për hyrjen në Republikën e Kosovës”- fort mirë. Transportuesi, çka mund të vlejë, vërtetojë është validitetin e dokumenteve të pasagjerit dhe vizën, të cilën e posedon apo nuk e posedon, përndryshe për dosjen kriminale, gjegjësisht, për një bagazh negativ, i cili mund ta ketë ai i huaj, transportuesi nuk është në gjendje ta vërtetojë dhe të marrë hapa konkret për kthimin e tij nga shteti kah ka ardhur.

Andaj, edhe është e padrejtë që të ngarkohet transportuesi që ai me mjetet e tij t'ia sigurojë kthimin të huajit, i cili nuk meriton apo nuk është i denjë për sigurinë e qytetarëve të Kosovës.

Te neni 28, paragrafi 2, shihet qartë ku zyrtari policor kufitar, për kontrollin e kufirit shtetëror mund, por nuk kufizohet të kërkojë nga i huaji dhe t'i dëshmojë shkaqet e hyrjes të tij në Kosovë. Këtu mendoj, se fjala “kufizohet” duhet të zëvendësohet me fjalën “obligohet”- do të thotë, zyrtari policor mundet, por nuk obligohet të marrë informata për qëllimin e vizitës së tij në vendin tonë.

Gjithashtu, vërejmë edhe te neni 43, paragrafi 2, ku i lëshohet leje qëndrimi të përkohshëm sa i përket të huajit, i cili do të thotë, do të hyjë në vetë territorin e Kosovës. Diskrepancë apo mospërputhje tjetër mes paragrafëve dhe neneve është gjithashtu, te qëndrimi i paligjshëm i të huajve në Kosovë, ku i huaji i cili qëndron në mënyrë të paligjshme në Republikën e Kosovës duhet që menjëherë apo në afatin e caktuar ta lëshojë territorin e Kosovës.

Do të thotë, në këtë rast te ky kapitull, të qëndrimi i paligjshëm, dy paragrafët kanë të bëjnë me këtë nen, ndërsa paragrafi i 3 dhe 4, fare s'kanë të bëjnë me këtë nen. Domethënë, paragrafi 3 tregon, fjala kemi të bëjmë për qëndrimin e paligjshëm, ndërsa paragrafi flet, se: “ konsiderohet që i huaji ka lëshuar Kosovën në momentin e kalimit të kufirit shtetëror” dhe paragrafi i 4 tregon, se i huaji, i cili ka paraqitur me kohë kërkesën për vazhdim qëndrimit të përkohshëm, mund të qëndrojë deri në marrjen e vendimit të plotfuqishëm.

Do të thotë, këto dy paragrafët tregojnë një diskrepancë mes nenit, i cili flet për këtë rast, do të thotë, sa i përket leje qëndrimit të qytetarëve të huaj në Kosovë.

Te qëndrimi i përkohshëm, këtu kemi te neni 66, i cili flet për ndërprerjen e mbajtjes së të huajit në qendër, në radhë të parë, kur një huaj, i cili ka hyrë në territorin e Kosovës, qoftë në mënyrë ilegale apo pas hyrjes së tij në mënyrë legale, është konstatuar, se ai paraqet rrezik apo nuk posedon dokumente, siç është viza, të qëndrojë në territorin e Kosovës, ai në bazë të Rregullores duhet të mbahet në qendër, derisa të merret ndonjë vendim për faktin, se ai nuk guxon të dëbohet në shtetin nga ka ardhur, për shkak të sigurisë së tij personale apo botëkuptimeve të tij politike.

Në këtë rast, këtu te neni 67 mendoj, se duhet të ndërrohet ky definicion “qëndrimi i përkohshëm i të huajit” ngase të ky nen ne nuk kemi të bëjmë me qëndrim të përkohshëm, por kemi një qëndrim detyruar të huajit, cili po mbahet në qendër dhe mendoj, se ky term duhet të ndërrohet me terim “qëndrimi i pa definuar” derisa, Ministria përkatëse e Punëve të Brendshme të marrë një vendim, se a duhet të qëndrojë edhe a guxon të qëndrojë në territorin e Kosovës, ky person i huaj?

Gjithashtu, te neni 90, 91 dhe 92 ku parashihen gjobat për personat e huaj, të cilët kanë hyrë në Kosovë, është paraparë te neni 88, 89 edhe gjoba prej 50 deri në 1500 euro, prej 50 deri 1000 euro. Në këtë rast, nuk është përmendur fare gjoba me paraburgim, vetëm gjoba me mjete financiare edhe si gjobë e fundit dëbimi nga territori i Kosovës. Në këtë rast, i huaji kushdo qoftë ai, mendoj, se duhet t'i nënshtrohet edhe masave tjera, qoftë edhe paraburgimit.

Ne si grup parlamentar në parim do ta përkrahim këtë, me shpresë që këto vërejtje do të merren parasysh në Komisionin e Punëve të Brendshme. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, fjalën e ka deputeti Milivoje Stojanoviq.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa SLS je razmatrala i analizirala ovaj zakon. Mišljenja smo da je ovo veoma bitan zakon, jer na neki sveobuhvatni način rešava pitanje stranaca na teritoriji Kosova. U Nacrtu zakona postoje određene nejasnoće i neusklađenosti između određenih članova. Potrudimo se da to ispravimo kroz rad komisije. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, nuk ka të paraqitur.

Deputetë tjerë nuk janë lajmëruar. Prezentë janë 56 dhe duhet të kthehen në sallë deputetët.

Regjia, vazhdo edhe 2-3 herë me zilen, për t'i ftuar deputetët!

Vazhdojmë, jemi në procedurën e votimit. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë, tash!

Në sallë janë 66 deputetë.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për të huajt.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe Komisioni i përhershëm, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesë Raportin me rekomandime.

Pra, shpresoj që nuk jeni lodhur, po vazhdojmë dhe pikën e 10-të të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj zëvendëskryeministrin, zotin Bujar Bukoshi, që në emër të Qeverisë së Republikës të Kosovës, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, për fushën e mbrojtjes nga rrezatimi dhe sigurisë bërthamore, për mbrojtjen e shëndetit, mjedisit si përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare, nga Komisioni Evropian dhe nga Agjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike, para nesh kemi Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Sigurinë Bërthamore, si nevojë e harmonizimit të legjislaturës së Kosovës me atë të Bashkimit Evropian.

Ju kisha lutur që mos të tmerroheni nga ky titull i këtij projektligji, se sikur krijon, disa kështu, asociacione, kur është fjala për siguri bërthamore. Ju e dini, se Kosova nuk është fuqi bërthamore, as mos t'ju shkojë mendja te reaktorët bërthamor, ne s'i kemi ato. Kjo fushë gjerë më sot nuk ka qenë, shumë e trajtuar te ne dhe ky ligj plotëson nevojën që të definohet baza ligjore për zbatimin e këtij ligji, me masat për mbrojtjen nga rrezatimi, garantimin e sigurisë nukleare dhe radioaktive, menaxhim të sigurt me mbeturinat radioaktive dhe sigurinë në transportin e materialeve radioaktive.

Për shkak të kompleksitetit të fushës që e rregullon, ligji është i bazuar në standarde ndërkombëtare që janë kërkesë e komisionit Evropian dhe organizatave botërore që udhëheqin këtë fushë. Standardet janë të normalizuara në formë të direktivave që garantojnë siguri dhe të udhëzimeve, se si të përmbushen kërkesat e paraqitura.

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Gjatë përgatitjes të këtij projektligji janë marrë në konsideratë rekomandimet dhe sugjerimet e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë. Dispozitat e këtij projektligji që mund ta shihni rregullojnë gjithë atë duhet rregulluar, si status i agjencisë, buxheti, përgjegjësitë, kompetencat, organizimi i brendshëm dhe llogaridhënia.

Projektligji është hartuar pra konform me Rregulloren për punë të Qeverisë. Është në harmoni me Kushtetutën tonë dhe me dispozitat e *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian.

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Ky projektligj do të përmbushë kërkesat vendore, për mbrojtjen e shëndetit në rend të parë, mjedisit dhe të sigurisë, si dhe obligimet ndërkombëtare për sigurinë bërthamore dhe zbatimin e infrastrukturës ligjore. Ai bën pjesë në grupin e ligjeve që janë kërkesë e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian.

Besoj, që vërejtjet dhe sugjerimet tuaja do ta bëjnë këtë projektligj edhe më të kompletuar. Ju faleminderit, për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit zëvendëskryeministër! Radha është e kryetarit të Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, pra fjala është për deputetin Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje zëvendëskryeministra, ministra,

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore dhe Kuvendit, i sugjeron ta votojë në parim, megjithëse projektligji ka shumë të meta, besoj se gjatë procesit të leximit të parë, në leximin e dytë do të amendamentohet dhe do të përmirësohet edhe këto të meta që i ka do të hiqen. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Radha është në emër të grupeve, atëherë në emër të Partisë Demokratike fjalën e ka deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: I nderuar kryetar,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Me Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore do të mbulohet dhe rregullohet edhe kjo fushë. Dhe, në këtë aspekt sistemi ligjor i Republikës së Kosovës do të jetë edhe më i kompletuar.

Natyrisht, kur punohet ka edhe gabime, lëshime, të cilat duhet përpunohen. Këto lëshime janë të pranishme edhe në këtë projektligj dhe ato mund t'i përmendim. Së pari, vetë titulli i projektligjit është i pasaktë, i pakuptueshëm dhe jo logjik, kështu siç është Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, pjesa e dytë "për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria bërthamore" nuk duhet të mbetet, sepse nuk mund të mbrohem nga siguria bërthamore, nga vetë fakti, se siguria bërthamore siç është definuar del, se ne jemi të sigurt dhe nuk kemi nevojë për mbrojtje.

Ky titull ndoshta edhe duhej të rregullohet, të jetë disi ndryshe, ndoshta më mirë është të thuhet, Projektligji për Agjencinë e Mbrojtjes nga Rrezatimi Bërthamor. Është një fakt tjetër, po ashtu kreu i 3, neni i 13 dhe 14 i projektligjit në fjalë, i cili përcakton themelimin e një komisioni parlamentar për këtë çështje, nuk duhet të lëshohet në detaje tjera, përpos saktësisht, se puna e kësaj agjencie, duhet të mbikëqyret nga ana e komisionit parlamentar për këtë fushë, sepse kjo bie ndesh me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në të cilën thuhet se Kuvendi është ai që vendos themelimin dhe shuarjen e komisioneve parlamentare.

Ky ligj është i përfshirë në Raportin e Progresit dhe miratimi e përmbush edhe një kërkesë ose një obligim të Kuvendit tonë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do ta mbështesë këtë projektligj në parim, kërkon që të votohet. Ne do ta japim kontributin tonë në pasurimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore, po ashtu do të paraqesë disa vërejtje lidhur me këtë projektligj.

Këtë ligj e shohim si të domosdoshëm, duke pasur parasysh faktin që kjo fushë e rëndësishme për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguria bërthamore që prek drejtpërdrejt shëndetin e njeriut, e cila deri më tani nuk ka qenë e trajtuar. Këtu duhet theksuar edhe rëndësinë që ka Agjencia në luftë kundër terrorizmit bashkëkohor dhe parandalimin e

përhapjes së armëve dhe materieve bërthamore dhe tërë këtë në kontekstin e ruajtjes së sigurisë kombëtare dhe globale.

Mirëpo, vërejtjet të cilat janë në kuadër të këtij projektligji, të cilat i ka paraqitur edhe Ministria për Ekonomi dhe Financa, si vërejtje e shohim Deklaratën financiare nga MEF-i, ku thekson se kemi të bëjmë me një projektligj me ndikime të larta financiare dhe bazuar në situatën buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës, ky buxhet paraqitet i papranueshëm dhe pamundësi financimi.

MEF-i rekomandon duke marrë për bazë, se ky projektligj prodhon kosto të lartë në vlerë, prej mbi 5 milion euro, që nuk është pjesë e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011 dhe 2014 dhe nuk është i paraparë në kornizën e afatmesme të vitit 2012-2014, kërkon që ky projektligj të shtyhet deri në krijimin e kushteve dhe mundësive buxhetore.

Departamenti i Buxhetit vlerëson, se kjo kosto e vlerësuar buxhetore është e mbiçmuar në aspektin e mjeteve monetare, në faktin, se është kalkuluar një pagë mesatare për të punësuar, afërsisht është një vlerë prej 1600 euro, për muaj. Kjo, do të thotë, se paga e drejtorit të Agjencisë është më e lartë, se paga e kryetarit të Komisionit Parlamentar, dhe po ashtu parasheh edhe ngarkesa të mëdha buxhetore me stafin e planifikuar nga agjencioni, nga 34 zyrtarë.

Ky legjislacion nuk duhet të rregullojë dhe t'i përcaktojë pagat dhe shtesat e të punësuarave të Agjencionit, prandaj të gjitha këto dispozita duhet të fshihen.

Duke vlerësuar projektligjin me ndikime të larta buxhetore, kostoja buxhetore e të cilit nuk është pjesë ndarja buxhetore të aprovuara në buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2011-2014 dhe si i tillë, ky projektligj trajtohet i papranueshëm. Njëkohësisht, kur janë në pyetje deklarata financiare, ne biem në kundërshtim edhe me nenin 54 të Rregullores së Parlamentit, i cili parasheh që çdo ligj i cili inicohet duhet ta ketë koston buxhetore për vitin e parë dhe pastaj për vitet në vijim, në këtë rast do të thotë që me këtë projektligj, sipas deklaratës financiare, që është hartuar nga MEF-i, njëkohësisht, nga Departamenti i Buxhetit, për këtë ligj nuk ka mjete as për vitin e parë, por do të thotë, deri në vitin 2015.

Andaj, duke marr për bazë këtë deklaratë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike nuk do ta votojë në parim dhe kërkon që këtë ligj, t'ia kthejmë edhe njëherë Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të merret me shqyrtimin adekuat që të jetë i implementueshëm ky ligj, do të thotë, duhet të përcaktohen saktë kostot buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputet! Në emër të “Vetëvendosjes” deputetja Albanë Gashi.

ALBANA GASHI: Faleminderit!

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka lexuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore. Ne, në parim e mbështesim këtë projektligj, ndërsa kontributin tonë do ta japim në Komisionin funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe për shkak të kostos buxhetore, të cilën e ka paraparë edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, grupi ynë nuk do ta përkrahë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re, e përkrah në parim projektligjin për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore. Kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Goran Marinković, e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke je razmatrala zakon. I pored budžetskih implikacija koje nisu male, zakon je veoma neophodan i veoma značajan

Poslanička grupa SLS podržace u načelu usvajanje ovog zakona, a svoje sugestije i primedbe daće preko funkcionalne komisije. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+” a e do dikush fjalën? Jo!

Për fjalë është lajmëruar deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Para vete e kemi Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Me siguri që ky ligj i ka plotësuar boshllëqet ligjore të cilat i nevojiten Kosovës dhe pas këtij me siguri do të vijë Projektligji për mbrojtjen nga sulmet nga kozmosi apo menaxhimin e fatkeqësive detare e diçka e ngjashme.

Në anën tjetër, ligjet bazike, ligjet të cilat kanë të bëjnë me qytetarin e Kosovës, Ligji për sigurimet shëndetësore, Ligji për pensione edhe ligje të tjera të cilat janë me të vërtetë ato të cilat e krijojnë një boshllëk të madh për qytetarin e Kosovës edhe për Kosovën, nuk janë në rend të ditës, po merremi me mbrojtje, me Fukushimën edhe me sende të tjera.

Në anën tjetër shihet që projektligji edhe Qeveria e ka udhëzuar Kuvendin e Kosovës që të formojë një komision parlamentare nuk e di kur ka marrë Qeveria detyrën që të caktojë

Kuvendi çfarë komisione parlamentare duhet të krijojë, ndoshta është ky një avancim në funksionimin e Qeverisë së Kosovës.

Në anën tjetër shihet që Agjencioni i ka 34 persona, të paguar mirë dhe një përparësi të këtij ligji, të them të drejtën, këtu nuk po shohim.

KRYETARI: Faleminderit!

Të lajmëruar për diskutim nuk kemi.

Shkojmë votojmë në parim projektligjin.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Prezentë janë 63 deputetë.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 42 vota “për”, 17 “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.

Kërkohej nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Nëse jeni dakord, pasi i kemi edhe dy ligje me pak amendamente, i kryejmë sot e nesër i lëmë ato votimet që i kemi paradite. Nëse jeni dakord mund të shkojmë edhe për dy pika të rendit të ditës. A jeni dakord? Jeni dakord, shumë mirë.

Vazhdojmë pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputeten Vjollca Krasniqi, që para deputetëve të arsyetoj raportin me rekomandime. A e donë fjalën, s’e do fjalën.

Kemi 15 amendamente, nga Komisioni funksional.

Ju lutem, hymë në procedurën e votimit, deputetë nuk është mirë të lëvizni. Në sallë kemi prezentë 64 deputetë.

Amendamenti 1.

A ka “kundër”?

Abstenim? Nuk ka

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.
A ka “kundër”?
Abstenime? Nuk ka.
Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3.
A ka “kundër”?
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.
A ka “kundër”?
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5.
A ka “kundër”? Një.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6.
A ka “kundër”?
Abstenim? Nuk ka,
Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7.
A ka “kundër”? Një.
Abstenim? Një.
Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 8.

Amendamenti 9.
A ka “kundër”? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12.
A ka “kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 14.

Edhe amendamenti i fundit 15.
“Kundër”? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka.
Kalon amendamenti 15.

Tani votojmë ligjin në tërësi.
Prezentë 71 deputetë.
Konstatohet se më 69 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, deputetin Fatmir Xhelili, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime, nëse natyrisht e do fjalën.
Fjala për deputetin Fatmir Xhelili.

FATMIR XHELILI: Komisioni ka punuar në grup punues dhe i ka propozuar amendamentet në fjalë dhe besoj me aprovimin e këtyre amendamenteve do të thotë një ligj funksional që do të mundësojë krijimin e relacioneve adekuate të instrumenteve të

shtetit tonë për luftë kundër zjarrit dhe mbrojtjes nga zjarri si edhe për shpëtim, andaj propozoj në emër të Komisionit për t'i miratuar amendamentet në fjalë.

KRYETARI: Për regjinë është se harruam të themi se është miratuar Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Faleminderit, deputetë!

Në këtë projektligj janë të propozuara tetë amendamente dhe fillojmë me to:

Amendamenti 1.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3.

A ka “kundër”? Nuk ka.

Abstenim?

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7.

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 7.

Amendamenti i fundit - 8

“Kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Kalon amendamenti 8.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Prezentë janë 77.

Konstatohet se më 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim.

Faleminderit!

Pika e trembëdhjetë:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve, të arsyetojë raportin me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e ka trajtuar këtë projektligj dhe normal e rekomandon Kuvendit aprovimin e tij. Megjithatë e shoh të arsyeshme me qenë se është një numër pak më i madh, ndoshta i pazakontë i amendamenteve, të jap edhe disa sqarime edhe për faktin se edhe Komisioni tjetër i përhershëm për Legjislacion e ka shprehur shqetësimin e vet për numrin e madh të amendamenteve të shpjegojë që pjesa dërmuese e këtyre amendamenteve kanë të bëjnë me formulimin gjuhësor. Ndoshta edhe kjo do të ishte një rast i mirë që sponsorizuesit t’i kërkohej që ligjet t’i bjerë me formulim adekuat. Është e vërtetë që kemi edhe mungesë termash teknologjike e tjerë në gjuhën shqipe, po në rastin e këtij ligji me të vërtetë kemi pasur mangësi serioze në formulimet, pra që janë më shumë të natyrës teknike dhe është një numër kaq i madh i amendamenteve. Në përgjithësi është një punë e mirë që është bërë edhe nga Komisioni edhe nga stafi tjetër mbështetës dhe teknik dhe unë kërkoj nga Kuvendi dhe deputetët t’i aprovojnë këto amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka kërkuar deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Vetëm një sqarim, ne në shqyrtimin e parë i kemi thënë vërejtjet tona pra në lidhje me këtë projektligj dhe pasi që kanë qenë përmbajtjesore kemi votuar “kundër” projektligjit. Tani të gjitha këto 27 amendamente janë kryesisht tekniko-gjuhësore, pra kanë të bëjnë me përmirësimin e tekstit origjinal, kështu që për amendamentet do të abstenojmë, ndërsa për projektligjin do të votojmë “kundër”. Faleminderit!

Deputetja TEUTA SAHATQIJA e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ky projektligj ka qenë një projektligj i cili është trajtuar një kohë shumë të gjatë në Komision, ka pasur shumë herë shtyrje edhe ka pasur edhe një shkelje procedurale kur për të njëjtin projektligj është votuar dy herë. Në votimin e parë kanë qenë 4 me 4, ne kemi propozuar që të mos votohet, ndërsa atëherë është organizuar nuk e di me çfarë rregullore edhe një herë votimi dhe atëherë ka kaluar ky ligj. Vërejtjet tona kanë qenë që ky projektligj duhet të jetë projektligj për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuar dhe pasuritë e tyre, por që në këto ndërmarrje të mos jetë i përfshirë edhe kompleksi i "Trepçës" për të cilin ne mendojmë që duhet të ketë një ligj të veçantë.

Ky propozim ynë ka qenë prej fillimit në Komision dhe pasi që të gjitha procedurat u kryen në votimin e parë dhe ishin 4 me 4, ne propozojmë që të ketë të shkruar në te që ky projektligj nuk vlen për kompleksin "Trepça." Përndryshe, të gjitha amendamentet mund të vlejné për ndërmarrje tjera, por mendojmë që këto amendamente nuk mund t'i drejtohen edhe kompleksit "Trepça" dhe kjo duhet të jetë e shkruar, përndryshe ne votojmë "kundër". Propozimi ynë është që në dispozitat kalimtare të shtohet që ky ligj nuk vlen për kompleksin "Trepça", përndryshe do të votojmë "kundër".

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj të theksoj faktin se ky është një ndër ligjet në pakon e ligjeve të privatizimit, është paksa i vonuar, por është momenti i fundit që të jetë tashmë i aprovuar.

Dëshiroj të sqaroj edhe diçka rreth procedurave. Është e vërtetë që dy herë ka kaluar në votim, herën e parë ka qenë një votim i balancuar, herën e dytë ka qenë një kërkesë e deputetëve edhe atyre që kanë qenë aty edhe të tjerëve që të ri-trajtohet edhe për faktin tjetër që ka qenë një mënyrë e pazakontë në gjithë mbledhjen ka pasur punë në amendamente dhe janë aprovuar amendamentet, ndërsa në fund nuk ka pasur votim të projektligjit, po kjo është krejt çështje formale.

Dëshiroj të kthehem edhe një herë në nevojën e aprovimit të këtij ligji. Ky ligj, sipas sponzorizuesit i dedikohet komplet kompleksi "Trepça", është një shans që jepet, është i analizuar dhe i studiuar mirë edhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit edhe nga Qeveria e Kosovës dhe po ashtu edhe nga partnerët që e kanë përcjellë procesin e privatizimit dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe është një kërkesë e përbashkët dhe një zotim që ky ligj do të japë shansin vendimtar "Trepçës" që ta kalojë këtë fazë e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme për këtë gjigant ekonomik dhe për të hyrë në një fazë të mëvonshme e cila do të jetë po ashtu e rëndësishme, jo vetëm për "Trepçën", por edhe në ndonjë ndërmarrje eventualisht tjetër që mund t'i përshtatet ose mund t'i përshtatej ky projektligj në procesin e mëtutjeshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!

Është evidente që është e rëndësishme që ky ligj të kalojë, mirëpo po duket që rrezikon që të mos kalojë për shkak të arsyeve që u thanë këtu pa dashur t'i përsëris, kështu që si mocion kisha propozuar që projektligji të shtyhet për nesër. Me qenë se nuk kemi hyrë në procedurë të votimit, kemi mundësi ende ta shtyjme për nesër, që seanca të mbahet në orën 11:00 dhe paraprkishtë të provojmë të gjejmë rrugë. Nëse projektligji nuk kalon procedura është e saktë, i kthehet sponsorizuesit që do të thotë Qeverisë dhe i merr disa muaj për t'u kthyer.

Mirëpo, nëse nuk gjejmë gjuhë kemi mundësi të shkojmë me sa di unë edhe në lexim të tretë edhe të shohim se cilat janë ato amendamente të cilat mund të rregullohen në mënyrë që mos të kthehet krejt projektligji në procedurë prej fillimit.

Domethënë, propozimi im është të presim deri nesër dhe të shohim a kemi mundësi ta gjejmë ndonjë zgjidhje që ta kalojmë projektligjin? Faleminderit!

KRYETARI: Unë kam respekt për këtë që e the ti Ardian, po këtu tash kemi një problem që është esencial. Kryetari i Komisionit thotë se ligji është për "Trepçën", në anën tjetër kemi kërkesën nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike që thotë kjo vlejë për të gjitha të tjerat, por jo për "Trepçën", do të thotë kjo nuk është një punë që mund të kalohet brenda një nate, se mund ta shtyjme. Nëse ju jeni dakord ne mund ta lëmë për nesër, jo në orën 11:00, po në orën 10:00.

(Reagim nga salla)

Atëherë, kalojmë në procedurën e votimit.

Konstatojmë se janë prezentë 79 deputetë.

Tash lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Amendamenti 1.

Konstatoj se më 43 vota "për", 3 "kundër" dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 49 vota "për", asnjë "kundër" dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 47 vota "për", asnjë "kundër" dhe 11 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 49 vota "për", asnjë "kundër" dhe 15 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 46 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 20 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 45 vota “për”, një “kundër” dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 45 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 47 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 47 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 45 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 16 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 42 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 44 vota “për”, një “kundër” dhe 12 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 42 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 44 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 43 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 17 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 43 vota “për”, një “kundër” dhe 16 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 45 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 42 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash.

Prezentë 81 deputetë.

Konstatoj se më 43 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 43 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 18 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash.

Konstatoj se më 42 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 17 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Amendamenti 21 lidhet me nenin 25. Në nenin 26 kolegu Sabri Hamiti , kishte të drejtë, me të vërtetë nuk po analizohen asnjëherë diskutimet parimore. Në shqyrtimin e parë ne kemi problematizuar pikën 4 të nenit 26 ku thuhet, ku

ka të bëjë me transferimin ose dhënien me qira të pasurisë së ndërmarrjeve që riorganizohen dhe në fund thuhet: “kontrata e tillë e qiramarrjes ka afat prej 99 vjetëve dhe ka një e tjera e tjera”. Ma merr mendja që kjo është një zgjidhje shumë problematike, ose duhet të fshihet ky afat ose duhet të kufizohet për arsye se dhënia e aseteve të ndërmarrjeve dhe pasurive të paluajtshme në një afat fiks qysh është themeluar kështu 99 vite është shumë problematike. Propozimi im është që në një afat deri 99 vjet, por të kalojë në Kuvend sipas vendimit të Kuvendit, për çdo rast të veçantë, sepse këto janë çështje shumë me rëndësi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Votojmë amendamentin 22.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 44 vota “për”, 3 “kundër” dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 48 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 15 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 46 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 21 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 48 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 43 vota “për”, një “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27 dhe i fundit.

Votojmë tash.

Konstatohet se më 46 vota “për”, një “kundër” dhe 19 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Tani është koha për të votuar tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit!

Në fillim të shqyrtimit të dytë të këtij projektligji propozova që në fund, te neni 50, te dispozitat kalimtare, të shtohet paragrafi i ri si vijon: “Dispozitat e këtij ligji nuk

zbatohen për kompleksin “Trepça” për të cilin do të bëhet ligji i veçantë”. Këtë e thashë edhe në fillim të shqyrtimit të projektligjit, tash jemi në dispozitat kalimtare. Ju kisha lutur që ta qitni edhe këtë në votim.

KRYETARI: Ju lutem, ne nuk po votojmë dispozita kalimtare, ne po votojmë ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se më 51 vota “për”, 16 “kundër” dhe 10 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe të pasurisë së tyre.

Dhe, me këtë për sot kemi përfunduar seancën, vazhdimi nesër në orën 10:00.

E premte, më 23.9.2011, ora 10:00, vazhdimi i seancës

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministër,

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 22 shtator 2011, për pikat e mbetura.

Konstatohet se prezent janë 78 deputetë, 77 me kartela. Vazhdojmë me pikën e 14-të të rendit të ditës:

**14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion,
lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër
Korrupsionit**

Komisioni funksional për Legjislacion ka intervistuar kandidatët për pozitën e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Kuvendit i ka propozuar dy kandidatët e mundshëm për pozitën e drejtorit.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion, deputetin Arben Gashi.

ARBEN GASHI: I nderuar kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç e dini, Komisioni për Legjislacion ka pasur për detyrë funksionale që të merret me procedurat për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit. Procedurat janë ndjekur është shpallur konkursi dhe si rezultat i konkursit, ka rezultuar që kanë konkurruar 11 kandidatë. 9 prej tyre janë kualifikuar, sepse 2 nga ata kanë aplikuar jashtë afatit kohor.

Komisioni ka bërë intervistimin e të gjithë kandidatëve dhe si rezultat i intervistimit, me një proces shumë transparent dhe, besoj, me një punë shumë të mirë të komisionit, që ka qenë një punë pa asnjë lloj ankese, për të cilën dëshiroj edhe t’i falënderoj të gjithë

anëtarët e komisionit që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për selektimin e kandidatëve më të mirë të mundshëm për kryetar të komisionit. Dhe, rezultati ka dalë ky:

Nga intervistimi i kandidatëve rezulton se: kandidati Bashkim Zeqiri ka marrë 243 pikë nga 250 maksimalja, ndërsa kandidati tjetër Hasan Preteni ka marrë 202 nga 250 maksimalja.

Ne sot kemi para vete një mundësi, mundësinë që t'i japim Kosovës një drejtor, i cili do të bëjë luftën kundër korrupsionit dhe do të ndikojë edhe në Raportin e Progresit dhe në perceptimin e qytetarëve të Kosovës lidhur me korrupsionin. Kjo mundësi vendoset nga ju, prandaj ju ftoj që të jeni të vëmendshëm në kuptimin e dhënies së votës dhe në kuptimin e përgjegjshmërisë para qytetarëve të Kosovës. Kjo është një ftesë miqësore, pa dashur të ndikoj se për cilin kandidat ju do të mund apo dëshironi të votoni.

Prandaj, ju falënderoj shumë për bashkëpunim, falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për punën që kanë bërë dhe ju ftoj që të merrni pjesë në këtë votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në radhë janë kryetarët e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar, fjalën e ka deputeti Behar Selimi!

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka dhënë kontributin e vet në këtë komision përmes 3 deputetëve përfaqësues në komision dhe mendojmë që Kuvendit i kemi ofruar 2 kandidatura potenciale për të marrë atë përgjegjësi. Inkurajojmë të gjithë deputetët që mbi bazën e të gjitha informacioneve që i kanë, që i kanë marrë qoftë nga informacionet përmes materialeve apo edhe në rrugë tjera, mbi bazën e ndërgjegjes së lirë të votojnë për njërin prej kandidatëve që ne e kemi rekomanduar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar me kujdes CV-të e kandidatëve. Duke marrë parasysh që Agjencioni kundër Korrupsionit është institucion i pavarur dhe i themeluar me qëllim të hetimit, parandalimit dhe luftimit të korrupsionit mbi bazën e ligjit edhe të kësaj arsyeje, Grupi Parlamentar i LDK-së do të bëjë përzgjedhjen e më të mirëve në bazë të konkurrencës së paraqitur dhe do ta jap kontributin e vet pa asnjë ndikim në njërin anë apo në anën tjetër. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të “Vetëvendosjes”, Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mbështet rekomandimin e Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit dhe do të marrë pjesë në votim. Faleminderit.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se dy kandidatë, të cilët kanë ardhur deri në këtë fazë, janë kandidatë të mirë dhe kemi vendosur që të mos kemi preferencë politike, por ta lëmë në vullnetin e deputetëve se cilit kandidat do t’ia hedhin votën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Amir Hameti.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, ne si pjesëmarrës në Komisionin për Legjislacion kemi dhënë kontributin tonë dhe i kemi ofruar Kuvendit dy kandidatët me poenët më së shumti të fituara në komision. Mendoj se kanë qenë alternativat tona më të mira. Shpresojmë se deputetët do të vendosin për njeriun më meritor! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputetja Jasmina Zhivković.

JASMINA ŽIVKOVIĆ: Zahvaljujem!

I Parlamentarna grupa SLS je dala svoj doprinos u radu sa komisijom i intervjuisanju kandidata. Poslanici pred sobom imaju dva kandidata, koja su dobila najveći broj glasova i slobodno mogu odlučiti za koga će glasati. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Podržavamo kandidaturu oba predstavnika i glasaćemo za jednog od njih. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, sipas nenit 8 paragrafi 5 të Ligjit për Agjencionin kundër Korrupsionit, Kuvendi me votim të fshehtë dhe me shumicën e thjeshtë të votave, zgjedh njërin prej kandidatëve të propozuar për drejtor të Agjencisë.

Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues, nga përbërja e deputetëve me mbështetjen e zyrtarëve të administratës së Kuvendit. Ftoj përfaqësuesit e Grupeve Parlamentare të propozojnë nga një anëtar për Komisionin votues.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, na e epni një emër!
Fjalën e ka deputeti Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për anëtar të komisionit propozon Halit Krasniqin.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputeti Ismet Beqiri!

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, faleminderit!
Grupi Parlamentar i LDK-së propozon për anëtar të komisionit, deputetin Imri Ahmeti.

KRYETARI: Faleminderit!
“Vetëvendosja”?

FLORIN KRASNIQI: Albulena Haxhiu!

KRYETARI: Faleminderit!
AAK, Ardian?

ARDIAN GJINI: Faleminderit, kryetar!
E propozojmë Kymete Bajraktarin, deputeten Kymete Bajraktarin.

KRYETARI: Faleminderit!
Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!
Koalicioni për Kosovë të Re propozon për anëtar të komisionit Jeton Svircën.

KRYETARI: Grupi i SLS-së, Sasha Milosavleviq!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!
Mi predlažemo Jasminu Živković.

KRYETARI: Faleminderit!
Grupi “6+”!

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!
Ne e propozojmë deputeten, Duda Balje.

KRYETARI: Faleminderit!
Para se të fillojmë me procedurën e votimit, lus mediat që ta lëshojnë sallën! Shkojmë me një votim formal për komisionin!
Kush është “për” kandidatët e propozuar? Shumica!
“Kundër”? Nuk ka!

Abstenim? Nuk ka!

Konstatohet se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë kundër Korrupsionit.

Lus komisionin që të fillojë me procedim! Ndërsa, deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës!

Në sallë janë 89 deputetë. Anëtarët e komisionit t'i zënë vendet e tyre!

Po fillojmë!

Adem Grabovci, Afërditë Berisha, Afrim Hoti, Afrim Kasolli...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Regjia, kamerat i përqendroni te kutia e votimit!

Gëzim Kelmendi, Agim Kuleta, Ahmet Isufi, Albanë Fetoshi, Albanë Gashi, Albin Kurti, Albulenë Haxhiu, Ali Sadriu, Albert Kinolli, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Aurorë Bakalli, Azem Syla, Bahri Thaçi, Arsim Bajrami, Bali Muharremaj, Berat Luzha, Behar Selimi, Amir Ahmeti, Bekim Haxhiu, Biserka Kostić, Blerim Shala, Blerta Deliu, Burim Ramadani, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj Bujupi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enis Kervan, Nait Hasani, Eqrem Kryeziu, Ethem Arifi, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Xhelili, Jeton Svirca, Flora Brovina, Florin Krasniqi, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Gorana Marinković, Njazi Idrizi, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Hamza Balje, Hydajet Hyseni - Kaloshi, Hashim Deshishku, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Emin Gërbeshi, Idriz Vehapi, Imri Ahmeti, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi...

Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti

Jasmina Živković dhe Jelena Bontić, Justina Pula, Kymete Bajraktari, Latif Gashi, Liburn Aliu, Lirie Kajtazi, Lumnije Morina, Lutfi Haziri...

Drejtimin e seancës e rimerr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

Lutfi Zharku, Fikrim Damka, Kurtan Kajtazi, Suzan Nobërdaliu, Mufera Shinik, s'është, Muhamet Mustafa, Mursel Halili, Myzejene Selmani, Naser Osmani, Nazane Breca, Kimete Bytyqi, Sasha Milosavleviq, Petar Miletqi, Rada Trajković, Ramë Vataj, Ramiz Kelmendi, Ramiz Lladrovci, Rasim Demiri, Rexhep Selimi, Rita Hajzeraj-Beqaj, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha – Shala, Sali Asllani, Sali Morina, Salihe Mustafa, Sasha Gjokiq, Millivoje Sojanović, Safete Hadërgjonaj, në rend je, Sevdije Lama, Skender Hyseni, Boban Todorović, Sreten Ivanović, Teuta Haxhiu, Time Kadrijaj, Ukë Rugova, Vesimir Saviq, Vesna Mikiq, Visar Ymeri, Vjollca Krasniqi, Vjosa Osmani, Valbonë Dibra, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaku, Xhevdet Neziraj, Zenun Pajaziti.

Nëse kemi harruar ndonjë deputetë për ta ftuar, le të lajmërohet. Po më duket i kemi ftuar krejt me rend.

Komisioni mund të fillojë numërimin e votave!

HALIT KRASNIQI, në emër të Komisionit, deklaroi rezultatin e fletëvotimeve: Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Bashkim Zeqiri; Bashkim Zeqiri, Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; e pavlefshme, Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; e pavlefshme; Hasan Preteni; e pavlefshme, janë votuar të dytë; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; e pavlefshme; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Bashkim Zeqiri, Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; e pavlefshme; e pavlefshme; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Hasan Preteni; e pavlefshme; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; e pavlefshme; e pavlefshme; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; Hasan Preteni; Bashkim Zeqiri; e pavlefshme.

KRYETARI: Urdhëro Halit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit votues, deputeti Halit Krasniqi!

HALIT KRASNIQI: Në bazë të votimit, rezultoi ky përcaktim:

Në votim kanë marrë pjesë 94 deputetë,

Të pavlefshme kanë qenë 10,

Për Bashkim Zeqirin kanë votuar 30 deputetë,

Për Hasan Pretenin kanë votuar 54 deputetë.

Ky është rezultati i votimit që ka dalë nga numërimi.

KRYETARI: Faleminderit!

Në bazë të Raportit të Komisionit votues, konstatoj se Kuvendi zgjodhi zotin Hasan Preteni, drejtor të Agjencisë kundër Korrupsionit, me mandat 5 vjeçar.

Kalojmë në pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e një anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ka fjalën kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, deputeti Zenun Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër, ministra,

Deputetë të nderuar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 25.8.2011, pasi që shqyrtoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, ka vendosur që Kuvendit t'i paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

Që zoti Enver Halimi, të emërohet anëtar i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të grupeve, nëse dëshiron ndokush? Nuk dëshironi!

Atëherë, shkojmë në votim.

Prezentë kemi 67 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Konstatohet se me 44 vota “për”, 4 “kundër”, 12 “abstenime”, Kuvendi zgjodhi zotin Enver Halimi, anëtar në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, me mandat pesëvjeçar.

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetaren e komisionit funksional, deputeten Safete Hadërgjonaj, që ta arsyetojë raportin me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 78, paragrafi 2 dhe 3 i Ligjit Numër 03/L-222 për Administratën Tatimore të Kosovës dhe procedurat, anëtarët e Bordit të Pavarur për shqyrtim të ankesave propozohen nga Qeveria mbi bazën e aftësive të tyre për të kryer funksionin dhe miratohen nga Kuvendi.

Bordi përbëhet prej 16 anëtarëve, që së paku 7 anëtarë duhet të jenë nga komuniteti i biznesit dhe gjysma e anëtarëve zëvendësohen për çdo vit kalendarik.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 18 korrik e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtim të Ankesave, përkatësisht listën e kandidatëve me biografi të tyre të propozuara nga Qeveria për emërimin në këtë Bord dhe ka vlerësuar se biografite të të gjithë kandidatëve nuk ishin të kompletuara, mungonin dokumentet shtesë që argumentojnë përgatitjet profesionale, përvojën dhe trajnimet që janë cekur në përmbajtjen e biografive të anëtarëve të propozuar për emërim të Bordit dhe ka kërkuar nga Qeveria që t'i plotësojë biografite të këtyre anëtarëve dhe të propozojë sipas Ligjit njërin prej këtyre anëtarëve si kryesues të këtij bordi.

Qeveria, sipas rekomandimeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa i ka dërguar Kuvendit dokumentet e kërkuara, si dhe ka bërë propozimin e njërit prej anëtarëve për kryesues të Bordit për shqyrtim të ankesave sipas dispozitave ligjore.

Në mbledhjen e Komisionit të mbajtur më 22.8.2011 i ka shqyrtuar dokumentet shtesë të dërguara nga Qeveria që argumentojnë përgatitjet universitare, përvojën dhe trajnimet që janë cekur në përmbajtje të biografive të anëtarëve të propozuar për emërimin në Bordin për Rishqyrtim të Ankesave dhe njëkohësisht komisioni ka shqyrtuar edhe anëtarin e propozuar nga Qeveria për kryesues në këtë Bord dhe ka vlerësuar se anëtarët e propozuar dhe kryesuesi kanë përgatitjet profesionale dhe eksperiencën për kryerjen e punëve të tilla dhe i përmbushin të gjitha kërkesat dhe kushtet ligjore të parapara me Ligjin për administratën tatimore dhe procedurat dhe me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit ta miratojë këtë Propozim-vendim të Qeverisë për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit të ankesave me mandat dy vjeçar dhe njëkohësisht ka kërkuar nga Qeveria që t'i plotësojë kushtet për punë dhe të angazhohet në funksionalizimin sa më të shpejtë të këtij bordi, sepse është edhe kërkesë e Raportit të p]Progresit, pika 72.

Gjatë shqyrtimit dhe analizës së biografive të këtyre kandidatëve, ne kemi pasur aty edhe ministrin dhe i kemi marrë të gjitha arsyetimet dhe kemi ardhur në përfundim se këta anëtarë i plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë të këtij bordi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të grupeve, e doni fjalën? Fjalën e ka kërkuar deputetja Hykmete Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka parë me kujdes vendimin e Qeverisë për emërimin e kryesuesit dhe të anëtarëve të Bordit, të ashtuquajtur, të Pavarur për Rishikimin e Ankesave.

Ne nuk do ta votojmë këtë vendim, sepse ky s'është gjë tjetër, veçse një hap i radhës i Qeverisë në vazhden e përpjekjeve për të shlyer favore apo bërë favore personave dhe grupeve të caktuara të interesit.

Në Komision, kur kemi pyetur Qeverinë se pse po bëhet ndërrimi i Bordit, Qeveria ka thënë se Bordi nuk ka qenë efikas, kurse kryesuesi ka mbetur i njëjtë, do të thotë kemi personin i cili ka qenë kryesues i Bordit prej vitit 2008.

Edhe një vërejtje tjetër është se Qeveria nuk e ka emëruar Bordin. Ky bord ka operuar pa mandat qe një vit. Kështu, Qeveria vazhdon të ndërrojë bordet e agjencioneve, kinse të pavarura, pa dhënë ndonjë rezultat.

Ne nuk kemi asgjë kundër, në veçanti kundër ndonjë kandidati, mirëpo mendojmë se ky bord do të duhej të përbëhej nga njerëz që posedojnë personalitete dhe që kanë kredibilitet në shoqërinë kosovare, e ne mendojmë se kësaj përbërje i mungon kjo.

Ne do të votojmë kundër! Ju faleminderit!

KRYETARI: A e do ndokush tjetër fjalën? Jo!

Atëherë, shkojmë në votim!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash!

Prezentë janë 80 deputetë!

Konstatohet se Kuvendi me 40 vota “për”, 33 “kundër”, 4 “abstenime” emëroi kryesuesin dhe anëtarët e Bordit të Pavarur për Rishikimin e Ankesave, me mandat dyvjeçar, si në vijim:

- Skender Kolgeci, kryesues,
- Faruk Prebreza, anëtar,
- Loreta Peci, anëtare,
- Agron Kajtazi, anëtar,
- Shukri Hoxha, anëtar,
- Vlorë Zhushi, anëtare,
- Abdullah Haxhiu, anëtar, dhe
- Hyda Hajrullah-Dallku, anëtar.

Dhe, me këtë e kemi përfunduar seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti: Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës